REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**MIRATOHET**

KRYETAR I K.K.T.-së

**Z. EDI RAMA**

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**Znj. BELINDA BALLUKU**

Kryetar i Këshillit Bashkiak

**Z. SHEFQET DAUTI**

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak
Nr. 08 Datë 26.02.2021

Kryetar i Bashkisë

**Z. LIMAN MORINA**

# PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË HAS

*STRATEGJIA TERRITORIALE*

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 02, Datë 15.04.2021

DPKZHT: *NOVRUZ BARDHOSHI*
KONSULENT "GJEOKONSULT&CO": *me përfaqësues ligjor Z.Hamit Mustafa* , Nr.Liç. N6408/18

## Përmbajtia


1. HYRJE ..... 5
2. REZULTATET E ANALIZËS DHE VLERËSIMIT TË TERRITORIT ..... 6
2.1 Parashikimet e planit kombëtar ..... 6
2.1.1 Objetivat, politikat dhe vizioni i PPK ..... 6
2.1.2 Parashikimet e PPK në lidhje me Hasin ..... 8
3. STRATEGJI DHE DIREKTIVA KOMBETARE TË PLANIFIKIMIT SEKTORIAL ..... 8
3.1 Strategjia e Sektorit të Transportit ..... 8
3.2 Strategjia Kombëtare e Energjisë ..... 10
3.3 Strategjia kombëtare e menaxhimit të mbetjeve ..... 11
3.4 Programi Kombëtar Sektorial i Ujit 2018-2030 ..... 12
3.5 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015- 2020 ..... 13
3.6 Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 ..... 14
3.7 Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015 – 2020 ..... 15
4. PROJEKSIONE DEMOGRAFIKE ..... 17
4.1 Të dhëna socio-demografike ..... 17
4.2 Shërbimet publike ose me përdorim publik ..... 18
4.2.1 Kopshtet, shkollat 9-vjeçare, shkollat e mesme ..... 18
4.2.2 Qendrat Shëndetësore ..... 21
5. ORIENTIME NGA DOKUMENTAT E PLANIFIKIMIT ..... 23
5.1 Hasi në lidhjet rajonale ..... 23
5.2 Hasi në programin IPA II ..... 23
5.3 "Plani i Përdorimit të Tokës për Planifikimin e Territorit të Njësisë Vendore Bashkisë Krumë" ..... 24
6. Përcaktimi i territorit në të 5 sistemet dhe analiza SWOT ..... 25
6.1 SISTEMI URBAN ..... 27
6.2 SISTEMI BUJQËSOR ..... 30
6.3 SISTEMI NATYROR ..... 33
6.4 SISTEMI UJOR ..... 35
6.5 SISTEMI INFRASTRUKTUROR ..... 37
6.6 KONKLUZIONE PARAPRAKE ..... 46
7. VIZIONI DHE STRATEGJIA TERRITORIALE E BASHKIVE FQINJE ..... 47
7.1 KUKËSI: ..... 47
7.2 TROPOJA: ..... 48
7.3 FUSHE ARRËZ ..... 49
8. VIZIONI DHE STRATEGJIA E HASIT ..... 50
8.1 VIZIONI I BASHKISË ..... 50
8.2. Objektivat strategjik ..... 51
8.3 Drejtimet kryesore të zhvillimit ..... 53
8.3.1. Drejtimi i Zhvillimit të Ifrastrukturës ..... 54
8.3.2. Drejtimi i Zhvillimit të Bujqësisë ..... 57
8.3.3. Drejtimi i Zhvillimit të Turizmit ..... 58
8.4 Objektiv Strategjik 1 - Mbrojtja e mjedisit ..... 59
8.4.1 Programet strategjike për OS1 ..... 60


REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

8.4.2 Projektet prioritare/pilot ........ 66
8.5 Objektiv Strategjik 2 - Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore dhe monumentale ne Has ........ 74
8.5.1 PROGRAMET STRATEGJIKE ........ 77
8.5.2 Projektet Prioritare/Pilot ........ 86
8.6 Objektiv Strategjik 3 - Përmirësimi i bujqësisë edhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase ........ 91
8.6.1 Programet strategjike ........ 93
8.6.2 Projektet Prioritare/Pilot ........ 96
8.7 Objektiv Strategjik 4 – Përmirësimi i shërbimeve publike ........ 101
8.7.1 Programet strategjike ........ 103
8.7.2 Projektet prioritare/pilot ........ 107
8.8 Objektiv Strategjik 5- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar të bashkisë si pasojë e pozicionit gjeografik të saj ........ 125
8.8.1 Programet strategjike ........ 126
8.8.2 Projektet Pilot/Prioritare ........ 128
8.9 Objektiv Strategjik 6 - Organizimi i hapësirës urbane të bashkisë ........ 130
8.9.1 Programet strategjike ........ 131
8.9.2 Projektet prioritare/pilot ........ 136
9. PLANI I VEPRIMIT ........ 141
10. REFERENCA LIGJORE ........ 159
11. DËGJESA PUBLIKE DHE FORUMI VENDOR I KRYER NGA AKPT ........ 160
11.1 Dëgjesa Publike ........ 160
11.2 Forumi Vendor i kryer nga AKPT datë 28.01.2019 ........ 164

GJEOKONSULT & C
NIPT: K31810005U
TIRANE - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA HAS

## 1. HYRJE

Ky raport zhvillon Strategjinë territoriale të bashkisë së Hasit duke nisur nga vlerësimi I analizës territoriale zhvilluar në Fazën 1, përsa i përket natyrës, kulturës, gjeologjisë, hidrologjisë, socio- demografisë, socio-ekonomisë, infrastrukturës, të trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të vendbanimeve. Analiza gjithashtu përfshin identifikimin e parashikimeve dhe strategjive të Planit Kombëtar për zonën e Hasit, që do të implementohen në PPV të bashkisë.

Ripërpunimi kritik i të dhënave të dala i ka dhënë rrugë përpunimit të analizës SWOT mbi të pesë sistemet e caktuara territoriale: sistemin urban (UB), sistemin e infrastrukturës (IN), sistemin natyral (N), sistemin e ujor (U) dhe sistemin bujqësor (B).

Relacioni paraqitet si më poshtë:

- Kapitulli i parë janë përmbledhur rezultatet e kërkimeve të kryera në fazën e parë
- Kapitulli I dytë janë nxjerrë konkluzione në lidhje më Bashkinë Has në bazë të strategjive dhe direktivave kombëtare të planifikimit sektorial
- Kapitulli I tretë janë trajtuar projeksionet demografike
- Një kapitull në të cilin përshkruhet strategjia territoriale për 5 sistemet duke përcaktuar objektiva strategjikë, për zhvillimin e territorit në përputhje me identifikimin e nevojave dhe mundësive
- Një plan veprimi që paraqet pamjen e përgjithshme të projekteve të identifikuara dhe në të cilat janë paraqitur:
    - Akse strategjikë të planit
    - Objektiva
    - Projekte
  - Prioritete dhe korniza kohore
    - Tipologjia e investimit
    - Vlerësim I përafërt I kostove
- Për çdo projekt janë redaktuar disa skeda implementimi që përcaktojnë:
    - Objektivin e projektit
    - Përmbajtja e projekti

# 2. REZULTATET E ANALIZËS DHE VLERËSIMIT TË TERRITORIT

## 2.1 Parashikimet e planit kombëtar

Plani i Përgjithshëm Kombëtar përcakton kuadrin e referimit për të gjitha planet e hartuara në Shqipëri; në fakt, ai përcakton parimet dhe udhëzimet për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, duke vendosur supozimet për krijimin e kushteve territoriale për zhvillimin rajonal.

Përveç kësaj, Plani i Pergjithshëm Kombëtar përcakton kuadrin e përgjithshëm për zhvillimin e infrastrukturës publike kombëtare, dhe përcakton kushtet për ruajtjen e ekosistemeve dhe burimeve territoriale, nga ato nëntokësore në ato natyrore e kulturore, në lidhje me ndikimet e sistemeve urbane dhe të aktiviteteve ekonomike.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar drejton objektivat ndërsektoriale të planifikimit rajonal, dhe koordinon objektivat e zhvillimit sektorial me efekt mbi territorin; se fundi, një funksion i rëndësisë qendrore që zhvillohet nga Plani ka të bëjë me kontrollin logjik në lidhje me udhëzimet dhe orientimet e perspektivës së zhvillimit të hapësirës Evropiane.

Lidhja me dimensionin evropian të qeverisjes së territorit është perceptuar si një çështje shumë e rëndësishme, duke supozuar për të ndërtuar në mënyrë sa më të mirë marrëdhëniet strategjike me shtetet fqinje që lindin nga stabiliteti politik, por edhe bazat për krijimin e një platforme që lehtëson aksesin e fondeve të alokuara në kuadër të programit evropian.

Ndërsa per sa i përket qeverisjes territoriale në dimensionin e saj të brendshëm, plani zhvillohet ne brendësi të një proçesi më të gjerë reforme administrative e cila ka prodhuar një ridefinim të hierarkive territoriale mes qendrave urbane dhe territoreve, së cilave i korrespondon një unifikim dhe riorganizim mjetesh planifikimi hapësinor në shkallë të gjerë.

### 2.1.1 Objektivat, politikat dhe vizioni i PPK

Në nivel strategjik, Plani Kombëtar shpalos objektivat e mëposhtme:

1. Integrimi hapësinor në kontekstin evropian,
2. Përforcimi i konkurrueshmërisë ekonomike të Shqipërisë në nivel rajonal,
3. Sigurimi i integritetit fizik e territorial të peizazhit historik, kulturor, natyror dhe urban në të gjithë territorin kombëtar.
4. Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nëpërmjet promovimit të rritjes ekonomike, eliminimit të pabarazive hapësinore dhe heqjen e pengesave për qasje në infrastrukturë dhe njohuri.

Për arritjen e këtyre objektivave, plani evidenton direktivat e projektimit në nivel politik, të cilat kanë të bëjnë me:

1. Zhvillimi i infrastrukturave kombëtare të lidhjes me korridoret e transportit ndërkombëtar;
2. Zhvillimi irolit të Shqipërisë si pikë lidhëse për infrastrukturat energjetike të rajonit të Ballkanit;
3. Zhvillimi i Sistemeve Urbane Inteligjente;
4. Mbrojtja dhe zhvillimi i burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore, edhe në aspektin e identitetit, duke përmirësuar aksesin dhe përdorimin;
5. Zhvillimi sistemit të transportit multimodal që lidhet me qëndrueshmerinë dhe transportin e integruar, i cili mbështet zhvillimin territorial policentrik;
6. Zhvillimi i infrastrukturave energjetike funksionale në përdorimin e burimeve energjitike të ripërtëritshme;
7. Projektimi dhe zhvllimi një hub-i për të integruar flukset që lidhen me komunikimet, transportin,energjinë dhe produktet ushqimore.

Politika të tilla përshkruajnë "vizionin" e përgjithshëm të Planit, i cili shtrihet në nivele dhe fusha të ndryshme, duke mbajtur të forta dy referenca të kontekstit të cilit i asociohen dy shkallë diskutimi, njera e lidhur me kontekstin e mbarë-evropian, dhe të tjera me atë të hapësirës ballkanike.

Në rastin e parë, skenari i propozuar nga plani merr në konsideratë krijimin e lidhjeve të infrastrukturës kombëtare që lidhin Shqipërinë me rrjetin e transportit trans-evropian, duke synuar forcimin e lidhjeve strategjike të vendit me anë të disa korridoreve që do të zhvillohen si pasojë arsyetimi multi-sektorial:

- Korridori gjelbër (Shkodër, Hani Hotit - Kakavijë,Gjirokastër)
- Korridori Blu (përgjatë bregdetit)
- Korridori VII, i cili lidh Detin Mesdhe me Detin e zi
- Boshti qendror Elbasan, Berat – Jug
- Rruga e Arbrit

Në kontekstin Ballkanik, Shqipëria ka qëllim për të zhvilluar centralitetin e saj në lidhje me tematika të ndryshme, ndër të cilat qëndron tema e energjisë: Shqipëria është në fakt vend kalimi për korridore të ndryshme ndërkombëtare, të tilla si: Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), Gazsjellësi Jonian Adriatik (IAP) dhe IAP i KOSOVES për furnizimet në Kosovë përmes unazës së Ballkanit Perëndimor (WBR), të cilave i shtohen funksionet e shkëmbimit tregtar dhe logjistik të katër porteve kryesore shqiptare, ndër të cilat ai I Vlorës paraqitet më I rëndësishmi në frontin energjitik.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

### 2.1.2 Parashikimet e PPK në lidhje me Hasin

Në këtë paragraf do të bëjmë një përshkrim të shkurtër të parashikimeve të planifikuara në Planin Kombëtar ne lidhje me Hasin dhe konluzione nga faza e analizës.

1. Bashkia Has si pjesë e polit të zhvillimit rajonal Kukës-Has-Tropojë do të përfitojë nga zhvillimet që parashikohen të ndodhin në këtë rajon, të drejtuara kryesisht në fushën e infrastrukturës.
2. Kufizimi që ka në Jug-Perëndim, Jug, Jug-Lindje nga liqeni i Fierzës, bën që bashkia Has të kufizohet në këto drejtime nga korridori natyror i propozuar në PPK. Pikërisht pozita gjeografike bën që ai të jetë me të gjithë territorin e tij pjesë e Brezit të Gjelbër Europian.
3. Pjesa Jugore dhe Jug-Lindore e bashkisë cilësohet nga PPK si zonë e cila mund të shfrytëzohet për prodhimin e energjisë nga era.
4. Propozohet gjithashtu një projekt për pastrimin dhe mbrojtjen e baseneve ujore nga dotja e mundshme në vijimësi.

## 3. STRATEGJI DHE DIREKTIVA KOMBETARE TË PLANIFIKIMIT SEKTORIAL

### 3.1 Strategjia e Sektorit të Transportit

Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit në Shqipëri është një nga prioritetet kryesore, për krijimin e parakushteve për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë, rritjen e aksesit dhe kontributit të konsiderueshëm në rritjen e përgjithshme ekonomike dhe zhvillimin e ekonomisë. Nga Strategjia Kombëtare e Transportit për zhvillimin e infrastrukturës së transportit, parashikohen si më poshtë:

- Prioritet strategjik për infrastrukturën rrugore, është përfundimi dhe modernizimi i rrjetit rrugor primar dhe dytësor të vendit, duke siguruar ndërlidhjen dhe lidhjen ndërkombëtare dhe sigurinë rrugore. Me gjithë investimet e fundit në rrjetin rrugor lokal dhe rajonal, cilësia e infrastrukturës së transportit rrugor mbetet e ulët dhe ekziston një ndryshim i konsiderueshëm rajonal në drejtim të aksesit të tregjeve dhe shërbimeve bazë. Rrjeti rrugor në vend është ende i kufizuar në mbulim dhe në cilësi dhe vuan nga mungesa e mirëmbajtjes, pavarësisht nga investimet e bëra përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). Mirëmbajtja dhe performanca sipas standardeve të BE-së, si dhe dendësia e rrjetit, duhet të përmirësohet përmes një sistemi menaxhimi të aseteve rrugore dhe zgjerimit të rrjetit rrugor kombëtar me pjesët e rrjetit rural.

- Përveç kësaj, rishikimi i klasifikimit funksional të rrjetit rrugor, rritja e alokimit të buxhetit vjetor për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar rrugor, promovimi i outputeve dhe koncesioneve të bazuara në performancë (Partneritetet Publike-Private) për operatorët rrugorë dhe mirëmbajtjen, jo vetëm për rrjetin kombëtar, por edhe për rrjetin rajonal dhe lokal dhe ekzaminimi i mundësisë së përcaktimit të një përqindje të caktuar të tarifave të përdoruesit të rrugës për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor.

- Për më tepër, për të siguruar lidhjen midis Evropës Juglindore dhe BE, strategjia parashikon përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimin e lidhjeve të munguara në rrjetin gjithëpërfshirës të Evropës Juglindore, duke siguruar në të njëjtën kohë lidhjen e këtij rrjeti bazë me pjesën tjetër të rrjetit primar dhe sekondar të vendit. Rrjeti i projektit përfshin seksionin Rrëshen - Milot të korridorit SEETO 7, që lidh Nishin (Serbi) - Prishtinën (Kosovë) dhe Durrësin, (në aksin e kësaj rrugë që kalon në Shqipëri, pjesë e iternerarit të saj është edhe bashkia e Hasit). Mbetet prioritet dhe përfundimi i një ure dhe një tuneli në segmentin Kukës-Morinë në rrugën 7 drejt Prishtinë.

- Lidhur me infrastrukturën hekurudhore, prioritet është futja e vendit në tregun hekurudhor evropian si një aktor në korridoret e transportit në Evropën Juglindore. Kjo kërkon përpjekje për rritjen e performancës së hekurudhave, përkatësisht për të reduktuar kohën e tranzitit dhe shpenzimet e transportit dhe logjistikës, për të lehtësuar kalimet kufitare duke krijuar kalime të përbashkëta kufitare dhe tërheqjen e investimeve të nevojshme për të harmonizuar aspektet teknike dhe rregullatore sipas standardeve të BE.Për Hasin nuk është parashikuar ndonjë segment hekurudhor, i cili kalon në këtë territor.

- Së fundmi, për Aeroportet, duhet të përpunohet një Master Plan për të gjithë vendin për 20 vitet e ardhshme, me theks në zhvillimin dhe ndërtimin e një aeroporti të ri në jug të vendit, në mënyrë që të shërbejë si një qendër për fluturimet ndër-evropiane e dhe mesdhetare, për zgjerimin e aeroportit të Tiranës pas vitit 2025 dhe për ndërtimin e aeroportit të Kukësit. Aeroporti i Kukësit do të ndikojë në zhvillimin jo vetëm të Kukësit, por edhe zonave përreth, ku përfshihet edhe Hasi.

- Perspektiva e zhvillimit Intermodal dhe Transportit të Kombinuar, qëllimi është të integrojë planifikimin dhe zhvillimin e terminaleve në planifikimin më të gjerë të transportit dhe përdorimit të tokës, përmirësimin e aksesit në terminale dhe pajisjet e terminaleve me kapacitete operacionale si dhe për të drejtuar investimet në trajtimin e pengesave, në mënyrë që të sigurohet një transport efikas i integruar me zinxhirë logjistikë pa ndërprerje, kosto të ulët dhe zvogëlim të trafikut të automjeteve të rënda nga portet kryesore shqiptare në vendet fqinje (duke përfshirë vendet që kane dalje në det Kosovë dhe FYROM) dhe më gjerë dhe duke kontribuar në këtë mënyrë në zbatimin e Flagship Axes në rajon.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - TIRANË - SEKRETARIA

### 3.2 Strategjia Kombëtare e Energjisë

Shpreh në thelb përcaktimin e drejtimeve kryesore të zhvillimit të sektorit energjetik, si një sektor mbështetës për zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë, duke garantuar sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e mirëqenies me një kosto minimale sociale. Shqipëria ka potenciale të konsiderueshme të burime të rinovueshme:

- Energjia nga burimet hidrike
- Energjia Diellore
- Energjia e Erës
- Energjia e biomasës
- Energjia gjeotermale.

Përmirësimi i performancës së sektorit energjetik është thelbësor, për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit tonë, por ajo duhet parë dhe në kontekst të situatës energjetike në vendet e Europës Juglindore.

Traktati i Komunitetit të Energjisë, i cili ka hyrë në fuqi në Korrik 2006, në të cilin vendi ynë është palë (ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9501, datë 03.04.2006), inkurajon krijimin dhe integrimin e tregjeve të energjisë elektrike dhe të gazit në rajon, në kuadër të Tregut të Brendshëm Energjetik të Komunitetit Europian.

Për realizimin e objektivave të strategjisë janë përcaktuar këto prioritete:

- Përfundimi i ristrukturimit të sektorit energjetik shqiptar;
- Përsosja e mëtejshme e kuadri efektiv institucional e ligjor;
- Rritja sigurisë së furnizimit me energji të vendit,
- Rritja e kontributit të sektorit energjetik në zhvillimin ekonomik të vendit, në Buxhetin e Shtetit dhe bilancin financiar të vendit,
- Rritja e kapaciteteve gjeneruese dhe diversifikimi i tyre,
- Intensifikimi i operacioneve të kërkim-prodhimit të hidrokarbureve dhe tërheqja e investitorëve strategjikë në këtë sektor, si dhe në zhvillimin e vendburimeve ekzistuese, për të mundësuar shfrytëzimin me efektivitet dhe eficencë të naftës bruto.
- Ndërtimi i linjave të reja të interkonjeksionit në sektorin elektroenergjetik,
- Angazhimi në realizimin e projekteve rajonale të interkoneksionit me linjat e gazit dhe diversifikimi i burimeve të furnizimit,
- Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjetike, me konceptin e planifikimit me kosto më të ulët dhe ndikim minimal në mjedis,
- Nxitja e përdorimit efiçent dhe ekonomik të burimeve të energjisë, si dhe nxitja e aplikimit të mënyrave të ndryshme të menaxhimit të energjisë, në sektorët e ndryshëm të ekonomisë,
- Nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë,



GJEOKONSUL
NIPT: K 18100
TIRANE

- Krijimi i tregut të brendshëm dhe integrimi i tij në tregun rajonal,
- Përmirësimi i kapaciteteve menaxheriale në sektorin energjetik,
- Përmirësimi i organizimit institucional i sektorit energjetik dhe nënsektorëve të tij (elektroenergjetik, hidrokarbur, energjive të rinovueshme dhe efiçencës).
- Për realizimin e qëllimi strategjik në përafrimin me Direktivat e Bashkimit Europian duhet të realizohen:
- Përfundimi i plotësimit dhe përafrimit të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator të sektorit energjetik, në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian;
- Përfundimi i strukturimit të shoqërive tregtare, që operojnë në sektorin energjetik;
- Do të përfundojë privatizimi i shoqërive të prodhimit të energjisë elektrike, pronë publike, me përjashtim të hidrocentraleve Vau i Dejes, Koman dhe Fierzë mbi lumin Drin.

Sipas vendim nr. 27, datë 20.1.2016 ështe miratuar Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme për vitet 2015–2020.

Përsa i përket bashkisë Has, megjithëse nuk ka territor të pasur me resurse natyrore, sidomos të tipit që mund të përdoren për ti kthyer në energji të formave të ndryshme. Gjithsesi u miratua një vendim për ndërimin e një Hidrocentrali në Perollaj, konkretisht vendimi nr.3 KKT dt.
05.05.2015. "HEC Perollaj", I cili është ndërtuar në pellgun ujëmbledhës të përroit të Bexhmillës në Golaj. Ky hidrocentral ka një kapacitet prej 0.5 mega-watt dhe sipas raportit vjetor të ERE për vitin 2017 ka prodhuar 345 KË.

### 3.3 Strategjia kombëtare e menaxhimit të mbetjeve

Është miratuar me VKM 175, datë 19.01.2011. Administrimi i mbetjeve në Shqipëri është në një nivel shumë të ulët. Me sisteme për grumbullimin e mbetjeve të ngurta janë pajisur vetëm qytetet, por jo zonat rurale. Praktikohet shumë pak riciklim. Kryesisht mbetjet asgjësohen në vendgrumbullimet e mbetjeve. Nuk ka një sistem të sigurt për administrimin e mbetjeve të rrezikshme. Sipas kësaj strategjie raportohen disa problem mjedisore të cilat lidhen me këto çështje si:

- Sistemet për grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve janë të pamjaftueshme dhe joefektive;
- Vendimet për mbledhjen dhe heqjen e tyre nuk mund të bëhen në mungesë të një informacioni të besueshëm;
- Nuk ka një traditë të mirëfilltë për trajtimin dhe heqjen e mbetjeve;
- Burimet financiare dhe teknike janë të pamjaftueshme;

- Publiku ka mungesë informacioni për sa i përket rrezikut që shkaktohet nga administrimi i dobët i mbetjeve.

Strategjia kombëtare e mbetjeve e pranon nevojën për të marrë plotësisht në konsideratë nevojat dhe rrethanat lokale, në mënyrë që të identifikojë zgjedhjet praktikisht më të mira për menaxhimin e mbetjeve në të gjithë vendin. Për këtë arsye, strategjia e ndan vendin në 12 zona mbetjesh bazuar në kufijtë gjeografikë të qarqeve ekzistuese, ku secili nga planet do të zhvillohet në bashkëpunim me aktorët

lokalë. Strategjia, gjithashtu, njeh nevojën për të identifikuar burimet parësore të mbetjeve, në mënyrë që ata të mund të jenë subjekt i veçantë në konsideratë për Qeverinë dhe komunitetin ndërkombëtar të donatorëve.

Aktualisht në Bashkinë Has funksionon një vend-depozitim, josanitar dhe i paorganizuar,I cili gjëndet në kufirin mes ish-njësisë administrative Fajzë dhe Krumë. Gjithashtu, në bazë të kërkimeve të kryera dhe në terren, u konstatuan të shpërndara në të gjithë territorin e bashkisë vende të tjera të vogla të deponimit të pakontrolluar. Duke pasur si çështje kryesore përmirësimin e synuar të rrethanave patogjene që ndikojnë në metabolizëm për sa i përket cilësisë së jetës dhe cilësisë së mjedisit, propozohen veprimet e mëposhtme për Bashkinë:

- Ndryshimi total i modelit të menaxhimit të mbetjeve (të lëngshme dhe të ngurta). Përpunimi (në impiante të përshtatshme) të ujërave të zeza urbane, përhapjen e riciklimit të ambalazhimeve dhe mbetjeve organike të ngurta urbane, në mënyrë që në të ardhmen, deponimi i mbetjeve të kufizohet në ato që teprojnë nga mënyrat alternative të menaxhimit.
- Marrja e masa për të parandaluar dhe rehabilituar ndotjen e burimeve ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore).

## 3.4 Programi Kombëtar Sektorial i Ujit 2018-2030

Manaxhimi i integruar i ujit është një ndër prioritet e qeverisë shqiptare. Ky prioritet theksohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (*miratuar me VKM nr. 348 datë 11.5.2016*). Sektori i ujit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Ai lidhet ngushtë me prodhimin e energjisë elektrike, zhvillimin e bujqësisë, turizimin dhe rekreacionin. Në procesin e integrimit evropian arritja e standardeve të BE-së në sektorin e ujit konsiderohet si një nga proceset më të vështira dhe të kushtueshme. Për të realizuar vizionin për një periudhë trembëdhjetëvjeçare (2018-2030) për sektorin e ujit janë identifikuar dhe propozuar tre qëllime, të cilat shprehen në funksion të tre shtyllave të sektorit të ujit: përdorimi i ujit, mbrojtja e ujit dhe mbrojtja nga uji. Për arritjen e këtyre qëllimeve janë propozuar trembëdhjetë objektiva të cilat tregojnë pozicionimin e sektorit të ujit për këtë periudhë. Këto tre qëllime prekin ciklin natyror të ujit dhe nuk ndryshojnë pavarësisht kuadrit institucional, i cili ka rolin kryesor në harmonizimin e tyre.

### *1. Përdorimi i Ujit*

Nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtëtë tyre ndërmjet përdoruesve, duke maksimizuar përfitimet ekonomike nërespekt të kushteve mjedisore dhe parimeve të manaxhimit të qëndrueshëm.

### *2. Mbrojtja e Ujit*

Mbrojtja e ekosistemeve ujore, përfshirë ujërat sipërfaqësore dhenëntokësore, nga ndotja shpërdorimi dhe mbishfrytëzimi, dukemirëkoordinuar të gjitha aktivitetet të cilat shkaktojnë presione mbi to si dheduke respektuar parimet e manaxhimit të qëndrueshëm.

### *3. Mbrojtja nga Uji*

Mbrojtja e popullsisë dhe e pronës nga efektet e pakthyeshme të shkaktuaranga uji, përfshirë këtu përmbytjen dhe erozionin, në mënyrë të qendrueshmedhe efektive. Ne Bashkinë Has marrja e ujit nga vendburimet bëhen në bazë të studimeve tekniko – ekonomike dhe të lejeve përkatese nga organet kompetente, duke parë leverdisshmërinë e investimeve të ndërtimit, të mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit; në marrjen e ujit nga pusshpimet
duhet të parashikohen puse rezervë sipas Tabelës:

| Nr. | Emërtimi | Sasia e puseve |
|---|---|---|
| 1. | Numri i puseve në pune | 1 2 3 4 5 6 |
| 2. | Numri i puseve rezervë | 1 1 1 1 1 1 |

*Tab.1. Puset rezervë*

Sasia mesatare e ujit që duhet te sigurohet nga vendburimi dhe që duhet të përcillet deri te konsumatori, llogaritet si shumatore e sasisë së ujit që nevojitet për çdo konsumator veç, sipas normativave të aprovuara dhe specifikave të veçanta të nevojës së tyre për konsumin e ujit.

### 3.5 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015- 2020

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) përfaqëson dokumentin themelor strategjik që kombinon axhendën e integrimit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. SKZHI II eshtë dokumenti që paraqet vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit gjatë periudhës 2015-2020, duke ravijëzuar aspiratat për integrim në Bashkimin Europian. SKZHI 2015- 2020 paraqet se si ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive që synojnë, si më poshtë:

- Nxitjen e ritmeve të zhvillimit të vendit, duke gjeneruar rritje ekonomike të qëndrueshme, përmes një stabiliteti makroekonomik dhe financiar;
- Arritjen e standardeve që u shërbejnë qytetarëve, rritjes së mirëqenies dhe sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre;
- Transformimin e Shqipërisë në një vend me standarde, që mundësojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian;
- Ndërtimin e politikave që rrisin konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të vendit, krahasuar me vendet e rajonit dhe më tej.

Vizioni dhe përparësitë strategjike të Shqipërisë bazohen në njohuri të shëndosha rreth faktorëve të integrimit evropian dhe zhvillimit kombëtar. Përgatitja e SKZHI-II është udhëhequr nga një numër parimesh bazë, disa prej të cilave janë artikuluar në një gamë konventash dhe marrëveshjesh ndërkombëtare,24 dhe disa të tjerash që kanë dalë dhe janë përdorur gjatë proceseve të konsultimit dhe analizës së politikave. Parimet janë përdorur gjithashtu edhe për përgatitjen e strategjive dhe planeve specifike sektoriale dhe ndërsektoriale, të tilla si parimet e tregtisë së ndershme dhe menaxhimit të financave publike, ose parimet e Kartës së Autonomisë Vendore të BE-së, dhe kështu me radhë.

### 3.6 Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020

Reforma administrativo-territoriale si një nga prioritetet më të rëndësishme, u hartua në një proces gjithëpërfshirës dhe u miratua miratuar me ligjin 115/2014 datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi kryesor dhe përfundimtar i reformës administrative territoriale është rritja e efikasitetit të administratës lokale, cilësisë dhe standardeve të ofrimit të shërbimeve si dhe zhvillimi i drejtë i territorit duke mundësuar burime më të mëdha njerëzore dhe financiare, duke shtuar përgjegjësitë dhe kompetencat në nivel lokal dhe duke u orientuar drejt një vendimmarrjeje më transparente dhe me më shumë pjesëmarrje.

**Strukturat e dekoncentruara**

Reforma administrative do të rikonfigurojë marrëdhëniet e bashkëpunimit mes pushtetit vendor dhe strukturave të dekoncentruara të qeverisjes qendrore. Do të synohet përmirësimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit institucional si dhe eliminimi i mbivendosjeve funksionale dhe të kompetencave. Gjithashtu do të synohet saktësimi dhe kalimi gradual i kompetencave në funksionet e përbashkëta. Rishikimi i rolit të prefektëve kundrejt monitorimit dhe kontrollit të ligjshmërisë të organeve të qeverisjes vendore do të respektojë parimet e Kartës Evropiane të Qeverisjes Vendore. Funksionet e qeverisjes vendore pas reformës administrative-territoriale do ti nënshtrohen një rishikimi me qëllim ripërcaktimin e përgjegjësisë së autoriteteve vendore mbi funksionet e veta dhe të përbashkëta që do të miratohen nga ligji i ri organik i qeverisjes vendore. Megjithatë decentralizimi si një proces në vazhdim do të synojë alokimin e funksionet të reja edhe me ligje sektoriale, por duke aplikuar një parimin e analizës funksionale dhe financimin e plotë të funksionit, përpara decentralizimit të tij.

Qeverisja vendore do mund të refuzojë funksionet që synohen ti decentralizohen me ligje sektoriale nëse nuk ka një analizë funksionale dhe financim të plotë të funksionit. Ligji i ri organik për qeverisjen vendore do të përmbajë për herë të parë edhe parimin e decentralizimit asimetrik bazuar në parimin e subsidiaritetit. Ato njësi vendore që kanë kapacitete njerëzore dhe burime financiare mund të kërkojnë decentralizimin e kompetencave të caktuara brenda funksioneve të përbashkëta apo dhe funksioneve të tjera që ushtrohen nga organet e qeverisë qendrore duke synuar ofrimin e shërbimeve në një standard më të lartë.

### 3.7 Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015 – 2020

Në fushën e mbrojtjes së natyrës është realizuar transpozimi i Direktivave kryesore të kësaj fushe, respektivisht Direktivës së Habitateve dhe Direktivës së Shpendëve, duke arritur në një masë transpozimi mbi 85 % për këto Direktiva. Është plotësuar kuadri ligjor kombëtar nëpërmjet janë hartimit dhe miratimit prej vitit 2006 të n jë numër ligjesh të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit që transpozojnë direktivat e sipërpërmendura si: Ligji "Për mbrojtjen e faunës së egër", Ligji "Për gjuetinë", Amendimi i Ligjit "Per zonat e Mbrojtura", Ligji "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të tregëtimit ndërkombëtar të llojeve te rrezikuara të faunës dhe florës së egër", amendimi i Ligjit "Për bidoversitetin" si dhe një numër aktesh nënligjore në zbatim të tyre. Sfidat për të ardhmen. Objektivat e ardhshëm do të jenë:

(i) përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit europian në fushën e pyjeve dhe kullotave;
(ii) rritja e kapaciteteve të menaxhimit të pyjeve komunale nëpërmjet grandeve konkurruese dhe forcimit te kapaciteteve;
(iii) përmirësimi i sistemit te informacionit dhe data bazës pyjore;
(iv) forcimi i sistemit te kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit ne pyje;
(v) përmirësimi i marrëdhënieve rajonale, aplikime te përbashkëta ne programe ndërkombëtare dhe unifikimin e teknologjive e metodologjive;
(vi) aplikimi ne programe kombëtare e ndërkombëtare për te siguruar një mbështetje te nevojshme për zhvillimin e pylltarisë në vend
(vii) përfshirja e çështjeve te ndryshimeve klimatike ne te gjithe aspektet e administrimit e menaxhimit te fondit pyjor.

Në zonën e Bashkisë Has si zonë të mbrojtura njihen 30 monumente natyrore siç është Ahishtja e Likenit të Kuq dhe 30 ha rezervë natyrore e menaxhuar *"Tej Drini i Bardhë" VKM nr.102, datë 15.01.1996*. Zona të mbrojtura, me vendim të këshillit të ministrave nr.676 datë 20/12/2002 janë: Shpella Tingëlluese, Shpella në Mazrrek, Sofër dhe shpella e Dajçit, Vrella e Krumës, Brrudit, Domaj, Harhullës, maja e Qytezës dhe Pisha e Gjinajve. Zhvillimet e parashikuara për këtë çështje janë përkatësisht në objektivat strategjikë 1 dhe 2 mbi vizionin e së ardhmes për Hasin.

### 4.8 Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2018-2020

Vizioni Shqipëria do të njihet si një destinacion turistik tërheqës, autentik dhe mikpritës në rajonin e Mesdheut dhe Evropë, bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të potencialeve natyrore, kulturore dhe historike për zhvillimin e produkteve të cilësisë lartë dhe të shumëllojshme, e arritshme lehtësisht nga tregjet ndërkombëtare. Turizmi luan një rol kryesor në ekonominë shqiptare, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe duke krijuar një mjedis tërheqës për investimet dhe hapjen e vendeve të punës. Zhvillimi i turizmit do të shkojë në përputhje me objektivat dhe strategjitë e sektorëve të tjerë që kushtëzojnë dhe ndikojnë direkt dhe indirekt zhvillimin dhe cilësinë e shërbimeve turistike. Harmonizimi në

kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) do të garantojë një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit dhe një strategji të arritshme.

Turizmi i qëndrueshëm shqiptar luan një rol të rëndësishëm në mirëqenien ekonomike dhe sociokulturore, të rritjes së të ardhurave dhe krijimit të vendeve të reja të punës dhe është një kontribues i rëndësishëm për reputacionin ndërkombëtar të Shqipërisë, bazuar në marketingun intensiv të produkteve turistike të Shqipërisë, markave të njohura ndërkombëtarisht dhe me vlerë të lartë të shtuar.

**Deklarimi i politikës dhe vizioni**

Qeveria synon mbështetjen e turizmit si një sektor i rëndësishëm i integruar ekonomik me karakteristika të thella kulturore, ndër-sektoriale, ndër-rajonale dhe i një niveli të lartë ndikimi social. Turizmi është tashmë një sektor me ndikim të madh social dhe ekonomik që synon të plotësojë kërkesat e qytetarëve shqiptarë dhe turistëve të huaj për vizita kulturore, kohën e lirë,

shëndetin dhe sportin, akomodimin, ushqimin dhe argëtimin, etj., duke ndryshuar pozitivisht strukturën ekonomike, duke krijuar vende të reja pune me një treg pune tërheqës, të qëndrueshëm dhe konkurrues dhe të ardhura të konsiderueshme, si dhe duke kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Parimet kryesore të strategjisë dhe politikave bazë në fushën e turizmit janë:

- Vlerësimi i turizmit si sektor strategjik dhe prioritar i ekonomisë, me ndikim të lartë social dhe komunitar;
- Mbrojtja dhe respekti ndaj mjedisit janë kritere të panegociueshme të çfarëdo planifikimi dhe zhvillimi në sektorin e turizmit;
- Mbështetja e turizmit duke krijuar kushte të favorshme ligjore, ekonomike dhe strukturore për zhvillimin e tij;
- Sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit duke krijuar kuadrin e plotë të ligjeve dhe rregulloreve dhe zbatimi i një procesi të koordinuar planifikimi për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin dhe strukturat sociale;
- Përcaktimi i drejtimeve prioritare për zhvillimin e turizmit në Shqipëri, me fokus në produktin e turizmit bregdetar, produktin e turizmit kulturor dhe produktiv e turizmit natyror;
- Krijimi i imazhit të favorshëm të Republikës së Shqipërisë si destinacion turistik;
- Krijimi i kushteve për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të ligjshme të turistëve dhe ofruesve të shërbimeve turistike;
- Sigurimi i zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e turizmit, parashikuar edhe në MSA;
- Mbështetja e shoqatave dhe organizimeve vullnetare të subjekteve të veprimtarisë turistike në mënyrën e përcaktuar me ligj;
- Përfshirja aktive e qeverisjes vendore në zhvillimin e turizmit në nivel lokal dhe rajonal (destinacioni) dhe krijimi i kushteve për jetësimin e këtij kontributi;
- Zbatimi i strategjisë së zhvillimit të turizmit të lidhur ngushtë dhe në ndërveprim e simbiozë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Planin e Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030, Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, Politikat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË
KONSULLT GJEOKONSULT & CO NIPT: K31810005U TIRANË ALBANIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit, Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, Strategjinë e Transportit, Politikat strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit, Kulturën dhe Turizmin Kulturor dhe çdo strategji tjetër kombëtare e sektoriale që ka ndikim në zhvillimin e turizmit.

Konkretisht, kjo çështje mbi zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në bashkinë Has lidhet me objektivin strategjik nr.3 në vizionin e të ardhmes për Hasin.

# 4. PROJEKSIONE DEMOGRAFIKE

## 4.1 Të dhëna socio-demografike

Tabela më poshtë tregon dendësinë (numri i personave për kilometër katror). Kështu, duket se Krumaështe shumë më e populluar dhe madje me shumë diferencë administrative, fakt i pritshëm, duke pasur parasysh madhësinë e popullsisë dhe sipërfaqen shumë te vogël. Gjinaj, me vetem 15.6 banore për km$^2$, është me pak e populluar. Duke marrë parasysh shkallën e urbanizimit të të gjithë territorit shqiptar, bazuar në një kategorizim modern, totali i Bashkisë
renditet ne zonat me popullsi te paktë nga njësitë e tjera.

| Qendra e banuar | Banorë për km$^2$ |
|---|---|
| KRUMË | 83.7 |
| FAJZË | 49.6 |
| GJINAJ | 15.6 |
| GOLAJ | 33.6 |

*Tab.2. Dëndësia e popullsisë*

| Bashika | Njësitë administrative | Klasifikimi administrativ | | Klasifikimi bazuar në rrjet | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | % urban | % rural | % urban | % rural |
| HAS | Krumë | 84 | 16 | 0 | 100 |
| | Fajzë | 0 | 100 | 0 | 100 |
| | Gjinaj | 0 | 100 | 0 | 100 |
| | Golaj | 0 | 100 | 0 | 100 |

*Tab.3. Përqindja e urbanizimit sipas njësive administrative*




*Grafiku. 1. Piramida e moshës*

Nga totali i popullsisë banuese , janë 49.75% meshkuj dhe 50.25% femra. Raporti gjinor është 1.01 dhe evidenton një dominancë të lehtë të femrave në krahasim me meshkujt.

Me një popullsi totale prej 16 900 banorë ekzistuese të regjistruar në gjendjen civile, për bashkinë e Hasit parashikohet një rritje e vogël e popullsisë në vitet e ardhshme deri në 15%-20% të saj.

Kjo sepse shifrat ekzistuese të popullsisë së sotme nuk paraqesin personat që banojnë fizikisht në territor, kjo pasi një pjesë e mirë e tyre kanë migruar ose emigruar. Prurja e popullsisë është më e madhe në periudhën e verës dhe pranverës ku kryesisht emigrantët ritkthehen në territor duke krijuar një rritje fiktive sezonale.

## 4.2 Shërbimet publike ose me përdorim publik

### 4.2.1 Kopshtet, shkollat 9-vjeçare, shkollat e mesme

Bashkia e Hasit ka një mbulim të mirë nga shkollat fillore dhe 9-vjeçare në gjithë territorin e bashkisë.

Përsa i përket shkollave të mesme rrezja e shërbimit nuk e mbulon gjithë territorin e bashkisë duke qenë kryesisht e vendosur në vendbanimet më të populluar si Perollaj, Golaj, Vlahen dhe në qytetin e Krumës. Mbulimi i shërbimit është i llogaritur në bazë të popullsisë së territorit të Hasit si dhe në bazë të aksesibilitetit të këtyre zonave, duke specifikaur rrezet e mbulimit sipas llojit të shërbimit si më poshtë:



*Fig.1. Institucionet arsimore*

Sikurse shihet në hartën e mësipërme, propozimet e insitucioneve arsimore mbështeten kryesisht në restaurimin/rikonstruskionin e shkollave ekzistuese. Kjo pasi një pjesë e mirë e territorit të Bashkisë Has është e mbuluar me shkolla, kryesisht të nivelit fillor, 8-vjeçar dhe të mesëm, të cilat së fundmi edhe janë sistemuar.

Pavarësisht kësaj, kryesisht në pjesën veriore të bashkisë aksesi drejt insitucioneve arsimore, e shoqëruar kjo me popullsinë e vogël në këto qendra të banuara, nuk mundëson plotësimin e kushteve për krijimin e shkollave të reja. Harta e mësipërme dhe në këto zona, propozon restaurimin e shkollave ekzistuese të cilat nuk shfrytëzohen prej disa vitesh, por për shkak të pozicionit të tyre në raport me qendrën e banuar, godina ekzistuese e pashfrytëzuar mund të shihet si potencial për të plotësuar nevojën për arsim në këto territore.

Duke u nisur nga verifikimi i gjendjes ekzistuese propozohet rikonstruktimi i Shkollës së Mesme Vlahen, Shkollës 9-Vjeçare Helshan dhe Shkollës 9-Vjeçare Fshat-Krumë. Sot banorët e këtyre territoreve arsimohen në zonën e Krumës ose braktisin shkollën.



*Fig.2. Shkollë 8-vjeçare në Bashkinë Has (potencial restaurimi)*

### 4.2.2 Qendrat Shëndetësore

Bashkia Has ka një mbulim të mirë të shpërndarjes të qendrave shëndetësore në territor. Të gjitha fshatrat me përjashtim të Zgjecit,Peraj dhe Kishaj kanë qendër shëndetësore të tipit konsultore, ambulancë ose qendër shëndetësore.

Vizioni për bashkinë Has propozon rregullimin e rrjetit ekzistues të qendrave shëndetësore duke ndërhyrë në përmirësimin e infrastrukturës së ndërtesave ekzistuese.

Mbulimi i shërbimit është llogaritur duke parë gjëndjen ekzistuese në territor, si dhe aksesibilitetin nga ana e popullsisë në këto territore.



*Fig.3. Qendrat shëndetësore*

Popullsia ekzistuese dhe e parashikuar e Hasit nuk justifikon hapjen e Qendrave Shëndetësore dhe institucioneve Arsimore te reja (sidomos në pjesën veriore të bashkisë) .

Pavarësisht kësaj, ajo popullsi e vogël që banon në këto territore duhet të ketë shërbimet primare, arsim dhe shendetësi. Në njësitë kryesore administrative të bashkisë, rasti konkret në njësinë Golaj, gjenden objektet e vjetra të para viteve '90 sot të pashftrytëzuara dhe të degraduara të cilat duhet të shihen si potencial për rikonstruksion. Kjo shihet si mundësia më e përshtatshme për të mbuluar shërbimet parësore në këto zona me një popullsi shumë të ulët dhe të vështira për t'u aksesuar nga pikëpamja e infrastruktures rrugore.

Përsa i përket shërbimit shëndetesor, ajo merret nga banorët e zonës, ose në fshatin më të afërt të aksesueshëm ose përsëri në Krumë. Kjo është arsyeja e largimit nga këto zona të bashkisë në krasim me pjesën jugore të bashkisë.

## 5. ORIENTIME NGA DOKUMENTAT E PLANIFIKIMIT

Në këtë kapitull do të bëjmë një përmbledhje të të gjitha orientimeve dhe konkluzioneve që kemi përftuar nga dokumentat e planifikimit. Duke përfshirë lidhjet rajonale të Hasit, pozitën e bashkisë Has në raport me porgramin IPA II, direktivat që rrjedhin nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar, raporti i bashkisë Has me "PINS Bregdeti" dhe "PINS Durana", gjithashtu më poshtë do të paraqiten dhe konkluzionet e arritura nga "Plani i Përdorimit të Tokës për Planifikimin e Territorit të Njësisë Vendore Bashkisë Krumë" dhe nga PPV të bashkive Kukës dhe Tropojë të cilat janë miratuar tashmë.

### 5.1 Hasi në lidhjet rajonale

Ndai korridoreve pan – europiane, rezulton që bashkia Has ka pozicion strategjik shumë të favorshëm në lidhje më këtë rrjet. Kjo pasi lidhja direkte që ka me korridorin kombëtar Durrës – Kukës – Morinë, i mundëson që nëpërmjet Prishtinës të lidhet me Korridorin X pan – europian. Ky korridor është shtylla kurrizore e rrjetit rrugor dhe hekurudhor të Europës jug-lindore, si një korridor që lidh shtete si: Austria, Hungaria, Sllovenia, Kroacia, Sërbia, Bulgaria, Maqedonia dhe Greqia. Ky akses kaq i afërt me shtetet fqinje dhe europën e vendos Hasin në një pozitë të favorshme për këmbimet ndërkombetare, ekonomike, social-kulturore, etj. Avantazh tjetër për Hasin është dhe afërsia me aeroportin e Kukësit, i cili me vendosien në funksionim të plotë të tij, përbën një mundësi shumë të mirë për lidhjen e Hasit me europën dhe më gjërë.

### 5.2 Hasi në programin IPA II

Bashkia e Hasit bën pjesë në zonën Kukës - Prishtinë të bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të programit IPA. Ky grup bashkëpunimi ndërkufitar përbëhet nga dy nën grupe, atë Tropojë – Gjakovë dhe Kukës - Prizren. Në këtë të fundit Hasi si bashki kufi me Kosovën dhe fqinje me komunën e Prizrenit, është në pozitë tepër të favorshme për shfrytëzimin e fondeve që BE vendos në dispozicion të këtij programi. Tjetër aspekt avantazhues për bashkinë Has kundrejt përfitimit të fondeve të programit IPA, për bashkëpunimin ndër-kufitar, është dhe fakti që në kufi ka një shtet dhe komunë shqip folëse. Gjë e cila e bën më të thjeshtë bashkëpunimin dhe bashkërendimin për projekte të përbashkëta, kjo si pasojë e kulturës së njëjtë, traditës, historisë dhe perspektivës së përbashkët që këto treva kanë me njëra-tjetrën.

Siç shihet në vizionin strategjik të secilës prej dy bashkive kufitare me bashkinë Has, njashmëria e pozitës gjeografike, formës dhe resursëve territoriale, ka rezultuar në propozime që trajtojnë të njëjtat problematika që hasim dhe në zhvillimin e bashkisë Has. Këto dy plane janë një shembull shumë i mirë ku do të mund të referohemi për hartimin e vizionit strategjik, por dhe më tej, të PPV- së për bashkinë Has. Gjithashtu nga analiza e bërë vizioneve strategjikë të bashkive Kukës dhe Tropojë, vërehen dhe magësi të vogla apo difekte në trajtimin e strategjisë territoriale. Mundësia që na krijohet për ti parë këto difekte (megjithëse të vogla) na jep mundësinë për ti shmangur gjatë trajtimit të strategjisë territoriale për PPV-në e bashkisë Has.



GJEOKONSULT & C
NIPT: K*1810005U
TIRANE - ALBANIA
REPUBLIKA E SHQIPERISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPERISË BASHKIA HAS

Në përfundim vërehet se ashtu si në territorin e bashkisë Has, ashtu dhe në territoret e bashkive Kukës dhe Tropojë, ekziston nevoja për pasurimin e këtyre territoreve me shërbime dhe lehtësirat më elementare për të cilat banorët në këto bashki kanë nevojë.

### 5.3 "Plani i Përdorimit të Tokës për Planifikimin e Territorit të Njësisë Vendore Bashkisë Krumë"

Është i vetmi dokument planifikimi i hartuar për territorin e bashkisë Krumë, që si i tillë nuk ka pasur mundësinë të miratohet dhe të hyjë në fuqi pasi ndryshoi ligji për ndarjen administrative.

Ky projekt merr në shqyrtim territorin e ish bashkisë Krumë, ku përfshihen: Kruma si qendër e bashkisë, Zarisht, Dajç, Mujaj dhe Cahan si qendra të banuara rurale në administrimin e kësaj njësie vendore. Vizioni për zonën që përfshin këto qendra të banuara, është ndarja në tre kategori zhvillimi, zhvillimi hapsinor, zhvillim bujqësor dhe qendër shërbimesh. Mbështetur në resurset natyrore që ofrojnë këto zona është bërë dhe përcaktimi i llojit të zhvillimt që do të nxitet në këto zona. Njëkohësisht përcaktohen dhe lloji i turizmit që parashikohet të zhvillohet në këto zona, i ndikuar nga karakteristikat kryesore të resurseve natyrore që ndodhen në të.

Kështu territori i ish bashkisë Krumë ndahet në zonën e zhvillimit me qendër Zahrishtin. Zonë së cilës i jepet prioritet zhvillimit bujqësor, kjo pasi ajo është një zonë afër liqenit të Fierzës, ku dhe tokat janë më pjellore dhe ka më shumë mundësi për vaditjen, aq shumë të nevojshme në këtë sektor.

Zona e zhvillimit Krumë, e cila ka në qendër të saj qendrën administrative të ish bashkisë Krumë, dhe si e tillë i jepet prioriteti për zhvillim si qendër shërbimesh. Arsyeja është evidente, pasi aty ndodhen të gjitha shërbimet kryesore që ofrohen nga administrata shtetërore për këtë zonë.

Ndërsa zonës Dajç, Mujaj, Cahan i jepen atributet e zhvillimt blegtoral, duke qënë se kjo zonë ndodhet në pjesën më malore të ish bashkisë Krumë. Ku për pasojë është më i përshtatshëm zhvillimi i aktivitetit blegtoral, sidomos pë mbarështrimin e dhive të Hasit, të cilat njihen për karakteristikat e veçanta në prodhimin e qumështit. Në varësi të vektorit të zhvillimt që u është atribuar këtyre zonave, derivojnë dhe llojet i turizmit që marrin prioritet sipas rastit. Përkatësisht këto zona, në aspektin e turizmit, trajtohen si më poshtë:

a. Zahrishti – qendër për zhvillim bujqësor, i jepet prioritet turizmit liqenor dhe agro turizmit
b. Kruma – qendër shërbimesh, i jepet prioritet turizmit kulturor
c. Zona Dajç, Mujaj, Cahan – zhvillim blegtoral, i jepet prioritet turizmit malor

Ky studim ka propozuar dhe ndërhyrje urbane dhe hapësinore në qytetin e Krumës, që nisin me sitemimin dhe përshtatjen e rrugëve për këmbësorët dhe bicikletat. Pasojnë me propozimin për zgjerimin e bulevardit kryesor dhe lidhjen me pazarin e vjetër. Zhvillimi i akseseve rrugore për lidhjen e qytetit me lumin. Krijimi i një tregu rajonal për produktet bujqësore dhe blegtorale, si dhe krijimi i rrugës lidhëse të këtij tregu me qytetetin. Një propozim tjetër është dhe krijimi i një rruge unazore rreth qytetit, që do të shërbejë kryesisht për automjetet e tonazhit të rëndë. Tjetër propozim me vlerë për qytetin është dhe rehabilitimi i fashës së gjelbër të lumit si dhe krijimi i disa fashave të gjelbra që përshkojnë qytetin.

Siç shihet nga analiza e "Plani i Përdorimit të Tokës për Planifikimin e Territorit të Njësisë Vendore Bashkisë Krumë" si i vetmi studim i hartuar për njësinë administrative Krumë, pjesë e bashkisë Has. Ka një përmbajtje mjaftueshëm të plotë dhe propozimet e këtij dokumenti janë në përputhje me karakterin e zonës dhe i përshtaten shumë mirë mundësisë që ka kjo zonë për zhvillim. Gjithsesi aty vërehet mungesa e propozimeve për projekte të zhvillimit urban dhe hapësinor për njësitë Zahrisht, Dajç, Mujaj, Cahan.




*Fig.4. Ish-Plani I Përdorimit të tokës, qyteti Krumë*

## 6. Përcaktimi i territorit në të 5 sistemet dhe analiza SWOT

Territori i bashkisë Has, me qëllim të përgatitjes së PPV, është ndarë në pesë sisteme në përputhje me kërkesat refereruar VKM Nr. 686 dt. 22.11.2017 dhe të rregullores aktuale:

1. Sistemi Urban (UB)
2. Sistemi Infrastrukturor (IN)
3. Sistemi Natyror (N)
4. Sistemi Ujor (U)
5. Sistemi Bujqësor (B)

Këto sisteme nuk duhet të lexohen si komponentë të izoluara, por në ndërveprim të vazhdueshëm dhe lidhje midis tyre në një pespektivë të zhvillimit strategjik të territorit, në bazë të potencialeve, problemeve dhe nevojave të mundshme dhe specifike të çdo sistemi.

| Sistemi | Ha | % |
|---|---|---|
| Sistemi Urban (UB) | 763.9 | 1.6% |
| Sistemi Infrastrukturor (IN) | 345 | 0.9% |
| Sistemi Natyror (N) | 308.7 | 75.5% |
| Sistemi Ujor (U) | 1855 | 4.6% |
| Sistemi Bujqësor (B) | 7184 | 17.4% |

*Tab.4. Sipërfaqet e 5 sistemeve territoriale që përbëjnë bashkinë e Hasit*



*Fig.5. Harta e 5 sistemeve*

Territori i bashkisë së Hasit mbizotërohet nga sistemi natyror në pjesën më të madhe të territorit të tij. Pavarësisht dominimimit në sipërfaqe që ky territor ka, një element dhe sipërfaqe të konsiderueshme të 5 sistemeve natyrore ekzistuese në Bashkinë e Hasit e zë dhe sistemi i tokave bujqësore të cilat mbizotërojnë kryesisht në pjesën e fshatrave.

Bashkia e Hasit sikurse dhe bashki të tjera të territorit të Shqipërisë mbizotërohet nga sistemi urban në qendrën e saj, në rastin konkretnë qytetin e Krumës, e cila është qendra kulturore, shëndetësore, arsimore e bashkisë. Qyteti sot ka një karakter urban, ndërkohë, njësitë administrative (më parë ish - komunat) dhe fshatrat përbërëse të tyre kanë një territor 100% rural duke bërë që në to të mbizotërojnë sistemi bujqësor dhe ai natyror.

Territori i Hasit spikat gjithashtu për sistemin ujor. Ky sistem ujor përbëhet nga liqenet artificiale të shpërndara në zona të ndryshme të bashkisë, të cilat janë realizuar për efekt të ujitjes së tokave bujqësore. Këto liqene janë një pjesë e rëndësishme që përbejnë territorin e Hasit duke dalluar
nga sistemet e tjera në të. Vlen për tu theksuar se krahas liqeneve ujore artificiale të tij, në pjesën veri-perëndimore kjo bashki kufizohet edhe nga degë të liqenit të Fierzës të cilët konturojnë kufirin e bashkisë.

## 6.1 SISTEMI URBAN

Në hapësirën gjeografike të administruar nga bashkia Has gjenden të dy tipat e vendbanimeve, urbane dhe rurale. Nga pikëpamja administrative bashkia Has ndahet në 4 njësi administrative përkatësisht:

- Njësia administrative Krumë e cila është dhe qendra administrative e bashkisë, si dhe e vetmja njësi që mund të konsiderohet me karakter urban.
- Njësia administrative Golaj është njësia territori i së cilës përbledh të gjithë pjësën veriore të bashkisë Has, si e tillë ajo zotëron pjesën më të madhe të kufirit me Kosovën dhe ka sipërfaqen më të madhe ndër njësitë përbërsë të bashkisë.
- Në kufij me Kukësin dhe Fushë-Arrëzin në pjësën jug-perëndimore ndodhet njësia Fajzë e cila ka në përbërje të saj gjashtë fshatra: Fshati Fajzë si qendër administrative e njësisë ndodhet në qendër të saj
- Edhe njësia administrative Gjinaj përbëhet nga gjashtë fshatra dhe zë pjesën juglindore të bashkisë Has

Vendbanimet që shtrihen në bashkinë e Hasit janë të përqëndruara kryesisht në luginat e lumit Drini i Bardhë si dhe në gropat e lugjet e hapësirës së bashkisë Has. Në gjithë sipërfaqen e bashkisë Has mbizotërojnë fshatrat e shpërndara në shpatet emaleve ku mund të përmendim fshatrat Pogaj, Gjinaj, etj. Nga ana tjetër fshatrat e përqendruara i gjejmë të shtrira kryesisht përgjatë luginës së lumit Drini i Bardhë si dhe në gropat e lugje. Mund të përmendim fshatrat Golaj, Metaliaj, Domaj-Has etj.



*Fig.6. Harta e sistemit urban Has*

Në qëndrat e tyre kanë të përqendruara objekte publike si shkolla apo institucione të njësive administrative. Mund të përmendim fshatin Golaj, Fajza, etj. Duhet theksuar se e përbashkët për të gjithë fshatrat e rajonit ndërkufitar të Hasit është vendosja e tyre pranë rrugëve kryesore të rajonit ose rrugëve që lidhin fshatrat me njëri-tjetrin. Kjo është mundësuar për shkak të krijimit të lehtësirave në komunikim. Sikurse shihet edhe në hartën e dendësimit të banimit, sistemi urban në territorin e bashkisë është i shpërndarë përgjatë territorit duke u lidhur me qendrat kryesore të njësive. Pavarësisht se zonat urbane shfaqen edhe jashtë qytetit të Krumës, ato kanë karakter kryesisht në ndihmë të bujqësisë, jo zona të mirëfillta urbane.




*Fig.7. Dendësia e banimit e sistemit insediativ të bashkisë Has*

Në vitin 2009 qyteti i Krumës kishte një popullsi prej 4.028 banorësh dhe 841 familje, ndërsa në vitin 2011 qyteti i Krumës kishte një popullsi prej 5.007 banorësh. Kruma në aspektin e zhvillimit të ekonomisë është qytet bujqësor, por, që pas viteve '90 të shekullit të kaluar, gjithnjë e më shumë po zhvillohet sektori i shërbimeve në formën e bizneseve të vogla familjare. Në qytetin e Krumës janë përqendruar dhe institucione sociale: një kopsht, dy shkolla nëntëvjeçare, një shkollë e mesme, një spital, një shtëpi kulture, etj

Që nga viti 2014 e më pas, në vitin 2016, qyteti i Krumës ka marrë një pamje të re. Me planifikimin e ri urban qytetit iu rikonstruktuan fasadat e pallateve, iu asfaltuan të gjitha rrugët brenda qytetit, iu krijuan dhe iu shtuan hapësirat e gjelbra në qytet dhe iu përmirësua ndriçimi i rrugëve.

Në përfundim të analizës mundet të rendisim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e sektorit urban:

**Anët e forta**

- Pozicioni i favorshëm gjeografik që ka në lidhje kufirin me Kosovën dhe afërsia me Kukësin si një nga qytetet porta të përcakruar në PPK ofron mundësi për shfrytëzimin e fondeve të BE-së për bashkëpunim ndërkufitar
- Hasi, sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar është cilësuar si një nga qëndër terciare, portë hyrëse për Kukes-Has-Tropojë

**Dobësitë**

- Zgjerim i pa planifikuar i qendrave urbane , duke cënuar në këtë tokat natyrore dhe bujqësore
- Mungesë në ofrimin e shërbimeve
- Cilësi e ulët shërbimesh në zonat rurale

**Mundësitë**

- Bashkëpunim ekonomik dhe social në nivel rajonal dhe ndërkufitar
- Zbatimi / Programim i ndërhyrjeve të rëndësishme tërigjenerimit urban që rrisin funksionin dhe imazhin e qytetit të Krumës,
- Zbatimi / Programim i Infrastrukturës sociale që përmirësojnë jetën shoqërore dhe mundësitë rekreative
- Zbatimi / Programim për ndërtimin e banesave sociale për grupet në nevojë

**Kërcënimet**

- Fenomeni i emigrimit
- Tendenca e të rinjve për të braktisur zonën

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - TIRANË - SEKRETARIA

### 6.2 SISTEMI BUJQËSOR

Sistemi bujqësor është ndër sistemet përbërës më të rëndësishëm të Bashkisë Has, pasi konsiderohet si një nga degët më të rëndësishme të ekonomisë së vendit, përparësi kjo e dhënë edhe e përmendur në bashkinë e Hasit nga PPK-ja. Ky sistem përbëhet nga të gjitha sipërfaqet e tokës se punueshme. Pjesë e sistemit buqësor është dhe dega e blegtorisë me të gjitha resurset natyrore që përdoren për mbareshtimin e kafshëve si dhitë, lopë etj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HAS

Larmia e kushteve dhe faktorëve gjeo-klimatike që ka sipërfaqja e bashkisë Has ka kushtëzuar shumëllojshmërinë e tokave, të cilat, si në të gjithë vendin, ndryshojnë sidomos në drejtim vertikal. Në këtë drejtim dallohen tokat e kafenjta, të murrme pyjore dhe livadhore malore, ndërsa si nën tipa dallohen tokat aluvionale në luginat e lumenjve.

Tokat bujqësore në territorin e bashkisë kategorizohen nga PPK-ja si toka me përdorim kompleks (te përzierë). Të cilat janë të përqëndruara kryesisht në pjesën qendrore dhe jug- perëndimore të territorit të bashkisë. Aty ku tokat nën administrimin e bashkisë Has, lagen nga ujërat e liqenit të Fierzës, ku si rezultat kanë më shumë mundësi për zhvillimin e aktivitetit bujqësor.



*Fig.8. Sistemi Bujqësor*

Larmia e kushteve dhe faktorëve gjeo-klimatike që ka sipërfaqja e bashkisë Has ka kushtëzuar shumëllojshmërinë e tokave, të cilat, si në të gjithë vendin, ndryshojnë sidomos në drejtim vertikal. Në këtë drejtim dallohen tokat e kafenjta, të murrme pyjore dhe livadhore malore, ndërsa si nën tipa dallohen tokat aluvionale në luginat e lumenjve.

Në përfundim të analizës mundet të rendisim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e sektorit bujqësor:

## Anët e forta

- Klima e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë
- Kosto e lirë e krahut të punës
- Tradita historike familjare në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe eksperienca e përfituar në vite përbën një bazë të rëndësishme për sektorin
- Akses për tregun ndër rajonal dhe vendet fqinje

## Dobësitë

- Mungesë e infrastrukturës së përshtatshme bujqësore, mungesa e teknologjive të reja
- Problemet me pronën dhe fragmentimi i saj
- Efiçencë e ulët e podhimit për efekt të fragmentarizimit të tokës bujqësore dhe mungesa e kulturës së bashkëpunimit mes fermerëve
- Mungesa e pikave të grumbullimit të prodhimeve bujqësore
- Mungesa e promovimit të produkteve bujqësore dhe blegtoriale
- Kostoja e lartë e prodhimit dhe rendimenti i ulët i prodhimit gjeneron norma të vogla fitimi
- Përdorimi pa kriter i plehrave kimike apo i pesticideve ka shkaktuar humbje të produktivitetit të tokave

## Mundësitë

- Kërkesa e tregut për produkte BIO dhe të çertifikuara
- Bujqësia , një sektor me prioritet për qeverinë
- Mundësi për zhvillimin e agrobizneseve nëpërmjet zhvillimit të agroturizmit
- Interes në rritje për eksportin e bimëve medicinale dhe aromatike
- Skema e subvencionit nga Ministria e Bujqësisë dhe donatorëve të huaj

## Kërcënimet

- Mungesa e aftësisë për të bashkëpunuar dhe kooperuar mes fermerëve
- Mungesa e studimeve dhe orientimeve te fermereve për te kaluar nga bujqesia tradicionale dhe primitive ne bujqësine intensive dhe te integruar
- Fatkeqsite natyrore, semundjet dhe viruset e kulturave dhe mungesa e programeve dhe mjeteve te pershtateshme per parandalimin e tyre
- Mungesa e politikave afatgjate ne mbeshtetjen e sektorit te Bujqesise;
- Kostoja e larte e shpenzimeve te transportit
- Niveli I ulet I eksporteve si pasoje e perdorimit pa kriter te pesticideve
- Siguria ushqimore
- Konkurenca rajonale nga importet

## 6.3 SISTEMI NATYROR

Sistemi natyror i territorit të bashkisë Has përbëhet nga disa njësi natyrore karakteristike, siç jane: Gropa e Krumës, Pllaja e Hasit, lugina e lumit Drin i Bardhë, Mali i Pashtrikut etj.

Ne zonen e Bashkise Has si zone te mbrojtura njihen 30 monumente natyrore siç është Ahishtja e Likenit të Kuq dhe 30 ha rezervë natyrore e menaxhuar *"Tej Drini i Bardhë" VKM nr.102, datë 15.01.1996*. Zona të mbrojtura, me vendim të këshillit të ministrave nr.676 datë 20/12/2002 janë: Shpella Tindëlluese, Shpella në Mazrrek, Sofër dhe shpella e Dajçit, Vrella e Krumës, Brrudit, Domaj, Harhullës, maja e Qytezës dhe Pisha e Gjinajve.

Element i rëndësishëm i sistemit natyror të territorit është Mali i Pashtrikut i cili shihet si një resurs i rëndësishëm pyjor. Kjo zonë e lokalizuar në pjesën jugore të bashkisë, është një potencial i rëndësishëm në zhvillimin e turizmit pyjore, malor dhe lidhjes që mund të krijohet nëpërmjet itinerarëve lëvizëse si brenda territorit shqiptar në drejtim të liqenit të Fierzës që kufizon bashkinë në pjesën jug-perëndimore por dhe lidhjen ndërajonale drejt maleve të Kosovës në kufi me Hasin.



*Fig.9. Sistemi Natyror*

Në përfundim të analizës mundet të rendisim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e sektorit bujqësor:

### Anët e forta

- Burimet natyrore dhe biodiversiteti
- Peizazhet e pasura natyrore dhe panoramike
- Prania e parqeve natyrore, pyjeve
- Turizmi i lidhur me këto elementë natyrorë

### Dobësitë

- Mos mirëmbajtja e zonave natyrore
- Mungesa e sensibilizimit përvlerën e pasurive natyrore
- Shërbime me cilësi jo të mirë dhe mungesë të kapaciteteve pritëse
- Mungesa e bahskëveprimit mes autoriteteve publike dhe operatorëve turistike
- Ndotje mjedisore

### Mundësitë

- Mundësi për zhvillimin e turizmit malor
- Mundësi për zhvillimin e turizmit pyjor
- Mundësi për krijimin e iternerareve vozitëse

### Kërcënimet

- Ndotja
- Mungesa e kontrollit mjedisor
- Demtimi i pyje

## 6.4 SISTEMI UJOR

Në përgjithësi rajoni i Hasit ka rrjedhje të varfra ujore dhe kjo lidhet me reshjet nën mesataren e vendit 800-900mm dhe me ndërtimin nga formacionet terrigjene dhe ultrabazikë pak të përshkueshëm.



*Fig.10. Sistemi Ujor*

Hasi bën pjesë në basenin ujëmbledhës të Drinit, ku një pjesë e liqenit të Fierzës depërton në territorin e bashkisë, më saktësisht në pjesën perëndimore të tij. Kjo gjë mundëson shfrytëzimin e ujit të liqenit për vaditje në sektorin e bujqësisë, për këtë pjesë. Ndërsa vaditja e tokave bujqësore në pjesët e tjera të Hasit, bëhet me rezervuare artificialë të krijuar pas viteve 90'. Të cilët janë të tipit kaskadë të diktuar nga terreni malor. Gjithsej janë 9 të tillë me kapacitete te ndryshme ujëmbledhëse, të shtrirë nga veri-perëndimi dhe vazhdojnë shpërndahen drejt jugut të territorit të bashkisë Has.

Lumi i Krumës zë fill në burimin e madh karstik të Vrellës, që del në afërsi të qytetit homonim. Ky lumë ka një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 227km2, lartësi mesatare 687m dhe rënie të shtratit 22m/km, ndërsa gjatësia e tij është 26.5km. Ngritja e nivelit të ujit afër 100m të liqenit të Fierzës e ka reduktuar mjaft gjatësinë e tij. Burimi i madh karstik përbën edhe ushqimin kryesor

të tij. Në përgjithësi rrjedhja e këtij përroi është e varfër, gjëqë pasqyrohet në prurjen mesatare shumëvjeçare prej 1.96m3/sek, ndërsa moduli i rrjedhjes është 8-10lit/sek/km2.

Ndërhyrje të nevojshme:

-marrja e masave për evitimin e ndonjë ndotje mjedisore me pasoja për zonën
- marrje e masave, duke vlerësuar rrezikun potencial dhe duke hartuar projekte dhe vepra për mbrojtje nga përmbytjet apo erozionet për ato zona që janë të lokalizuara përgjatë lumenjve që rrjedhin nga malet drejt liqenit të Fierzës.

Në përfundim të analizës mundet të rendisim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e sektorit ujor:

**Anët e forta**

- Shfrytëzimin e ujit të liqenit për vaditjen e tokave bujqësore
- Është pjesë e basenit ujëmbledhës të Drinit
- Prania e një numri të Konsiderueshëm rezervuarve
- Prania e liqenit artificial të Fierzës përbën një atraksion turistik për zonë

**Dobësitë**

- Ndotje nga derdhjet e patrajtuara
- Kontroli sanitar i nevojshëm për t'u përmirësuar dhe shtrirë në të gjithë sistemin
- Mungesa e infrastruktës adekuate
- Mbrojtje nga përmbytjet apo erozionet për ato zona që janë të lokalizuara përgjatë lumenjve
- Ndotje mjedisore

**Mundësitë**

- Investime për të përmirësuar mbulimin me shërbime
- Riorganizim i përpunimit të ujërave
- Mundësi për krijimin e iternerareve vozitëse ujore

**Kërcënimet**

- Ndotja
- Rreziku i përmbytjeve gjatë peridhave të reshjeve të rënda në dimër/pranverë
- Lidhjet e shumta informale dhe të paligjshme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - TIRANË - SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - TIRANË - SEKRETARIA

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HAS

## 6.5 SISTEMI INFRASTRUKTUROR

Pjesë e sistemit infrastrukturor janë:

- Rrjetet rrugore të nivelit kombëtar, rajonale dhe lokale
- Linjat hekurudhore
- Porte e aeroporte
- Rrjetet teknologjike që përfshijmë: linjat e energjisë, tubacionet e gazit, ujësjellës, kanalizime



*Fig.11. Sistemi infrastrukturor Has*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS
TIRANE - ALBANIA

**Shërbimi i transportit**

Të dhënat nga Bashkia Has tregojnë se rrjeti rrugor rural përbëhet nga 172 km, nga ku 12.5 km janë të asfaltuara dhe 159.9km janë me çakëll. Vitet e fundit infrastruktura rrugore ka pësuar ndryshime të rëndësishme, si rezultat i rikonstruksionit dhe asfaltimit të rrugës shtetërore Nr. 23 dhe të rrugës së Vlahnës me gjatësi 6km. Megjithatë, rrjeti rrugor rural që lidh fshatrat me rrugën shtetërore ose me qendrat e njësive administrative, është në gjendje jo të mirë, i pa asfaltuar dhe me vështirësi kalimi gjatë stinës së dimrit.

Sot sistemi rrugor është në përmirësim e sipër, duke qënë se janë hapur trasetë kryesore në territor, por nevojë të madhe rregullimi kane rrugët lokale nëpër fshatra. Ato, për shkak të pozicionimit gjeografik të bashkisë dhe të braktisjes së shumë fshatrave janë lënë pas dore dhe nuk janë sistemuar në pjesën më të madhe të tyre, pavarëisht se gjurma e tyre sot ekziston.

**Furnizimi me ujë**

Furnizimi me ujë i popullsisë së bashkisë së Hasit është një ndër çështjet më shqetësuese. Zona ka pasuri ujore e veçanërisht burime uji të pijshëm, që dallohen për cilësi shumë të mirë si përmbajtja e ulët e mineraleve, ngarkesat e vogla mikrobiologjike, tejdukshmëri, freski, etj. Megjithatë problemi i ujit të pijshëm ngelet ende i pazgjidhur.

Në bashkinë Has paraqitet kjo situatë e furnizimit me ujë: në qytetin e Krumës kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë të pijshëm është vetëm 8 orë në ditë ose 22%. Vetëm 33.9% e popullsisë në Bashkinë Has furnizohet me ujë nga SHA Ujësjellës-Kanalizime ndërsa rreth
66.1% e popullsisë rurale nuk mbulohet me shërbim nga SHA Ujësjellës-Kanalizime. Kjo pjesë e popullsisë furnizohet me ujë nga disa ujësjellës të vegjël fshatrash të amortizuar në një pjesë të madhe të tyre, siç është ai i fshatit Zgjec, Cahan, Mujë-Dajç. Të tjera mënyra furnizimi janë disa burime të përbashkëta (burime apo çezma lagjesh apo fshati) dhe puse të hapura nga banorët por të cilat mbartin probleme të cilësisë së tij dhe mungesës së tij gjatë verës (Gjinaj, Pusi i Thatë).

**Furnizimi me energji elektrike**

Shpërndarja e energjisë elektrike përbën një nga sfidat më serioze. Plotësimi i kërkesës së popullsisë së bashkisë me energji elektrike përbën një faktor të rëndësishëm për zhvillimin esaj. Në bashkinë Hasfurnizimi me energji elektrike bëhet vetëm nëpërmjet instalimit të nënstacionit të Krumës me fuqi 10600 kV, i lidhur direkt me hidrocentralin e Fierzës. Vitet e fundit në rajon kanë filluar të shfrytëzohen resurset ujore për ndërtimin e min HEC-ve. Dy te tillë janë ndërtuar në fshatin Perollaj dhe Zgjeç me kapacitet 1.5 MVA dhe 4 MVA. Aktualisht bashkia Hast ka energji elektrike 24 orë, e mjaftueshme për të plotësuar nevojat e konsumatorëve, të bizneseve, të shërbimeve shëndetësore, etj. Problem mbetet amortizimi i nënstacionit dhe i rrjetit të transmetimit nga mungesa e investimeve të nevojshme. Më e rënduar paraqitet gjëndja në fshatra ku ka raste të ndërprerjes së energjisë elektrike pasi në fshatra baza energjetike është jashtë mundësive. Kjo e vështirëson edhe më shumë situatën gjatë periudhës së dimrit.

Në përfundim të analizës mundet të rendisim pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e sektorit infrastrukturor:

## Anët e forta

- Afërsia me rrugën Durrë-Kukës-Morinë
- Lidhja nërmjet Kosovës me Korridorin 10
- Afërsia me hubin ndërkombëtar të Kukësit

## Dobësitë

- Infrastrukturë e dobët në zonat rurale
- Akses i varfër në ujin e pishëm
- Lidhjet e paligjshme
- Mungesë e nyjeve të transportit

## Mundësitë

- Lidhje rajonale
- Përmirësimi i ujit të pijshëm
- Afërsia me qytetin e Kukësit

## Kërcënimet

- Fshatrat të caktuar të pa aksesueshëm gjatë peridhës së reshjeve të dëborës, me rrugë shpesh të pakalueshme
- Transporti publik i dobët

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

## 6.6 KONKLUZIONE PARAPRAKE

Si **avantazhe** (Strengths) të rëndësishme përmenden fillimisht:

- Mjedis i pasur dhe i qetë natyror me vlerë të rëndësishme kulturore dhe ekologjike
- Peizazhe të paprekura dhe të bukura.
- Afërsia me qendrën urbane Kukës e cila parashikohet të shndërrohet në një nga portat hyrëse të shqipërisë.
- Ekzistenca e njësive themelore të mikpritjes – ushqimit traditë të fortë dhe të gjatë kulturore.
- Burime të shumta të ujit të pijshëm të pastër, të përshtatshëm për amballazhim në shishe.
- Njohje e rajonit përmes produkteve të standartizuara bujqësore.

Më poshtë shënohen **pikat e dobëta** (Ëeaknesses) të Bashkisë dhe konkretisht:

- Mungesë nga territori i bashkisë i rrugëve kryesore kombëtare dhe ndërkombëtare - mungesë qasjeje e vendbanimeve jashtë rrjetit të rrugëve kryesore.
- Pamundësi për të tërhequr fonde të mjaftueshme për investime.
- Infrastruktura teknike urbane e papërshtatshme dhe të pamjaftueshme (p.sh. furnizimi me ujë, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave).
- Ulje e numrit të popullësisë dhe plakja e saj.
- Braktisja e vendbanimeve malore dhe fshatrat e largëta nga banorët e tyre.
- Numër i kufizuar dhe cilësi e ulët e infrastrukturës së turizmit dhe rekreacionit.
- Ndërtesa të shpërndara jashtë kufijve zyrtarë dhe ekzistenca e ndërtesave informale.

**Potenciali më i rëndësishëm i zhvillimit - mundësi** (Opportunities) të rajonit, në raport edhe me ambientin e jashtëm, përmblidhen në:

- Hapësira përmirësimi i rrjetit të brendshëm rrugor (lidhje e selisë me njesitë administrative) dhe lidhja rrugore me bashkitë fqinje.
- Tendencat të rritura të zhvillimit të ekoturizmit në vend dhe jashtë vendit.
- Zbatimi / Programim ndërhyrjeve të rëndësishme (a) rigjenerimit urban që rrisin funksionin dhe imazhin e qytetit të Krumës, (b) Infrastrukturës sociale që përmirësojnë jetën shoqërore dhe mundësitë rekreative, dhe (c) ndërtimin e banesave sociale për grupet në nevojë.
- Interesi i Bashkisë për projekte dhe investime për të krijuar vepra të reja dhe ndërhyrjeve në ekonomi, duke u fokusuar në format e buta dhe alternative të turizmit (p.sh. turizmi rural, turizmi dimëror).
- Kthimi i banorëve të cilët kishin emigruar brenda dhe/ose jashtë vendit me njohuri dhe mundësi financiare.
- Shfrytëzimi i trendeve ndërkombëtare të kërkesës për produkte cilësore lokake agro- ushqimore.
- Shfrytëzimi i instrumenteve financiare dhe fondeve nga BE dhe organizatat ndërkombëtare,
- Afërsia me destinacione kryesore dhe të njohura turistike.
- Bashkëpunim i mirë dhe i vazhdueshëm me bashkitë fqinje dhe institucione (p.sh. OJQ) për çështje që kërkojnë bashkëpunim ndër-bashkiak

## 7. VIZIONI DHE STRATEGJIA TERRITORIALE E BASHKIVE FQINJE

Si një qendër e re e krijuar me reformën e re territoriale, strategjia edhe vizioni i Bashkisë HASI nuk mund të vlerësohet i shkëputur nga bashkitë fqinje të saj. Bazë për një zhvillim të qëndrueshëm edhe në bashkëpunim me këto bashki fqinje më poshtë listojmë Vizonin dhe Strategjinë e 3 bashkive kryesore në kufij me këtë bashki.

### 7.1 KUKËSI:




*Fig.12. Vizioni i bashkisë Kukës*

*1. Vizioni i Bashkisë Kukës:* Promovimi i një zhvillimi territorial të integruar që mbështet zhvillimin ekonomik për një akses dhe cilësi shërbimesh më të mira me qëllim përmirësimin në kompleks të cilësisë të jetës

*2. Objektivat strategjike të bashkisë Kukës*

OS1- Zhvillimi policentrik bazuar në forcimin e hierarkisë së sistemve urbane

OS2 - Përmirësimi i sistemit të brendshëm dhe vlerësimi i lidhjeve ndër-rajonale dhe ndërkufitare

OS3 - Zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore në fushat e turizmit, energjisë dhe minierave

OS4 - Vlerësimi i zinxhirit të prodhimit vendor bazuar në sektorin e bujqësisë dhe zejtarisë

## 7.2 TROPOJA:

*7.2.1 Vizioni i Bashkisë:*Vizioni për të ardhmen e e Tropojës bazohet në leximin e kujdesshëm të aseteve lokale të rajonit dhe të kuptuarit të shfrytëzimit të tyre nevojitet të bëhet në përfitimin e ekonomisë dhe popullsisë vendase, pacënuar vlefshmërinë dhe mundësinë e përdorimit të tyre në të ardhmën.

*7.2.2 Objektivat Strategjike të Bashkisë*

**O1- Mbrojtja e Mjedisit**

O1S1 Ruajtja (konservimi) i biodiversitetit

O1S2 Menaxhimi i Zonave të mbrojtura dhe rrjetit ekologjik

O1S3 Ndikimi i ndryshimeve klimaterike

O1S4 Ndërhyrje rigjeneruese në zonat e paprekura

**O2-Ruajtja e vlerave kulturore**

O2S1 Mbrojtja dhe rehabilitimi i monumeteve të kulturës hde vendbanimeve fshatare

O2S2 Ruajtja dhe pasurimi i trashëgimisë kulturore

**O3-Zhvillimi i Turizmit**

O3S1 Promovimi i Territorit

O3S2 Përmirësimi i rrugëve turistike dhe arritshmërisë në vlerat natyrore dhe ato të trashëgimisë

O3S3 Zhvillimi i strukturave turistike

O3S4 Përmirësimi i shërbimeve turistike

**O4 Fuqizimi i bujqësisë dhe blegtorisë** O4S1 Përmirësimi i mjedisit bujqësor O4S2 Mbështetja e fermave organike

O4S3 Mbeshtetja e prodhuesve të vegjël dhe fermave

O4S4 Promovimi i bashkëpunimit

O4S5 Promovimi i tregtimit dhe prodhimeve ushqimore vendase

O4S6 Sigurimi i çertifikimit të produkteve vendase

O4S7 Promovimi i formimit profesional

**O5 Përmirësimi i aksesueshmërisë në territor dhe në lidhjet e brendshme**

O5S1 Përmirësimi i strukturës rrugore

O5S2 Përmirësimi i transportit ujor

O5S3 Përforcimi i lëvizshmërisë së përbashkët

O5S4 Përforcimi i lëvizshmërisë së lehtë

**O6 Konsolidimi i qendrave urbane dhe rurale** O6S1 Garantimi i arritshmërisë së hapësirave publike O6S2 Përmirësimi i shërbimeve të përbashkëta

O6S3 PËrmbushja e nevojave për strehim dhe përmirësimi i ofertës aktuale për strehim

O6S4 Dendësimi dhe konsolidimi i qendrave ekzistuese urbane dhe rurale

**O7 Përditësimi dhe krijimi i infrastukturës bazë urbane**
O7S1 Përmirësimi i infrastrukturës lokale
O7S2 Përmirësimi i rrjetit të shërbimit të ujësjellësit
O7S3 Ngritja e një sistemi kanalizimesh funksional për të gjithë territorin
O7S4 Ngritja e një sistemi funksional për grumbullimin e mbeturinave për të gjithë territorin
O7S5 Përmirësimi i rrjetit të telekomunikimit
O7S6 Përmirësimi i efektshmërisë energjitike

**O8 Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar**
O8S1 Mbrojtja e biodiversitetit
O8S2 Mbështetja e zhvillimit socio-ekonomik

## 7.3 FUSHE ARRËZ

Vizioni dhe objektivat strategjike te bashkisë Fushë Arrëz janë ende në fazë drafti. Por duke qenë bashki kufitare vizioni dhe strategjia e këtyre dy bashkive do të krijojë një lidhje territoriale midis tyre sidomos në zhvillimin e turizmit, resurseve natyrore dhe infrastrukturës lidhëse midis tyre.

## 8. VIZIONI DHE STRATEGJIA E HASIT

Përshkrimi i strategjisë territoriale është i ndarë në dy seksione:

- Strategjia territoriale e vendndodhjeve që integron në mënyrë transversale disa elemente kyçe që dalin nga leximi i territorit të 5 sistemeve territoriale (UB, IN, N, U, B);
- Objektivat dhe veprimet të ndara sipas pesë sistemeve te përmendura, me qartësinë që nuk bëhet fjalë për sektorë të izoluar dhe të pavarur, por të ndërlidhura ngushtë me njëri-tjetrin në të cilin zhvillimi i çdo sistemi individual drejton dhe është drejtuar nga të tjerët.

Këto elemente të vijnë së bashku në formulimin e një vizioni rajonal që, duke filluar nga analiza e mësipërme SWOT, shpreh objektivin kryesor drejt te cilit orientohen ndryshimet e viteve të ardhshme. Strategjia territoriale bazohet edhe në kërkesat zhvillimore derivuese nga PlaniKombëtar.

### 8.1 VIZIONI I BASHKISË

Në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Plani Kombëtar, hulumtimi në terren, strategjia është e bazuar në vizionin e Hasit si një qendër terciare e rëndësishme, portë hyrëse e Kukës-Has- Tropojë, i cilido të mbështesë dhe do të mbështetet nga qyteti i cilësuar nga PPK si qytet- portë Kukësi duke lidhur vetë territorin e Hasit dhe zonat përreth tij. Pikërisht si pjesë e këtij poli të zhvillimit, bashkia Has do të përfitojë nga zhvillime të fushave të ndryshme, të drejtuara kryesisht drejt infrastrukturës.

Kufizimi që ka në pjesën Jug-Perëndimore, Jugore dhe Jug-Lindore nga Liqeni i Fierzës, mundëson zhvillimin e turizmit liqenor dhe agro-turizmit, si dhe krijimit të itinerareve turistike. Zhvillimi i bujqësisë është një aspekt mjaft i rëndësishëm për bashkinë Has, ku prioritet për këtë zhvillim ka zona e Zahrishtit duke qenë se ndodhet afër liqenit të Fierzës. Gjithashtu në bashkinë Has vëmë re edhe praninë e puseve artificialë të cilat ndihmojnë në zhvillimin e bujqësisë edhe në zona të cilat prania e ujërave është e pakët. Vizioni në të cilën bazohet strategjia territoriale e Hasit është:

***PROMOVIMI DHE ZHVILLIMI I BASHKISË SI NJË QENDËR E RE TERCIARE,NË ASPEKTIN E BUJQËSISË, TURIZMIT, RRITJES SË AKSESUESHMËRISË DUKE PËRMIRËSUAR LIDHJET IINFRASTRUKTURORE MIDIS PORTAVE TË RËNDËSISHME KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE NË AFËRSI TË SAJ, SI EDHE ZHVILLIMI HAPËSINOR-FUNKSIONAL I VETË BASHKISË***



*Fig.13. Rajonalizimi i qendrave të banuara*

Nisur nga deklarata e Vizionit dhe potenciali i zhvillimit të Bashkisë Has, është strukturuar rajonalizimi i qendrave të banuara duke mbajtur dhe rritur rëndësinë e qytetit të Krumës, jo vetëm si qendër e bashkisë por si qytet lidhës midis qyteteve të tjera.

Gjithashtu me Krumën si qendër, vihet re ndarja e bashkisë në dy pjesë:

a) Pjesa Perëndimore me karakter bujqësor-blegtoral për shkak të zonave më të shumta të banuara dhe pranisë më të madhe të liqeneve artificiale, si dhe
b) Zona Lindore me karakter turistik, kryesisht atij malor. Kjo e fundit për shkak se në këtë pjesë vihet re më tepër prania e zonave pyjore ku spikat Mali i Pashtrikut, duke zbritur deri në lidhjen me liqenin e Fierzës.

Nisur nga ky vizion dhe përmes ripunimit të Analizës SWOT, u përcaktuan 5 objektiva strategjikë që veprojnë në mënyrë të integruar me qendrat e banuara dhe potencialin e bashkisë.




*Fig.14. Vizioni strategjik bashkia Has*

## 8.2. Objektivat strategjik

Objektivat strategjik për bashkinë Has janë konceptuar ne përputhje me realitetin lokal të kësaj bashkie si dhe me synimin që të arrihet përmbushja e vizionit strategjik brenda harkut kohor prej 15 vitesh, për sa kohë kjo PPV do të jetë në fuqi. Duke u mbështetur në rezultatet e analizës së gjëndjes ekzistuese si dhe nga konsultat me aktorët vendas, janë konceptuar 5 objektiva strategjikë të cilët do të ndihmojnë vënien në jetë të vizionit të hartuar më sipër.

- Objektivi strategjik 1 është "Mbrojtja e mjedisit", si një bashki që pjesën më të madhe të territorit e ka natyrë, mbrojtja e mjedisit është primare në aktivitetin bashkiak por dhe qytetar.
- Objektivi strategjik 2 është "Promovimi i aseteve kulturore dhe monumentale në Has për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit", si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë, turizmit në bashkinë e Hasit do ti shtohen fondin e tij dhe asetet kulturore dhe monumentale si pika atraktive duke i bërë pjesë të intinerareve turistike.
- Objektivi strategjik 3 është "Përmirësimi i buqësisë dhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase", një objektiv shumë aktual në kuadrin e rritjes së mundësisë së plotësimit të nevojave të tregut vendas por dhe tregëtimin e produkteve jashte territorit të bashkisë apo shtetit shqiptar
- Objektivi strategjik 4 është "Përmirësimi i shërbimeve publike", ky objektiv është konceptuar sidomos për përmirësimin e shërbimeve në zonat më periferike të bashkisë atje ku sot shumë prej shërbimeve publike mundojnë tërësisht.
- Objektivi strategjik 5 është "Përmirësimi i bahskëpunimit ndërkufitar të bashkisë si pasojë e pozicionit gjeografik të saj", ky objektiv është konceptuar në kuadër të strategjive kombëtare për turizmin dhe bashkëpunimin ndërbashkiak si dhe në kuadër të projekteve IPA të financuara nga bashkimi europian.
- Objektivi strategjik 6 është "Organizimi i hapësirës urbane të bashkisë", me anë të këtij objektivi strategjik vihet në fokus qyteti i Krumës si e vetmja hapësirë urbane në bashkinë e Hasit, qëllimi i këtij objektivi është drejtimi i zhvillimeve urbane konform parametrave kontemporanë të zhvillimit si dhe në përputhje me legjislacionin territorial shqipëtar.




*Grafiku.2. Diagrama e objektivave strategjikë*

## 8.3 Drejtimet kryesore të zhvillimit

Analiza e gjëndjes ekzistuese është baza kryesore për hartimin e Vizionit, i cili më vete është një përmbledhje e të gjitha propozimeve që lidhen me drejtimet e zhvillimit dhe objektivat strategjike.
Vizoni dhe strategjia percaktojne drejtimet e zhvillimit që do të ketë Bashkia e Hasit, konkretizuar në një plan zhvillimi. Por gjithsesi ky Plan Zhvillimi nuk shteron mundësinë e propozimit ose zhvillimit të projekteve, programeve apo objektivave të reja shtesë për realizimin e Vizionit. Përkundrazi, plani është i nevojshëm që të plotësohet sipas nevojave konkrete të cilat mund të lindin jashtë parashikimeve të tij.

Në proçesin e planifikimit, emergjencat e paparashikuara duhet të konstatohen, rivlerësohen në lidhje me planin, të bëhen rregullimet e nevojshme sipas udhëzimeve ligjore të planifikimit nëse është nevoja, dhe të implementohen masat e nevojshme që duhen marrë. Dokumenti i PPV-së duhet te kuptohet si një mjet orientues, jo garantues i zhvillimit, i cili ndihmon organet e qeverisjes vendore për t'u përqafuar me nevojat lokale për zhvillim dhe për të orientuar potencialet investuese vendore përmes një platforme të përbashkët me qytetarët, që është vetë dokumenti dhe instrumentet që dalin në funksion të tij.

Ndërkohë, për aplikimin e efektshëm të propozimeve të planit në territor, është i domosdoshëm verifikimi konkret i të dhënave të detyrueshme ligjore dhe të planit, me qëllim afrimin e tyre me giendjen ekzistuese në vend, si dhe konsultim të vazhdueshëm mes grupeve që preken perpara çdo vendim-marrjeje.

Rregullorja e Planifikimit te Territorit, në bazë të V.K.M. nr.686 të datës 22.11.2017, përcakton nevojën e formulimit të drejtimeve të zhvillimit të territorit të bashkisë. Këto drejtime janë specifike për fushën që mbulojnë, orientuese për të gjitha fazat e mëtejshme të planit.

Drejtimet e zhvillimit përfshijnë disa disiplina dhe përcaktojnë bazën në të cilën do të orientohet formulimi i politikave urbane, lidhja e objektivave me programet, përparesia për projekte të zhvillimit, e të tjera. Për Bashkinë e Hasit drejtimet e zhvillimit të territorit janë katër; *Infrastruktura, turizmi,bujqësia dhe mjedisi*. Këto drejtime zhvillimi marrin shkas nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i cili e cilëson rajonin Kukës-Has-Tropojë si porta lindore e rajonit malor verior.




*Grafiku.3. Diagrama e drejtimeve kryesore të zhvillimit*

### 8.3.1. Drejtimi i Zhvillimit të Ifrastrukturës

Në funksionin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike përfshihen: shërbimi i furnizimit me ujë dhe i kanalizimeve, shërbimi i transportit dhe i infrastrukturës rrugore, shërbimi i rregullimit dhe administrimit të mbetjeve urbane, shërbimi i ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave arsimore/shëndetësore, shërbimi i planifikimit dhe zhvillimit të territorit, shërbimi i rregullimit dhe administrimit të hapësirave të gjelbra, dekorit etj.

**Transporti**

Rrjeti rrugor rural në bashkinë Has përbëhet nga 571 km, nga ku 25.8 km janë të asfaltuara dhe 545 km janë me çakëll. Në Has kalon rruga shtetërore nr. 23 me gjatësi rreth 57 km. Vitet e fundit infrastruktura rrugore ka pësuar ndryshime të rëndësishme, si rezultat i rikonstruksionit dhe asfaltimit të rrugës shtetërore nr. 23 dhe të rrugës së Vlahnës me gjatësi 6km.

Megjithatë, rrjeti rrugor rural që lidh fshatrat me rrugën shtetërore ose me qendrat e njësive administrative, është në gjendje jo të mirë, i pa asfaltuar dhe me vështirësi kalimi gjatë stinës së dimrit. Mungesa e fondeve dhe kapaciteteve ka sjellë probleme në mënyrën e organizimit të mirëmbajtjes së rrugëve rurale ndër vite. Fondi prej 1,527,000 lekë i parashikuar në buxhetin e 2016 si transfertë specifike për rrugët është i pamjaftueshëm, prandaj duhen kërkuar burime të tjera (si nga të ardhurat e bashkisë apo nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së komunitetit në mirëmbajtjen e sistemit rrugor rural).

Gjithashtu vihet re mungesa e një strukture efektive që përgjigjet për mirëmbajtjen e sistemit rrugor rural. Shihet prioritar rikonstruksioni me asfaltim i rrugës së fshatit Zarisht, Gjinaj, Nikoliq, Dobrunë dhe rehabilitimi i një seri rrugësh të tjera. Këto rrugë do i'u mundësonin banorëve të fshatrave lëvizje të lirë, nxjerrjen e produkteve bujqësore e blegtorale në tregjet e Krumës, Kukësit apo Gjakovës, rritje të numrit të turistëve në zonat turistike, dhe qasje më të mirë në arsim, shëndetësi, shërbime sociale dhe informacion etj.

Linjat e transportit publik në bashkinë e Hasit thuajse nuk ekziston, dallojmë që transporti me mjete publike si autobus, minibus apo taksi përfaqëson dhe përqindjen më të ulët nga mënyrat e transportit që zgjedhin banorët e kësaj bashkie për transportin në përditshmërinë e tyre. Linjat e transportit publik nuk ekzistorjnë, ky lloj transporti përfaqësohet vetëm nga transporti me minubuza privatë të cilët janë të regjistruar si taksi. Shihet e nevojshme krijimi i linjave urbane të transportit përgjatë rrugës Sh23 si dhe linja të fshatrave.

**Sistemi i furnizimit me ujë**

Uji ka një rol shumë të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe sigurimi i tij është kthyer në një nga sfidat më të mëdha botërore. Ai nënkupton pastërti, energji, por mbi të gjitha, dicka të sigurt për të pirë. Nga ky këndvështrim, Shqipëria mund të quhet një vend i bekuar. E megjithatë, ende një pjesë të mirë të popullatës nuk i ofrohet shërbimi i ujit, ndërkohë që edhe më fatlumët janë subjekt i ardhjes së ujit sipas orareve të caktuara.

Të dhënat tregojnë se furnizimi me ujë të pijshëm në bashkinë e Hasit është larg standardeve dhe objektivave të vendosur në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë 2011-2017. Vetëm 33.9% e popullsisë në Bashkinë Has mbulohet nga furnizimi me ujë nga Sh.A. Ujësjellësi. Popullsia urbane ose rreth 30.3% e popullsisë së Hasit mbulohet me shërbim 100 % nga Sh.A. Ujësjellësi, por edhe për zonën urbane vazhdimësia e shërbimit të furnizimit me ujë (orë/ditë) është 7-8 orë, ndërkohë që Strategjia për 2015 ka si tregues 16 orë dhe për 2016 18 orë.

Amortizimi i tejskajshëm i rrjetit që lidh konsumatorin familjar me rrjetin dytësor, si dhe mungesa e matësve ka sjellë humbje të mëdha në rrjet, konsum pa kontroll të ujit dhe faturim aforfe. Rreth 66.1% e popullsisë (popullsia rurale sipas klasifikimit administrativ) nuk mbulohet me shërbim nga Sh.A. Uj sjellës. Kjo pjesë e popullsisë furnizohet me ujë nga disa ujësjellës të vegjël fshatrash (të amortizuar në një pjesë të madhe të tyre, siç është ai i fshatit Zgjec, Cahan, Mujë-Dajç etj.), nga disa burime të përbashkëta (burime apo çezma lagjesh apo fshati), si dhe nga shumë puse të hapura nga banorët të cilat mbartin probleme të cilësisë së ujit dhe mungesës së tij gjatë verës (në Gjinaj e në Pus të Thatë). 10.2% e banesave të banuara janë pa asnjë lloj sistemi furnizimi me ujë.

**Sistemet e kanalizimeve dhe trajtimit të ujrave të zeza**

Ujërat me cilësi të dobët e rrezikojnë shëndetin e njerëzve dhe integritetin e ekosistemit, zvogëlojnë sasinë e ujit për pije ne dispozicion dhe zvogëlojnë prodhimtarinë ekonomike. Janë një numër i aktiviteteve natyrore dhe njerëzore si: bujqësia, industria, minierat, depozitimet e mbeturinave, rritja e popullatës, urbanizimi dhe ndryshimet klimatike që ndikojnë në karakteristikat biologjike, kimike dhe fizike të ujerave duke ulur ndjeshëm cilësinë e tyre. Në të kaluarën në shumë vende, kur sistemet publike të kanalizimeve nuk kanë qënë të mundura, e vetmja alternativë praktike ka qënë dhe vazhdon akoma, ndërtimi në vend i sistemit të trajtimit të ujerave të ndotura me gropa septike dhe absorbim në tokë, por jo të gjithë situatat, apo strategjitë e planifikimit në zonat rurale, janë të përshtatshme për ketë tip.

Prurjet e kohës në trajtimin teknologjik të ujërave të ndotura dhe të adaptimit të strategjive të reja të menaxhimit, kanë sjellë alternativa dhe opsione të reja për zonat rurale, të cilat, në ketë punimin janë marre parasysh, duke vlerësuar me shumë kujdes te gjitha opsionet dhe përshtatjen e tyre në dobi të komunitetit, për të arritur në një përafrim të kënaqshëm si të shpërndarjes së kostove ashtu dhe të përgjegjësive të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së ndërtimeve për trajtimin dhe eliminimin e ujërave të ndotura.

Bashkia ka një rrjet kanalizimesh prej 180 ml në qytetin e Krumës, i cili është përgjithësisht në gjëndje të mirë si pasojë e rikonstruksionit të plotë në magjistralin kryesor të ujërave të zeza. Disa probleme shqetësuese që vërehen janë: mungesa e ndërgjegjësimit të publikut për rrezikun nga mbetjet, derdhja e ujërave të zeza të patrajtuara direkt në lumin Kruma, amortizimi i kolektorit të ujërave të zeza në pjesën lindore të tij, mungesa e një rrjeti të organizuar të kanalizimeve dhe i trajtimit të ujërave të zeza në zonën rurale dhe mos pagesa e tarifës së pastrimit që sjell ulje të kapaciteteve financiare të bashkisë.

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza i ndërtuar kohët e fundit që përfshin Krumën, Vranishtin, Fajzën, Liqenin e Kuq dhe Zahrishtin, nuk është akoma 100% finksional. Ky rrjet funksionon vetëm për qyetin e Krumës ndërsa në këto fshatra dhe të tjerët ku nuk ka rrjet KUZ punohet me gropa septike.

Ashtu si rrjeti i ujësjellësit dhe rrjeti i KUZ është në një situatë shumë të prapambetur, ku vërjmë gjithastu të njëjtët vënbanime që kishin ujësjellës kanë dhe rrjet KUZ, kjo nga vetë fakti që këto dy rrjete projektohen dhe instalohen njëkohësisht. Megjithse ekziston rrjeti i KUZ për Krumën, Zahrishtin, Vranizhtin, Liqenin e Kuq, Fajzen dhe Fshat Krumë, ai shërben vetëm për transportimin e ujrave të zeza pasi mungon sistemi i trajtimit të tyre duke i derdhur ato direkt në lumin Kruma. Ndërsa pjesa tjetër e vendbanimeve nuk kanë rrjet KUZ dhe përdorin gropat septike private. Të cilat ashtu si dhe derdhja e pa trajtuar e ujrave të zeza nga rrjeti i KUZ cojnë në ndotjen e mjedist dhe helmimin e tokave bujqësore dhe ujërave nentokësore.

GJEOKONSULT & C
NIPT: K 13100050
TIRANA - ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

**Sistemi ujitës**

Kanali ujites Helshan

Furnizimi me ujë i këtij kanali bëhet nga rezervuari Helshan-4, kapaciteti ujëmbajtës i të cilit është 210 000 m3. Nga ky objekt marrin ujë për vaditje 280 familje të njësisë administrative Golaj. Gjatësia kanalit është 5.7 km, fillon tek rezervuari Helshan, përshkon 2 lagje dhe përfundon në fund të fshatit. Kanali ka një kapacitet 140 litra ujë në sekondë dhe vadit 70 ha tokë. Gjendja fizike e kanalit është e dëmtuar dhe jashtë funksionit. Kanali është ndërtuar në vitin 1972 dhe që nga ajo kohë ai nuk është përfshirë asnjëhere në rikonstruksion. Kjo ka sjell që kanali të jetë tërësisht i amortizuar duke shkaktuar rrjedhje dhe humbje të mëdha uji, prurje të pakta të ujit në parcelë dhe gjenerimin e konflikteve mes fermerësh.

Kanali ujites Letaj-Peraj-Zgjec

Kanali furnizohet me ujë nga rezervuari Letaj, i cili ka një kapacitet ujëmbajtës 1.300.00 m3 ujë. Kanali ka gjatësi 10.8 km dhe kapacitet 400 deri në 160 litra ujë në sekondë, vadit 250 ha toke bujqësore dhe përdoret nga 321 familje të njësisë administrative Golaj të fshatrave Letaj-Peraj- Zgjeç. Kanali është ndërtuar në vitin 1972 dhe që nga ajo kohë ai nuk është përfshirë asnjëherë në rikonstruksion. Kjo ka sjellë që kanali të jetë i amortizuar duke shkaktuar rrjedhje dhe humbje të mëdha uji, prurje të pakta të ujit në parcelë, ulje të interesit për t'u marrë me kultivimin e kulturave bujqësore si dhe ulje të rendimenteve bujqësore etj.

**Menaxhimi i mbetjeve të ngurta**

Zona e Hasit është një nga zonat më të pastra në vend në sajë të kontributit të qytetarëve dhe autoriteteve vendore. Pavarësisht kësaj, bashkia është duke u përballur me rritjen e prodhimit të mbetjeve dhe vështirësi në mirë-administrimin e tyre për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare dhe mungesës së kapaciteteve. Nga studimi i projektit INPAEL prodhimi i mbetjeve në Krumë është 0.7 kg/ person/ditë. Në planin e menaxhimit të mjedisit Krumë 2012 norma mesatare e prodhimit është rreth 250 kg për banor/vit në zonat urbane dhe 170 kg në zonat rurale. Sipas këtij plani, norma në zonat urbane përputhet me studimin e projektit INPAEL (0.7 kg), ndërsa në zonat rurale është 0.46 kg/person/ditë.

Nga këto tregues, në Has prodhohen rreth 4700 ton/vit mbetje familjare. Nuk ka të dhëna për sasinë e mbetjeve inerte dhe spitalore. Vendosja e koshave të rinj në qytetin e Krumës ka përmirësuar dukshëm grumbullimin e mbetjeve, por mungon selektimi në origjinë. Bashkia ka një sektor për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve dhe përdor si vend të hedhjes së tyre, gropën grumbulluese Qafë-Barak, e cila është jashtë standardeve të kohës (pasi është një vend grumbullim i hapur dhe i pa rrethuar). Kjo përben një kërcënim për mjedisin, cilësinë e ajrit dhe shëndetin e banorëve. Nuk ka asnjë procedurë të veçantë për trajtimin e mbetjeve shëndetësore. Në zonat rurale trajtimi i pjesës më të madhe të mbetjeve bëhet duke i hedhur pa kriter anash rrugëve, kanaleve dhe duke i djegur ato në mjedis të hapur.

**Rrjetet teknologjike**

Furnizimi me energji elektrike

Bashkia Has furnizohet me energji elektrike nëpërmjet nënstacionit të Krumës, i lidhur direkt me hidrocentralin e Fierzës. Vitet e fundit kanë filluar të shfrytëzohen resurset ujore për ndërtimin e HEC-ve. Dy Hece janë ndërtuar në fshatin Perollaj dhe Zgjeç. Bashkia Hast ka energji elektrike 24 orë, e cila mjafton për të plotësuar nevojat e konsumatorëve, të bizneseve, të shërbimeve shëndetesore, etj. Problem mbetet amortizimi i nënstacionit dhe i rrjetit të transmetimit nga mungesa e investimeve të nevojshme. Në fshatra situata paraqitet më e rënduar ku ka raste të ndërprerjes së energjisë si pasojë e gjendjes të rrjetit të shpërndarjes. Situata në këto fshatra vështirësohet akoma më sumë në periudhën e dimrit.

Përqindja e përdorimit të pajisjeve elektro-shtëpiake në vitin 2011 për Hasin ka pasur një rritje me 32% krahasuar me vitin 2011. Sipas të dhënave rritjen më të madhe e kanë pajisje si frigoriferët, lavatriçet, televizorët, celularët dhe dushet elektrikë. Familjet që nuk posedojnë asnjërën nga këto pajisje janë 186 familje, pra, 6.13% të familjeve që kanë të ardhura të pakta ose nivel shumë të ulët ekonomik.

<u>Shërbimi postar dhe telefonik</u>

Shërbimi postar dhe telefonik në bashkinë e Hasit i ka fillesat në kohën e prefekturës së Kosovës me qendër në fshatin Krumë. Në bashkinë Has gjatë periudhës 1954-1990 u mbulua zona me rrjet telefonik i cili përbëhej nga aparatura të vjetërsuara që lidheshin me linja ajrore telefonike manuale. Pas viteve '80 kjo linjë u zëvendësua me radio-rele disa kanaleshe të cilat mundësuan automatizimin. Në periudhën mes viteve 1992-2002 në mbështetje të master-planit për "Zhvillimin e telekomunikacionit", u bënë instalime të reja dhe moderne të centraleve dixhitale. Shërbimi i telefonisë celulare në rajonin e Hasit realizohet nga kompani si AMC, që u instalua në vitin 2000 apo VODAFONE që u instalua në vitin 2002 dhe që mbulon të gjithë territorin.

Shërbimi postar në Hasit paraqitet mirë në qendër, ndërsa në fshatra vërehen vonesa nga mungesa e tetë njësive postare pa ambiente pune. I gjithë rajoni ka shërbimin e internetit duke përbërë një argument për përmirësim të shërbimeve, duke u ofruar nga kompania TELEKOM. Pjesa më e madhe e territorit në të gjithë rajonin furnizohet me sinjale satelitore televizive private të vendit dhe nëpërmjet valëve të televizioneve kosovare.

### 8.3.2. Drejtimi i Zhvillimit të Bujqësisë

Nga analiza e bërë mbi propozimet dhe qasjen e PPK-së në lidhje me sistemin bujqësor të Hasit. Rezulton se kjo bashki nuk futet në grupin e bashkive prioritare në lidhje me buqësinë. Pozita gjeografike që ka dhe terreni kodrinoro-malor e bën që sipërfaqja e punueshme të jetë shumë e vogël. Këtë gjë mund ta shohim edhe nga statistikat, sipas të cilave qarku i Kukësit ku përfshihet dhe Bashkia Has, është qarku me nivelin më të ulët të prodhimit buqësor në shkallë vendi.

Gjithsesi direktivat e PPK-së janë që në të gjitha rastet toka buqësore të ruhet dhe zhvillohet duke shfrytëzuar në maksimum potencialin që kjo zonë ka për zhvillimin e buqësisë. Me këtë qëllim rekomandimet që degët e buqësisë që shfaqin më shumë mundësi për zhvillim në bashkinë Has, janë pemtaria (frutikultura) dhe kultivimi i bimëve medicinale. Ndërsa për sa i përket blegtorisë shihet me prioritet mbarështimi i dhive, si një karakteristikë e trashëguar e aktivitetit blegtoral në zonë.

Avantazh tjetër për zhvillimin e bujqësisë në territorin e bashkisë Has, shihet dhe pozita gjeografike që ka në lidhje me Kosovën, si dhe mundësia e lidhjes nëpërmjet Kukësit me polin bujqësor të Dibrës, i propozuar nga PPK. Tokat bujqësore në territorin e bashkisë kategorizohen nga PPK-ja si toka me përdorim kompleks (te përziera). Të cilat janë të përqëndruara kryesisht në pjesën qëndrore dhe jug-perëndimore të territorit të bashkisë. Aty ku tokat nën administrimin e bashkisë Has, lagen nga ujërat e liqenit të Fjerzes, ku si rezultat kanë më shumë mundësi për zhvillimin e aktivitetit bujqësor.

Megjithatë, vihet re se produktiviteti i zonës së studimit nuk është shumë i lartë sot. Për shkak të karakterit malor të zonës, aktiviteti bujqësor ushtrohet është i kufizuar. Në përgjithësi, vlen të përmendet se 80% e prodhimit bujqësor dhe blegtoral përdoret për të plotësuar nevojat e prodhuesve, ndërsa një pjesë shumë e vogël disponohet në treg. Numri i bimëve ushqimore që mund të kultivohen në territorn e bashkisë së Hasit

janë të kufizuara ndër to dallojmë kulturën e misrit, patates dhe pemëve ftutore gjithashtu janë vënë re dhe vreshtat me rrush të zhvillohen kohët e fundit.

### 8.3.3. Drejtimi i Zhvillimit të Turizmit

Në dekadën e fundit, turizmi është parë si një mundësi për zhvillimin ekonomik të zonës nga të gjithë ish-njësitë vendore. Pavarësisht se të gjitha njësitë kishin në vizionin, synimet dhe projektet tyre, zhvillimin e turizmit, ai mbetet në hapat e para të zhvillimit të tij për shkak të infrastrukturës së papërshtatshme, promovimeve të pakta të vlerave turistike të zonës, mungesës së kushteve të akomodimit të turistëve, mungesës së qendrave të informacionit turistik, ciceronëve, tabelave në terrritor etj.

Një nyje e rëndësishme turistike është dhe fshati Cahan, si pjesë e projektit "100 Fshatrat", në të cilin propozohet të ruhen dhe rigjenerohen të gjitha banesat duke u dhënë atyre funksion mikpritës (bujtina). Implementimi i propozimeve të këtij projekti në këtë fshat do ta kthejë Cahanin në një pikë të fortë të industrisë së turizmit në territorin e Hasit. Për këtë shihet me prioritet dhe ristrukturimi i rrugës Krumë-Cahan, njëkohësisht projekti për Cahanin mund të merret dhe si shembull zhvillimi për fshatra të tjerë në këtë Bashki.

Hasi ofron një potencial të madh turistik për shkak të pozicionit gjeografik, vlerave të larta natyrore dhe aspekteve të shumta historike e kulturore. Në planet e zhvillimit të dy ish-NjQV (Golaj dhe Krumë) përmendet si objektiv i përgjithshëm zhvillimi "Të rriten mundësitë për zhvillimin e turizmit...". Tek "Plani i menaxhimit të mjedisit -Bashkia Krumë" është hartuar plani i menaxhimit të resurseve dhe të infrastrukturës turistike. Dy guida turistike rajonale kanë një kapitull për Hasin. Zhvillimi i turizmit është frenuar nga infrastruktura rrugore e papërshtashme, mungesa e promovimit dhe informacionit të vazhdueshëm turistik, mungesa e përvojës dhe kapaciteteve akomoduese, si dhe nga mungesa e një strukture administrative përgjegjëse për turizmin në zonë.

### 9.3.4. Drejtimi i zhvillimit të Mjedisit

Plani i përgjithshëm vendor për bashkinë e Hasit e konsideron mjedisin natyror si bazën në të cilën mbështeten të gjitha aktivitet e tjera njerëzore dhe si i tillë ai duhet të jetë sa më i qëndrueshëm dhe frytdhënës. Për këtë arsye në mënyrë që të theksohet akoma më shumë rëndësia që ka kujdesi dhe mirëmbajtja e mjedisit natyror, "Zhvillimi i Mjedist" është menduar si një nga drejtimet kryesore të zhvillimit që parashikohet nga vizioni për bashkinë Has.

**GROPA E KRUMËS**

E gjendur në pjesën qendrore të territorit të bashkisë Has ajo ka origjinë tektonike. Në pamje të përgjithshme ajo ka formën e një amfiteatri të madh natyror, e rrethuar nga kurora e relievit gjysmëmalor e kodrinor, që hapet gjërësisht nga jugperëndimi në luginën e lumit Drin. Kjo gropë ka shtrirje verilindje-jugperëndim, sipërfaqe 227 km2 dhe lartësi mesatare 450-500m mbi nivelin e detit

**PLLAJA E HASIT**

Me sipërfaqe 126 km2, ajo shtrihet në skajin juglindor të malësisë dhe ka lartësi mesatare prej 900-1000m mbi nivelin e detit. Përbëhet nga formacione gëlqerore të kretës së sipërme dhe dallohet për shkallën më të madhe të diferencimit tektonik në krahasim me njësitë e tjera. Kjo pllajë është modeluar mbi një pllakë karbonatike të vendosur mbi shkëmbinj ultrabazikë me gjerësi dhe trashësi më të madhe tek maja e Pashtrikut (1989 m). Trashësia e saj rritet, nga 400-500m në jugperëndim deri në 800-1000m në verilindje. Janë pikërisht thyerjet tektonike shkëputëse që i kanë dhënë pllajës së Hasit karakter diferencues mes pjesës jugperëndimore (më të ulur) dhe pjesës verilindore (më të ngritur) të Pashtrikut.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

**LUGINA E LUMIT DRINI I BARDHË**
Nga fshati Gjonaj e deri në hyrje të territorit shqiptar, për shkak të ndryshimit të formacioneve nga depozitimet e piocen-kuaternarit në gëlqeroret e kretakut, lugina ngushtohet dhe hera herës merr tiparet e një kanioni.

## 8.4 Objektiv Strategjik 1 - Mbrojtja e mjedisit

Ruajtja e një standarti të lartë të një mjedisi të pastër dhe të pasur është një ofertë shtesë që bashkia e Hasit u ofron banorëve të saj si dhe vizitorëve të kësaj bashkie. Në një kohë kur qendrat e mëdha të banuara si Tirana, Durrësi etj, sot vuajnë nga një ndotje disa herë më të lartë se norma e bashkimit europin për zonat urbane. Në këtë kuadër Bashkisë i lind detyra që të marë masa për ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit natyror ashtu dhe infrastrukturave që bashkëlidhen me të.

Gjithashtu mbrojtja e mjedisit kërkon:
- Krijimin e një koncepti të ndarjes që në burim, të mbetjeve urbane, sipas një kompozimi "praktik" të koshave të riciklimit, në përputhje me strategjinë e Ministrisë së Mjedisit si: Të riciklueshme(të thata); Organike/të ndryshme (të njoma); Të rrezikshme;
- Ndërtimi i landfilleve, duhet të bëhet me kritere tepër rigoroze si gjeologjike edhe teknike, nën mbikqyrjen dhe përgjegjësine e plote të specialistëve të kësaj fushe.

Në përmbledhjen e objektit strategjik numër 1 si më poshtë sugjerojmë:
- Propozimi i krijimit të zonave të mbrojtura si: pyjet e Hasit , me rrezik natyror, të përhapura në bjeshkën e Krumës, Vranishtit, Gjinajve, Dajçit Mujajve, Cahanit & Kishajve etj
-Ruajtja e bimëve mjekësore që rrezikojnë të zhduken, si sherebeli
- Ruajtja edhe mbrojtja e pyjeve nga shpyllëzimi dhe djegia
- Shfrytëzimi i florës së pasur për rritjen e bletëve
- Përcaktimi i kufijve të saktë të zonave natyrore për të mos lejuar ndërtim

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË




*Grafiku.4. Diagrama e zbërthimit të "Objektivit strategjik 1"*

### 8.4.1 Programet strategjike për OS1

Hasi dallohet për larmishmëri të formave të relievit si gropa e Krumës, rrafshi i Planit, Bregu i Vlahnës deri tek qafat dhe majat më të larta. Bashkia ka reliev kodrinoro-malor, me lartësi mesatare 400-500 m mbi nivelin e detit dhe me kontraste të mëdha. Lartësia më e ulët mbi nivelin e detit është 296 m në bregun e liqenit të Fierzës, ndërkohë lartësia më e madhe është 1988 m në malin e Pashtrikut. Pyjet dhe kullotat zënë rreth 83.5 % të sipërfaqes dhe shtrihen në lartësitë mbi 1000-1200 m.

Hasi ka një rrjet të pasur lumor i cili karakterizohet nga përrenj të vegjël që furnizohen kryesisht nga reshjet e shiut dhe të dëborës. Nga periudha 1945-1990 Hasi gjithashtu trashëgoi një pasuri të madhe ujore siç janë numri i madh i rezervuarëve të lidhur me një rrjet të gjerë kanalizimesh. Sipërfaqja ujore e rrethit të Hasit përbëhet nga 24 rezervuare që ujitin 23% të tokës bujqësore. Gjithashtu përshkohet nga disa përrenj më i madhi

i të cilëve është Kruma, gjatësia e të cilit llogaritet të jetë 6 km, me shumë degëzime, që derdhet në Drinin e bashkuar. Shumë të rëndësishme janë gjithashtu edhe vrella e Brrudit, Domaj dhe vrella e Harhullës që furnizojnë me ujë të pijshëm fshatrat përkatës. Disa nga përrenjtë e rrethit të Hasit janë përroi i Skatinës (14 km), I Vlahnës (13 km ), Rosmanit (11 km), Shirzës, Spahisë, dhe Tërshanës. Rëndësi të madhe ka edhe kufizimi me Liqeni i Fierzës që do të thotë një pasuri shumë e madhe ujore për fshatrat Zahrisht, Metaliaj duke ndikuar fuqishëm në zhvillimin e turizmit sidomos në fshatin e Zahrishtit ku shihet prespektivë edhe në sektorin e peshkimit.

Rrethi i Hasit ka pasuri të shumta minerare përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë, magmatikë dhe metamorfikë kjo lidhet me pasuritë e shumta minerare në këtë zonë. Sasia më e madhe e Kromit ndodhet në Vlahen dhe vendburimi lokalizohet në masivin ofiolitik Tropojë-Has duke u lidhur me vend-burimet e Kam-Tropojës për nga lokalizmi dhe tregu me Qafë Prushin. Fshatrat Vranisht, Vlahen dhe së fundmi Cahan njihen për nëntokë të pasur me Fe-Ni.



*Fig.15. Foto nga mjedisi natyror Has*

Menaxhimi i mbetjeve është një tjetër problem por me vendosja e koshave të rinj në qytetin e Krumës ka përmirësuar dukshëm grumbullimin e mbetjeve, por mungon selektimi në origjinë. Bashkia ka një sektor për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve dhe përdor si vend të hedhjes së tyre, gropën grumbulluese Qafë-Barak.

Në zonat rurale trajtimi i pjesës më të madhe të mbetjeve bëhet duke i hedhur pa kriter anash rrugëve, kanaleve dhe duke i djegur ato në mjedis të hapur. Më poshtë paraqiten programet strategjike dhe zbërthimi i tyre në projekte strategjike të parashikuara për plotësimin e Objektivit Strategjik 1.

<u>1.1. Mbrojtja e resurseve ujore</u>

1.1.A. Projekt – "Pastrimi dhe mbrojtja e lumit Drin", projekt që konsiton në evidentimin e zonave përgjatë lumit ku ka depozitime te mbetjeve urbane, rreshkitje të dherave apo pengesa të tjera që bejnë që lumenjtë të ndoten dhe të kethehen në rrezik për mjedisin dhe njeriun si dhe marrja e masave për pastrimin e mbetjeve dhe përforcimin e luginave të këtyre lumenjve në zonat me rrezik për rrëshkitje.

1.1.B. Projekt - "Pastrimi dhe mbrojtja e lumit të Krumës", projekt që konsiton në evidentimin e zonave përgjatë lumit ku ka depozitime të mbetjeve urbane, rrëshkitje të dherave apo pengesa të tjera që bëjnë që lumenjtë të ndoten dhe të kthehen në rrezik për mjedisin dhe njeriun si dhe marrja e masave për pastrimin e mbetjeve dhe përforcimin e luginave të këtyre lumenjve në zonat me rrezik për rrëshkitje.

1.1.C. Projekt - "Rehabilitimi i shtratit të Lumit Kruma dhe krijimi i një shëtitore përgjatë segmentit nga burimi deri tek ura në rrugën SH23", ky projekt konsiston në sistemimin dhe rehabilitimin e shtratit të këtij lumi në tërësi si dhe krijimin e një pedonaleje në segmentin nga burimi deri tek ura në rrugën Sh23 duke e përfshirë atë duke i shtuar mbrojtje nga rrëshkitjet si dhe nga fryrjet e ujit që pëson në sezonin e dimrit. Si një zonë ku shtrihet Kruma e vjetër e karakterizuar nga banesat tip vile rehabilitimi i shtratit të lumit si dhe shëtitorja përgjatë tij do të përbëjnë një atraksion si për vendasit ashtu dhe turistët.



*Fig.16. Segmenti i lumit Kruma ku propozohet ndërtimi i pedonales*

1.1.D. Projekt - "Zyrtarizimi i ditës së lumenjve (organizimi i aktiviteteve për pastrimin, ekskursione, etj.)", me zyrtarizimin e ditës së lumenjve nga ana e bashkisë Has do të mundësohet krijimi i një dite me aktiviteteve social kulturore me temë lumenjtë. Ky projekt do të përfshijë në aktivitetet që do të zhvillohen të gjithë banorët

e Hasit dhe në veçantëi të rinjtë dhe nxënësit e shkollave. Të gjithë të interësuarit do të behën pjesë e programit që do të hartohet nga bashkia me rastin e kësaj dite, duke prezatuar punime të tyre në sfera të ndryshme si të artit, shkencës, kulturës apo duke u përfshirë në aktivitete sportive që bashkia do të ideojë me këtë rast. Përveç faktit se ky projekt do të rrisë ndjeshmërinë qytetare ndaj lumenjve dhe hapësirave të përbaëshkëta do ti krijojë mundësinë bashkisë Has ta shfrytëzojë dhe si një atraksion turistik shtesë.

1.1.E. Projekt - "Ngritja e pritave për sedimentet përgjatë rrjedhave ujore", vendosja e këtyre pritave do të sigurojë që të mos krijohen grumbullime sedimentesh të sjella nga rrjedha e lumenjve të cilët jo rrallë herë janë bërë shkaktarë për daljen nga shtrati të lumenjve sidomos në sesonin e shirave.

1.1.F. Projekt - "Vendosja e barrierave pritëse për mbetjet urbane ne degëzimet e lumit Drin në brendësi të bashkisë", në kuadrin e mbrojtjes së mjedisit, bashkia Has duhet të sigurohet të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda mundësive të saj ligjore dhe kapaciteteve ekonomiko-profesionale që ajo zotëron, në dhënien e kontributit të saj në mbrojtjen e mjedisit jo vetëm ne kufijtë e saj por dhe atë jashtë këtyre kufijve. Ndaj projekti në fjalë konsiston në vendosjen e barrjerave që filtrojnë mbetjet urbane që mund të derdhen në këto sipërfaqe. Ato do të montohen tërthor me rrjedhën e ujit në degëzimet e lumit Drin të cilat zgjaten në territorin e bashkisë, në mënyrë që të mos lejojnë derdhjen e mbetjeve direkt në lumin Drin.



*Fig.17. Pikat e vendosjes së barrjerave pritëse*

Këto barrjera përveç grumbullimit të mbetjeve do të mundësojnë dhe pastrimin e tyre në momentin që kanë arritur kapacitetin e tyre mbajtës, ose në raste kur vërehen fryrje të ujit dhe mbetjet e grumbullura mund të përbëjnë pengesë për rrjedhën e ujit. Administrimi i tyre ti lihet drejtorisë së pastrimit të mbetjeve urbane pranë bashkisë, ku të ngrihet një grup i posaçëm që veç të tjerash do të merret me pastrimin dhe mirëmbjtjen e tyre.

<u>1.2. Ruajtja dhe mirëmbajtja e resurseve natyrore</u>

1.2.A. Projekt – "Plan menaxhimi për zonat e livadheve", me anë të këtij projekti bashkia e Hasit do të krijojë një plan të mirëfilltë masash të cilat do të mundësojnë mbrojtjen e livadheve nga faktorët natyrorë apo dhe ata humanë. Vënia në zbatim të këtij plani masash do tu sigurojë fermave dhe individëve që merren me mbarështimin e kafshëve blegtorale sipërfaqet e nevojshme ku të kullosin dhe të gjejnë ushqim për kafshët e tyre në formën e tij natyrale.
"Plani i menaxhimit për zonat e livadheve" do të parashikojë masat për mbrojtjen:

- e livadheve nga zjarret
- nga ndotja
- nga erozioni
- keqpërdorimi i tyre nga njeriu me synimin e kullotjes së bagëtive
- nga zaptimi, duke përcaktuar në hartat përkatëse dhe në terren kufijtë e saktë të tyre etj.

1.2.B. Projekt – "Hartimi i planit lokal për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane", e nevojshme në bashkinë e Hasit është hartimi i një plani afat mesëm të qartë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane, nga ku bashkia të marrë përsipër realizimin e tij me fonde lokale apo te formave të tjera. Me anë të këtij plani bashkia Has do të përcaktojë saktësisht cilat janë zonat më të ndotura në territorin e saj dhe veprimet që duhet të ndërmerren me qëllim pastrimin e tyre. Gjithashtu ky plan do të vlerësojë nevojën dhe shpërdarjen e koshave për grumbullimin e mbeturinave nëpër vendbanimet e bashkisë Has, sidomos në ato rurale ku aktualisht mungojnë. Njëkohësisht do të vlerësojë nevojën për kamiona për grumbullim-transport të mbetjeve si dhe intervalet kohore gjatë të cilëve do të bëhet transporti i mbetjeve nga koshat e mbeturinave drejt pikës së grumbullimit.

1.2.C. Projekt – "Ristrukturimi dhe higjenizimi i pikës ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve urbane", ndërtimi i një infrastrukture të mirëfilltë në pikën ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve do të rriste cilësinë e shërbimit si dhe do të minimizonte ndotjen e mjedisit qe vjen si pasojë e dekompozimit të mbetjeve në mjedis pa kaluar në asnjë filtër trajtimi.




*Fig.18. Pika e grumbullimit të mbetejeve Has*

<u>1.3. Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve nga shpyllëzimi</u>

<u>1.3.A.</u> Projekt – "Krijimi i pikave të vrojtimit për kontrollin e sipërfaqeve pyjore të bashkisë", ky projekt konsiston në ndërtimin e disa pikave të vrojtimit të cilat do u vijnë në ndihmë punonjësve të bashkisë për të kontrolluar aktivitetet njerëzore dhe natyrore në sipërfaqet pyjore të bashkisë, të cilat sjellin dëmtim të këtyre sipërfaqeve. Konstatimi në kohë i aktiviteteve të dëmshme për pyjet do të bëjë të mundur marrjen e masave në kohë për zhbërjen e tyre.

1.3.B. Projekt – "Ngritja e një sistemi monitorimi të zonave pyjore të bashkisë", ky projekt do të konsitojë në krijimin e një databaze për të monitoruar rrezikun e shpyllëzimit dhe konsumit të tokës bujqësore dhe gjuetisë. Zhvillimin e masave për mbrojtjen e zonave pyjore. Programimin e fushatave për sensibilizimin dhe informimin e popullsisë së bashkisë. Rritjen e kontrollit dhe gjoba për gjuetinë e paligjshme. Kufizim i shfrytëzimit të drurit dhe masa kompesimi në zonat ku kryhen këto aktivitete.

1.3.C. Projekt – "Projekt pyllëzimi - Mbjellja e fidanëve të rinj të kulturave vendase në sipërfaqet pyjore të dëmtuara", rijetëzimi i sipërfaqeve pyjore të dëmtuara nga dora e njeriut apo shkaqet natyrore do ti shtojë vlerat fondit pyjor të bashkisë si dhe do të mbrojë këto zona nga rrëshkitje të mundshme të dherave.

1.3.D. Projekt - "Vlerësim i burimeve gjenetike kryesisht për speciet pyjore dhe identifikimi i pyjeve për ruajtjen e shumllojshmërisë", kategorizimi i llojeve të drurëve pyjorë do të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sipërfaqëve pyjore në territorin e bashkisë së Hasit. Ky projekt do të ndërmarrë krijimin e databazave për klasifikimin e specieve pyjore, pasqyrimi i kësaj dtabaze si në hartat përkatëse ashtu edhe në terren me anë të treguesve të posaçëm, përcaktimin specieve pyjore që nuk duhet të priten për ngrohje apo si lëndë drusore, etj.

1.4. Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i zonave të mbrojtura

1.4.A. Projekt - "Promovimi dhe informimi i banorëve vendas dhe vizitorëve për ekzistencën e zonave natyrore të mbrojtura dhe rëndësinë e tyre", me anë të fushatave në terren por edhe në media bashkia Has duhet të promovojë dhe informojë qytetarët e saj dhe ata jashtë territorit të bashkisë lidhur me ekzistencën e zonave natyrore të mbrojtura dhe monumeteve të natyrës që ndodhen në territorin e bashkisë. Kjo është përveçse një formë sensibilizimi dhe një formë reklamimi e resurseve natyrore. Infromimi do të kryhet duke përdorur:

- tabela informuese të vendosura përgjatë rrugëve kryesore të bashkisë
- shpërndarja e fletëpalosjeve për banorët e Hasit dhe vizitorët
- financimi i një spoti publicitar në një nga televizionet kombëtare
- organizimi i orëve tematike për nxënësit e shkollave

1.4.B. Projekt – "Ruajtja dhe kultivimi i bimëve mjekësore që rrezikojnë të zhduken", me anë të këtij projekti bashkia Has parashikon masat konkrete që duhen marë për ruajtjen dhe kultivimin e bimëve medicinale në habitatin e tyre natyral apo dhe kultivimin e tyre në ferma të posaçme. Gjithashtu në bashkëpunim me sektorin privat ose fermat familjare që veprojnë në territorin e Hasit, bashkia duhet të sigurojë dhe mbledhjen dhe tregëtimin e këtyre bimëve. Masat që duhet të parashikojë bashkia në kuadër të këtij projekti:

- ndalimi i kullotjes së bagëtive në sipërfaqet e habitatit natyror ku rriten bimët medicinale
- organizimi i takimeve informuese me fermerët vendas, ku tu tregohen sipërfaqet e habitatit natyror ku ata nuk duhet të kullosin bagëtitë, me qëllim ruajtjen e bimëve medicinale në formën e tyre natyrore.
- organizimi i takimeve trajnuese për fermerët vendas për kultivimin e bimëve medicinale
- hartimi i fletpalosjeve ilustrative ku të pasqyrohen hartat me zonat ku ndalohet kullotja, instruksione në lidhje me kultivimin e bimëve medicinale, etj

### 8.4.2 Projektet prioritare/pilot

| SKEDA E PROJEKTIT - 1 | |
|---|---|
| Lloji i Projktit | Prioritar |
| Emri i Projektit | Projekt pyllëzimi - Mbjellja e fidanëve të rinj të kulturave vendase në sipërfaqet pyjore të dëmtuara |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 1: “Mbrojtja e Mjedisit” |
| Vendndodhja | Projekti ka si synim mbjelljen e fidanëve në tre pjesë të ndryshme të territorit të bashkisë. Përkatësisht zona e parë janë sipërfaqet ujore mes fshtarve Zgjec dhe Qarr si dhe mes fshatrave Liqeni i Kuq dhe Helshan. Hapësira tjetër është ajo, mes fshatrave Dobrunë, Gajrep dhe Cahan si dhe hapësirat pyjore në njësinë administrative Gjinaj. |
| Harta |  |
| Sektori | 05_Mbrojtja e Mjedisit |
| Programi | 056_Mbrojtja Mjedisore |
| Faza | Afatgjatë (4-10 vite) |
| Tipologjia | Kujdesi për mjedisin |
| Kohëzgjatja | 4 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Bashkia Has është një ndër bashkitë të cilat mbartin sipërfaqen më të madhe të pyjeve në Shqipëri. Sistemi Natyror zë 87.4 % të sipërfaqes së bashkisë. |

| | |
|---|---|
| | Shfrytëzimi i pakontrolluar i sipërfaqes pyjore dhe djegia e tyre gjatë 28 viteve ka sjellë që një pjesë e madhe e sipërfaqes pyjore është dëmtuar duke sjellë dhe dëmtim të florës dhe faunës .<br><br>Loti 1-përfshin sipërfaqe pyjore ndërmjet njësive administrative Golaj, Krumë, Fajzë midis fshatit Zgjec dhe Qarr, pjesa midis fshatit Helshan dhe Liqeni Kuq dhe ka një sipërfaqe prej 559.8 Ha.<br><br>Loti 2- përfshin sipërfaqe pyjore në njësinë administrative Gjinaj në jug – lindje të bashkisë, në fshatrat midis Pusit të Thatë dhe Mujaj me sipërfaqe 1952,4 Ha.<br><br>Loti 3- përfshin sipërfaqe në lindje të bashkisë Has, e cila shtrihet mes njësisë Golaj dhe Gjinaj, në hapësirën mes fshatrave Dobrunë, Gajrep dhe Cahan dhe ka një sipërfaqe prej 1488.8 Ha.<br><br>Mbjellja e bimësisë dhe pemëve propozohet të jetë sipas llojeve që rriten aktualisht në Has si : pisha ,dushku dhe ahu. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 1,161,600,505 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Bashkëpunim publik – privat<br>- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit<br>- Drejtoria e pyjeve bashki |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i një projekti ku të përcaktohen saktë në harta kufijtë e hapësirave ku do të ndërhyet, llojet e fidanëve që do të përdoren si dhe sasia.<br>- Hartimi i një kalendari pune që mbulon kohëzgjatjen e parashikuar në këtë skedë<br>- Ngritja e grupit të punës ku duhet përfshihen specialistë të bashkisë dhe grupet e punës që do të bëjnë mbjelljen në terren<br>- Sigurimi i fondeve |
| Treguesi i monitorimit | Rritja e numrit të pemeve në fund të 4 vjeçarit në parcelat ku do të ndërhyet, hartimi i tabelave krahasuese dhe vënia në dispozicion të publikut. |

| SKEDA E PROJEKTIT - 2 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Prioritar |
| Emri i Projektit | Vendosja e barrierave pritëse për mbetjet urbane në degëzimet e lumit Drin në brendësi të bashkisë |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 1: "Mbrojtja e Mjedisit" |
| Vendndodhja | Projekti ndërhyn në segmentet e lumit Drin që degëzojnë në territorin e bashkisë Has. |
| Harta |  |
| Sektori | 05_Mbrojtja e Mjedisit |
| Programi | 056_Mbrojtja mjedisore |
| Tipologjia | Kujdesi për mjedisin |
| Faza | Afat shkurtër(1-3 vite) |
| Kohëzgjatja | 3 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Në kuadrin e mbrojtjes së mjedisit, bashkia Has duhet të sigurohet të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda mundësive të saj ligjore dhe kapaciteteve ekonomiko-profesionale që ajo zotëron, në dhënien e kontributit të saj në mbrojtjen e mjedisit jo vetëm në kufijtë e saj por dhe atë jashtë këtyre kufijve. Ndaj projekti në fjalë konsiston në vendosjen e barrjerave që filtrojnë mbetjet urbane që mund të derdhen në këto sipërfaqe. Ato do të montohen tërthor me rrjedhën e ujit në degëzimet e lumit Drin të cilat zgjaten në territorin e bashkisë, në mënyrë që të mos lejojnë derdhjen e mbetjeve direkt në lumin Drin.<br><br>Këto barrjera përveç grumbullimit të mbetjeve do të mundësojnë dhe pastrimin e tyre në momentin që kanë arritur kapacitetin e tyre mbajtës, ose në raste kur vërehen fryrje të ujit dhe mbetjet e grumbullura mund të përbëjnë pengesë për rrjedhën e ujit.<br><br>Adminitrimi i tyre ti lihet drejtorisë së pastrimit të mbetjeve urbane pranë bashkisë, ku të ngrihet një grup i posaçëm që veç të tjerash do të merret me pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |

| | |
|---|---|
| Kosto e përafërt | 12,587,143 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Bashkëpunim publik – privat<br>- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit<br>- Drejtoria e menaxhimit të mbetjeve urbane |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i një projektzbatimi për llojin dhe mënyrën e vendosjes së këtyre barrjerave<br>- Montimi i barrjerave në degëzimet e lumit drin në brendësi të bashkisë |
| Treguesi i monitorimit | Montimi i barrjerave në degëzimet e lumit Drin në territorn e Bashkisë |

| SKEDA E PROJEKTIT - 3 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Pilot |
| Emri i Projektit | Rehabilitimi i shtratit të Lumit Kruma dhe krijimi i një shëtitore përgjatë segmentit nga burimi deri tek ura në rrugën SH23 |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 1: "Mbrojtja e Mjedisit" |
| Vendndodhja | Segmenti i lumit Kruma që kalon në qytetin e Krumës |
| Përmasa | 0,54 km |
| Harta |  |
| Sektori | 01_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Programi | 013_Shërbime të përgjithshme publike |
| Tipologjia | Infrastrukturë mjedisore |
| Faza | Afatgjatë (4-10 vite) |
| Kohëzgjatja | 5 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Pastrimi dhe sistemimi i shtratit të lumit Kruma nga mbetjet urbane dhe depozitimet e ndryshme të dherave dhe materialeve natyrorë është një nevojë e cila rrjedh nga rreziku që përfaqëson ky lumë në periudhat e rreshjeve gjate së cilave rritja e nivelit të ujit rrezikon banesat që ndodhen pranë tij.<br><br>Gjithashtu si pasojë e vendndodhjes së tij, ky segment i lumit shfaq dhe një mundësi shumë të mirë për të krijuar një shëtitore për këmbësorët, e cila |

| | |
|---|---|
| | përveç një atraksioni shtesë për vizitorët do të shërbejë dhe si një strukturë urbane e cila do të tërheqë jetën e qytetit drejt saj.<br><br>Shëtitorja do të ndërtohet përgjatë shtratit të lumit dhe për ndërtimin e saj do të përdoren materiale vendase si guri dhe druri si dhe mobilim urban të stilit kontemporan si në dizajn ashtu dhe në materiale siç jane stolat apo ndriçuesit etj. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 96,257,318 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Bashkëpunim publik – privat<br>- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë<br>- Drejtoria e Planifikimit të Territorit |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Shpallja e një konkursi të hapur për projektide nga studio projektimi<br>- Shpallja e fituesit të konkursit të cilit i jepet e drejta për hartimin e projektzbatimit kundrejt pagesës së parashikuar në dokumentat e konkursit<br>- Ndërtimi i veprës |
| Treguesi i monitorimit | Ndërtimi dhe inagurimi i pedonales, prezatimi i saj kundrejt qytetit dhe vizitorëve nëpërmjet një aktiviteti të posaçëm. |

| SKEDA E PROJEKTIT - 4 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Prioritar |
| Emri i Projektit | Ristrukturimi dhe higjenizimi i pikës ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve urbane |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 1: “Mbrojtja e Mjedisit” |
| Vendndodhja | Hapësira subjekt i këtij projekti ndodhet 5 km në rrugë automobilistike në perëndim të qytetit të Krumës. |
| Harta |   |
| Sektori | 05_Mbrojtja e Mjedisit |
| Programi | 051_ Menaxhimi i mbetjeve |
| Tipologjia | Kujdesi për mjedisin |
| Faza | Afatgjatë (4-10vite) |
| Kohëzgjatja | 5 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Sitemimi i hapësirës ku grumbullohen mbetjet urbane do të sjellë mbrojtje shtesë për mjedisn ku ajo vepron duke mos lejuar që mbetjet të shpërndahen nga kjo pikë nëpër mjedisin natyror pa u kontrolluar. Kjo si pasojë e erës apo dukurive të tjera natyrore.<br><br>Gjithahstu shumë e rëndësishme në mirëfunksionimin e kësaj pike është dhe asfaltimi i rrugës që lidh këtë pikë grumbullimi me rrugën kombëtare Sh23. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 13,541,203 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Bashkëpunim publik – privat<br>- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit<br>- Bashkia Has |

| | |
|---|---|
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Shpallja e një konkursi të hapur për zgjedjen e një studio me kualifikimet më të larta në hartimin e projektzbatimit sistemimin e pikës së grumbullimit si dhe sitemim asfaltimin e rrugës që lidh këtë pikë me rrugën SH23.<br>- Shpallja e fituesit të konkursit<br>- Hartimi i Projktit nga ana e studios të përzgjedhur<br>- Prezantimi i Projktit për publikun<br>- Ndërtimi i masave të parashikuara në projekt |
| Treguesi i monitorimit | Përfundimi i ndërtimit të masave të parashikuara në projekt për sistemimin e pikës së grumbullimit të mbetjeve urbane si dhe përdundimi i asfaltimit të rrugës lidhëse me rrugën Sh23. |

| SKEDA E PROJEKTIT - 5 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Prioritar |
| Emri i Projektit | Ndërtimi i pikave të vrojtimit të pyjeve. |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 1: "Mbrojtja e Mjedisit" |
| Vendndodhja | Territori i bashkisë Has. |
| Harta |  |
| Sektori | 05_Mbrojtja e Mjedisit |
| Programi | 056_Mbrojtja Mjedisore |
| Tipologjia | Infrastrukturë mjedisore |
| Faza | Afatshkurtër (1 vit) |
| Kohëzgjatja | 1 vit |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Synimi kryesor i këtij projekti është përcaktimi i pikave të vrojtimit të pyjeve si dhe ndërtimi i infrastrukturave përkatëse për kryerjen e këtij shërbimi.<br><br>Ndërtimi i kullave të vrojtimit të pajisura me teknologjinë më të fundit në kryerjen e vrojtimit të pyjeve. Do të sjellë rritjen e cilësisë në punën për mirëmbajtjen e pyjeve në bashkinë Has. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 160,000 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Bashkëpunim publik – privat<br>- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit<br>- Bashkia Has |

| | |
|---|---|
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Përcaktimi i pikave ku do të ndërtohen kullat e vrojtimit<br>- Përcaktimi i modelit të kullave të vrojtimit<br>- Ndërtimi i kullave në pikat e evidentuara |
| Treguesi i monitorimit | Përfundimi i ndërtimit të kullave të vrojtimit në të gjitha pikat e parashikuara. |

### 8.5 Objektiv Strategjik 2 - Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore dhe monumentale ne Has

Në zonën e BashkisëHas si zonë të mbrojtura njihen 30 monumente natyrore siç është Ahishtja e Likenit të Kuq dhe 30 ha rezervë natyrore e menaxhuar *"Tej Drini i Bardhë"*.

Përkatësisht ato janë:

- *Mali i Pashtrikut*, kjo është zona më e famshme e Hasit që dallon për kullotat, shpellat, bimët dhe kafshët e rralla endemike. Ofron gjithashtu peizazhe të bukura, ajër të pastër dhe destinacion veror për turistë. Përmendet për pyjet me biodiversitet të theksuar sidomos në Cahan dhe Kishaj. Nga lartësia duket rrafshnalta e Dukagjinit ku qyteti i Gjakovës duket mes fushave pa fund. Nga krahu tjetër duket liqeni i Fierzës dhe më tej qyteti i lashtë i Prizrenit. Mali i Pashtrikut qëndron mes 4 qyteteve, shkëmbinjtë e mëdhenj gëlqeror i japin një pamje të bukur dhe në lartësinë më të madhe të malit shtrihet një gropë që quhet Hurdha e Madhe. Në lartësinë 1700 m mbi nivelin e detit është kroi i Dragovodit i cili dallohet për ujin e tij të akullt. Në majë të Pashtrikut është Vorri i mirë një vend shumë i vizituar pelegrinazhi në muajin gusht.
- *Bjeshkët e Krumës*, ofrojnë peizazhe të bukura dhe destinacion relaksi, destinacione pelegrinazhi, shpella objekte natyrore dhe arkeologjike, ngjitje alpiniste në majën e qytezës që është vendi më i njohur turistik. Ngjitja bëhet nga Cahani.
- *Shpella me oborr* gjendet pranë Krumës, 700 m mbi nivelin e detit. E formuar nga karsti në gëlqerorë, është mbi 40 m e gjatë, 4–5 m e gjerë, dhe e lartë 8–10 m. Ende e paeksploruar plotësisht është edhe shpella e Dajçit e ngjashme me shpellën e Pëllumbave.
- *Shpella që tingëllon në Mazrrek* gjendet në fshatin Mazrrek rreth 600 m mbi nivelin e detit. E formuar nga karsti në gëlqerorët, njihet pak. Fillon me një pus karstik mbi 50 m të thellë dhe 10–20 m të gjerë. Emrin e ka marrë nga tingëllimi i gurëve që hidhen në të.
- *Maja e Qytezës* gjendet afër Krumës rreth 800 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një maje gëlqerori mbi territorin përreth. Aty janë gjetur mbetje të një vendbanimi human të vjetër.
- *Burimi i Krumës* gjendet pranë Krumës rreth 480 m mbi nivelin e detit. Burimi karstik del në rrëzën e rrëpirës, në kontaktin gëlqerorë-argjile. Ka prurje 600 l/sec.
- *Gurra e Domajve* gjendet afër fshatit Domaj, Has 400 m mbi nivelin e detit. Burimi del në kontaktin litologjiko-tektonik, gëlqerorë-terrigjenorë me prurje 300 l/sec.

- *Burimet e Brrudit* gjenden afër fshatit Brrud, 450 m mbi nivelin e detit. Janë vetëm dy burime pasi të tjerët u mbuluan nga liqeni i Fierzës.

- Pisha e Gjinajve është dru 300 vjeçar, afër fshatit Gjinaj, 740 m mbi nivelin e detit, në formë kërpudhe të kurorës, lartësi 20 m dhe diametër të trungut 1 m

- *Ahishtja e Likenit të Kuq* me një sipërfaqe 12 ha. Është pranë fshatit Liqeni i Kuq, 300–370 m mbi nivelin e detit buzë liqenit të Fierzës. Është pyll ahu i zhvilluar shumë më poshtë lartësisë normale të arealit të ahut në vendin tonë dhe kjo e bën të veçantë dhe shumë interesant. Drurët e ahut kanë lartësi 25–28 m, diametër të trungjeve 35–57 m dhe moshë 80-150 vjet.

- *Shpella e Dajçit* ndodhet rreth 10 km në lindje të Krumës. Gjendet në lagjen Dajç të fshatit Mujaj. Ka qenë e banuar qysh në epokën e bronzit, hekurit dhe deri në antikitetin e hershëm. Këtë e dëshmojnë objektet e zbuluara në shpellë si: shpata, thika, qeramika etj.

Këto zona për shkak të vlerave të tyre, janë elemente të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit të Hasit si pjesë e rëndësishme e akseve kryesore ku ajo përfshihet. Këto pika shërbejnë për të promovuar qytetin e Hasit jo vetëm si një pikë tranziti por si një pjesë ku vetë turisitët mund të ndalojnë duke eksploruar natyrën e zonës. Nga karakteristikat që kanë këto zona mund të krijojnë tematika të ndryshme turizmi, duke filluar nga ai kulturor të turizmi i hiking, eksplorues ose muzeal.

Aspketin muzeal të zhvillimit dhe mbrotjes së monumenteve kulturore mund ta zhvillojnë më tepër objektet e lashta që ndodhen në këtë zonë të cilat janë të fortifikuara, të hapura, shpellore si më poshtë:

- Vendbanimi i Krumës
- Vendbanimet shpellore si ajo e Dajçit
- Vendbanime të tjera si Golaj, Nikoliq, Vlahen, Dobrunë, Helshan, Kosturr, Perollaj, Zjeç, Letaj, Qarr, Bardhaj. etj

Shpallja e monumeteve të mësipërme nga pikëpamja natyrore por edhe kulturore bëjnë të mundur rritjen e zhvillimit të turizmit në bashkinë e Hasit. Këto pika nëpërmjet marketingut dhe rrtijes së pikave të informacionit në pika të ndryshme të territorit të bashkisë rrisin ndjeshmërinë edhe njohurinë e banorëve lokal dhe turistëve të huaj kundrejt tyre.
Lidhja me këto zona krijon mundësinë që turistët nëpërmjet pikave të informacionit të njihen edhe më tepër me pikat e rëndësishme të zhvillimit turistik të Hasit, jo vetëm si pikë tranzit po si pikë ku mund të bëhet ndalesë më e gjatë në të.

Pra nëpërmjet këtij objekti strategjik si më poshtë listojmë që ai të shoqërohet me:

- Propozimin e pikave infopoint për në pika të ndryshme të territorit të Bashkisë
- Krijimine hartave turistike edhe itinerareve lëvizëse në pyjet e Bashkisë
- Bashkërendimi me bashkitë kufitare për të krijuar itinerare turistike në vazhdimësi nga njëra bashki në tjetrën
- Rritja e vëmendjes së fshatit Cahan si pjesë e projektit pilot 100 fshatrat




*Grafiku.5. Diagarma e zbërthimit të "Objektivit Strategjik 2"*




*Fig.19. Harta e vendodhjes së monumenteve natyrore dhe kulturore në Bashkinë Has*

## 8.5.1 PROGRAMET STRATEGJIKE

<u>2.1. Krijimi i shtigjeve dhe hartave turistike për territorin e bashkisë.</u>

<u>2.1.A.</u> Projekt – "Shpërndarja në territorin e bashkisë të pikave të informimit për turistët", ky projekt konsiston në krijimin e një rrjeti informimi për vizitorët e bashkisë Has, të cilat do të përfaqësohen nga stenda ku paraqiten harta dhe informacione lidhur me destinacionet turistike të bashkisë. Gjithashtu në qytetin e Krumës të ndërtohet dhe një pikë informimi ku punonjës të bashkisë tu ofrojnë vizitorëve fletëpalosje apo harta dhe udhëzime në ndihmë të vizitës që ata planifikojnë.




*Fig.20. Shpërndarja e pikave të informacionit në territorin e bashkisë Has*

2.1.B. Projekt – "Evidentimi si në hartë ashtu dhe në terren i shtigjeve natyrore në malin e Pashtrikut", evidentimi i shtigjeve natyrore në malin e Pashtrikut me anë të piketave që tregojnë drejtimin që duhet të ndjekësh si dhe pasqyrimi i këtyre shtigjeve në harta të cilat vendosen në dispozicion të vizitorëve me antë të fletëpalosjeve që shpërndahen në pikat e informacionit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANE
REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS



*Fig.21. Intinerar i propozuar në shtigjet e malit të pashtrikut*

2.1.C. Projekt – "Krijimi i intinerarit turistik në hapësirat natyrore Golaj-Fajzë", krijimi i intenerarit përgjatë hapësirave natyrore midis fshatrave Golaj dhe Fajzë do krijojë mundësinë e njohjes së natyrës së Hasit. Ky projekt njëkohësisht lidh dhe fshatin Golaj me Fajzë. Ky projekt rrit aksesin e turistëve në zonë duke ofruar një rrugë peizazhistike.

Krijimi i intenerarit ofron mundësi për zhvillimin e turizmit pasi ofron akses në një hapësirë të pashfrytëzueshme deri tani për shkak të mungesës të infrastrukturës. Ky projekt synon krijimin e intenerarit turistik në hapësirat natyrore dhe gjithashtu do jetë e plotësuar me sinjalistikën e duhur dhe përkatëse për shtigjet dhe zonat natyrore. Gjithashtu dhe krijimin e një harte turistike për zonën e Hasit.

2.1.D. Projekt – "Trajnimi i të rinjve për krijimin e guidave turistike brenda territorit të bashkisë Has", me anëtë këtij projekti bashkia e Hasit u krijon mundësi të rinjve të kësaj bashkie të trajnohen për krijimin e intinerareve turistike përgjatë sipërfaqes së territorit të bashkisë së Hasit. Duke krijuar kështu mundësi punësimi si dhe nxitje të turizmit në këtë bashki. Ky projekt do të:

- ngrejë një staf profesionistësh në fushën e turizmit për trajnimin e të rinjve të interesuar
- krijojë programin e trajnimit
- të sigurojë periudha praktike pas trajnimit
- ti mbështesë finaciarisht iniciativat e kursantëve pas trajnimit

2.2. Përfshirja në ofertën turistike të monumenteve të kulturës dhe natyrës

2.2.A. Projekt – "Restaurimi i Muzeut Etnografik në Krumë", Shkolla e Internatit Kosovar në Krumë është një objekt i cili bart shumë vlera historike, që prej funksionimit si shkollë, depo dhe më pas muze, ajo sot gjendet

gati e rrënuar dhe jashte vëmendjes. Rikonstruksioni i saj dhe adaptimi në përshtatje me funksionin e një muzeu do ia rriste vlerat ndërtesës dhe vetë Qytetit të Krumës.



*Fig.22. Godina e muzeut etnografik Krumë, ish "Shkolla e Internatit Kosovar në Krumë"*

<u>2.2.B.</u> Projekt – "Krijimi i intinerareve kulturore", si një krahinë me traditë të gjatë në aktivitetet kulturore, bashkia e Hasit duhet të krijojë intinerare njëditore për të vizituar objektet monument kulture. Përfshirja në këtë intinerar i shtëpive muze që parashikon pika më sipër është detyrim për ta bërë intinerarin sa më tërheqës dhe të kompletuar.



2.2.C. Projekt – "Memorial kushtuar dëshmorëve të luftës", me anë të këtij projekti synohet ti jepet rëndësi memories popullore për luftrat që ka kaluar popullsia në territorin e Hasit, në veçnati të theksohet kontributi i popullsisë së Hasit në luftën e Kosovës. Hasi ka qenë një ndër përkrahësit kryesor ne Luftën e Kosovës dhe ka 42 dëshmorë nga të cilët 37 nga lufta e Kosovës.

2.3. Nxitja e marketingut

2.3.A. Projekt – "Ngritja e shkollës profesionale të turizmit në Krumë", një nga problemet më të madha socialë në bashkinë e hasit është papunësia e të rinjve të cilët detyrohen dhe emigrojnë jashtë në kërkim të një pune. Me anë të këtij projekti bashkia Hasiu jep mundësinë të rinjve të aftësohen në profesione të fushës së turizmit, duke u dhën atyre një mundësi më shumë për tu punësuar në sektorin e turizmit. Gjithashtu aftësimi i të rinjve në fushën e turizmit do ti jeptë mundësinë bizneseve lokale të plotësojnë nevojat për personel me staf të klasifikuar ne këtë fushë. Ky projekt do ta kthente bashkinë e Hasit dhe në destinacionin e shumë të rinjve nga bashkitë kufitare dhe më gjërë për tu edukuar në fushën e turizmit.

2.3.B. Projekt – "Organizimi i aktiviteteve për çeljen e sezonit turistik", hartimi i një projekti për organizimin e një aktiviteti festiv me qëllimin e promovimit të turizmit, aty të propozohet dhe një datë që të njihet si dita e çeljes së sezonit turistik si dhe kohëzgjatja e sezonit turistik. Gjithashtu të përcaktohen dhe aktivitete social-kulturore dhe sportive që do të organizohen nga bashkia gjatë periudhës së sezonit turistik. Ndër aktivitetet që mund të organizohen janë:

- Koncert me këngë dhe valle popullore
- Organizimi i një panairi me produktet vendase
- Konkurs pikture me temën "Peizazh nga Hasi"
- Aktivitete sportive me nxënësit e shkollave
- Gara kanotazhi përgjatë liqenit të Fjezës.

2.4. Përfshirja në ofertën turistike të aseteve natyrore

2.4.A. Projekt – "Shfrytëzimi i brigjeve të rezervuarve për plazh ditor në sezon e veror", përveç furnizimit të bujqësisë me ujë për vaditje, disa prej rezervuarve që ndodhen në bashkinë e Hasit mund të përdoren dhe për plazh ditor nga banorët e Hasit dhe turistët që vijnë aty për ta vizituar. Me anë të këtij projekti bashkia Has duhet të sigurojë përshtatjen e brigjeve të rezervuarve më të mëdhenj, një nëdr ta është ai pranë qytetit të Krumës i cili është dhe më i madhi, duke i sitemuar dhe duke bërë mbushje me rërë në pjësën e bregut ku do të konsiderohet më e përshtshme. Ndonëse me sipërfaqë të vogla, brigjet e këtyre liqeneve ofrojnë një ambjent shplodhës të qëtë dhe me pamje fantastike të natyrës.



*Fig.23. Rezervuari nëë afërdsi të Krumës i cili është dhe me kapacitetin më të madh ujëmbledhës*

2.4.B. Projekt – "Krijimi i intinerarëve vozitës në hapësirat e lumit Drin dhe degëzimeve të tij", përgjatë gjithë kufirit të bashkisë së Hasit që laget nga lumi Drin shfaqet mundësia që të krijohen intinerarë vozitës të cilët të cojnë nga njëri fshat në tjetrin, drejt monumenteve të natyrës, siç është "Ahishtja e likenit të kuq". Ky projekt do të fokusohet përveç përcaktimit të intinerareve të mundshmë edhe në ndërtimin e infrasgtrukturës përkatëse siç janë limanet për ankorimin e varkave apo blerjen dhe të vetë varkave që do të përdoren për këtë qëllim.



*Fig.24. Propozimi për intinerarin vozitës bashkiak*

2.4.C. Projekt – "Krijimi i intinerarit vozitës nga Myc-Has drejt Liqenit të Kuq dhe anasjelltas",

Krijimi i një intinerari vozitës përgjatë basenit të liqenit të Fjerzës, shfaq një ofertë turistike shumë tërheqëse për vizitorët por dhe vetë banorët e bashkisë Has. Intinerari është menduar të nisë në fshtin Myc-Has i cili ndodhet në afërsi të rrugës Sh23 dhe të përfundojë në fshatin e Liqenit të Kuq atje ku ndodhet dhe një nga monumentet natyrore të bashkisë së Hasit. Ky projekt do të ndërmarrë veprimet e mëposhtme në mënyrë që të realizohet qëllimi i tij:

- krijimi i një rruge këmbësorësh nga fshati Myc-Has në bregun e liqenit të Fjerzës
- ndërtimi i një moli ankorimi për varkat në Myc-Has
- ndërtimi i një moli ankorimi për varkat në Liqenin e Kuq
- krijimi i një rruge këmbësorësh nga bregu i liqenit në afërsi të Liqenit të Kuq drejt fshatit Liqeni i Kuq




*Fig.25. Intinerari vozitës Myc-Has – Liqen i Kuq*

2.4.D. Projekt – "Rakordimi me bashkitë e Fushë Arrëzit, Kukësit dhe Tropojës për krijim e intinerarëve vozitës të përbashkët", intineraret vozitës bashkiak duhet të njëhësohen me ato të bashkive fqinje në mënyrë që oferta turistike në këtë fushë të bëhet më e plotë dhe gjithëpërfshirëse si dhe më atraktive. Kjo duke i ofruar vizitorëve një numër më të madh destinacionesh pjesë të këtij intinerari.

2.4.E. Projekt – "Përcaktimi i pikave për kamping", evidentimi dhe shtimi në hartat turistike të Hasit të zonave dhe pasazheve më të përshtatshme për kamping dhe ecje në natyrë, do të plotësonte ofertën turistike të Hasit edhe me ofrimin e një aktiviteti i cili është dhe trend i viteve të fundit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS




*Fig.16. Zonat e propozuara për kamping*

### 8.5.2 Projektet Prioritare/Pilot

| SKEDA E PROJEKTIT - 7 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Pilot |
| Emri i Projektit | Krijimi i intinerarit turistik në hapësirat natyrore Golaj-Fajzë |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 2: "Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore dhe monumentale ne Has" |
| Vendndodhja | Bashkia Has |
| Harta/Fotot |  |
| Sektori | 04_Çështjet ekonomike |
| Programi | 47_ Industri të tjera |
| Tipologjia | Turizëm në natyrë |
| Faza | Afatshkurtër (1 vit) |
| Kohëzgjatja | 1 vit |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Krijimi i intenerarit përgjatë hapësirave natyrore midis fshatrave Golaj dhe Fajzë do krijojë mundësinë e njohjes së natyrës së Hasit. Ky projekt njëkohësisht lidh dhe fshatin Golaj me Fajzën. Ky projekt rrit aksesin e turistëve në zonë duke ofruar një rrugë peizazhistike.<br><br>Krijimi i intenerarit ofron mundësi për zhvillimin e turizmit pasi ofron akses në një hapësirë të pashfrytëzueshme deri tani për shkak të mungesës së infrastrukturës. Ky projekt synon krijimin e intenerarit turistik në hapësirat natyrore dhe gjithashtu do jetë e plotësuar me sinjalistikën e duhur dhe përkatëse për shtigjet dhe zonat natyrore. Gjithashtu dhe krijimin e një harte turistike për zonën e Hasit. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 33,900,000 ALL |

| | |
|---|---|
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Evidentimi i saktë i gjurmës së intinerarit turistik Golaj-Fajzë<br>- Pasqyrimi i tij në harta turistike dhe vendosja në terren e sinjalistikës orientuese përgjatë gjithë intinerarit |
| Treguesi i monitorimit | Publikimi i intinerarit në hartat turistike dhe vendosja në terren e sinjalistikës orientuese |

| SKEDA E PROJEKTIT - 8 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Pilot |
| Emri i Projektit | Krijimi i intinerarit vozitës nga Myc-Has drejt Liqenit të Kuq dhe anasjelltas |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 2: "Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore dhe monumentale ne Has" |
| Vendndodhja | Myc-Has/Liqen i Kuq |
| Harta/Fotot |   |
| Sektori | 04_Çështjet ekonomike |
| Programi | 47_ Industri të tjera |
| Tipologjia | Turizëm në natyrë |
| Faza | Afatshkurtër (1vit) |
| Kohëzgjatja | 1 vit |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Krijimi i një intinerari vozitës përgjatë basenit të liqenit të Fjerzës, shfaq një ofertë turistike shumë tërheqëse për vizitorët por dhe vetë banorët e bashkisë Has. Intinearari është menduar të nisë në fshtin Myc-Has i cili ndodhet në afërsi të rrugës Sh23 dhe të përfundojë në fshatin e Liqenit të Kuq atje ku ndodhet dhe një nga monumentet natyrore të bashkisë së Hasit. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 1,859,632 ALL |

| | |
|---|---|
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Evidentimi i saktë i gjurmës së intinerarit turistik Golaj-Fajzë<br>- Pasqyrimi i tij në harta turistike dhe vendosja në terren e sinjalistikës orientuese përgjatë gjithë intinerarit |
| Treguesi i monitorimit | Publikimi i intinerarit në hartat turistike dhe vendosja në terren e sinjalistikës orientuese |

| SKEDA E PROJEKTIT - 9 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Pilot |
| Emri i Projektit | Memorial kushtuar dëshmorëve të luftës |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 2: "Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore dhe monumentale në Has" |
| Vendndodhja | Qyteti i Krumës |
| Përmas | |
| Harta |  |
| Sektori | 08_Argëtimi/kultura dhe feja |
| Programi | 082_Shërbime kulturore |
| Tipologjia | Turizëm kulturor |
| Faza | Afatmesëm (1vit) |
| Kohëzgjatja | 1 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Me anë të këtij projekti synohet ti jepet rëndësi memorjes popullore për luftrat që ka kaluar popullsia në territorin e Hasit, në veçnati të theksohet kontributi i popullsisë së Hasit në luftën e Kosovës.<br><br>Hasi ka qenë një ndër përkrahësit kryesor në Luftën e Kosovës dhe ka 42 dëshmorë nga të cilët 37 nga lufta e Kosovës. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 53,000 ALL |

| | |
|---|---|
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Shpallja e një konkursi të hapur për propozime lidhur me memorialin për dëshmorët e luftës.<br>- Krijimi i një aktiviteti ku të ekspozohen propozimet si dhe shpallja e fituesit, shpërdarja e cmimeve përkatëse.<br>- Ndërtimi i memorialit |
| Treguesi i monitorimit | Ndërtimi i memorialit dhe krijimi i një aktiviteti për inagurimin e tij. |

| SKEDA E PROJEKTIT – 11 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Prioritar |
| Emri i Projektit | Restaurimi i Muzeut Etnografik në Krumë |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 2: "Zhvillimi i turizmit duke promovuar asetet kulturore, natyrore dhe monumentale në Has" |
| Vendndodhja | Bashkia Has |
| Harta/Fotot |  |
| Sektori | 08_Argëtimi/kultura dhe feja |
| Programi | 082_Shërbime kulturore |
| Tipologjia | Turizëm kulturor |
| Faza | Afatmesëm (1-3 vite) |
| Kohëzgjatja | 3 vite |

| | |
|---|---|
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Restaurimi i muzeut entnografik në Krumë do ta shdërrojë këtë ndërtesë nga një godinë të lënë pas dore dhe jashtë funksionit, në një pikë atraksioni për vizitorët dhe simbol krenarie për pupullin e Hasit.<br><br>Kjo nga vet fakti i ekspozitës së pasur që zotëron ky muze me objekte dhe histori nga trashëgimia etnografike që populli hasian zotëron. Gjithashtu ky objekt do të kthehet në një aktivitet ekonomik përfitues për bashkinë e Hasit, pasi hyrja aty do të lejohet vetëm me anë të biletës çmimi i të cilës do të përcaktohet nga bashkia. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 12,000,000 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Shpallje e një konkursi të hapur për projektin e restaurimit të muzeut etnografik të Krumës.<br>- Shpallja e fituesit dhe nisja e punës për restaurimin e objektit |
| Treguesi i monitorimit | Përfundimi i punimeve për restaurikmin e muzeut në përputhje me projektin fitues dhe organizimi i aktivitetit për inagurimin e tij. |

## 8.6 Objektivi Strategjik 3 - Përmirësimi i bujqësisë edhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase

Është e nevojshme që në zona si Hasi ku ka mundësi zhvillimi të bujqësisë dhe blegtorisë të bëhet ruajtja maksimale e këtyre sipërfaqeve. Megjithëse vetë Hasi për shkak të terrenit të vështirë që ka, duke pasur mungesë të ujërave për ujitje, është e rëndësishme që të ruhen zonat ku ka mundësi të zhvillohen toka bujqësore, aty ku janë të krijuara edhe puset ujore. Degët që kanë më shumë mundësi për bujqësi janë pemëtaria dhe kultivimi i bimëve medicinale. Ndërkohë për blegtorinë është mirë të incentivohet mbarështrimi i dhive, i cili është i zhvilluar në zonë.

Zona e Hasit shënohet si një ndër zonat me prioritet për zhvillimin e blegtorisë edhe të bujqësisë, jo vetëm për potencialin e tokës, por edhe për shkak të potencialit të eksportit që kjo bashki ka me Kosovën.

Nga ky objekt strategjik listojmë si më poshtë disa nga pikat kryesore për realizimin e tij:

- Zhvillimi dhe mbarështimi i kafshëve të zonës; veçanërisht i dhive
- Zhvillimi i formave autoktone të bimëve, si pemtaria dhe bimë medicinale
- Krijimi i pikave të agroturizmit në zona të përshtatshme për kultivimin e bimëve dhe mbarështimin e kafshëve
- Zhvillimi i prodhimit vendas për të furnizuar nevojat lokale dhe eksport në vendet kufitare
- Shtimi i prodhimit vendas të produkteve bio
- Marketimi i produktevete endase të zonës




*Grafiku.6. Diagrama e zbërthimit të "Objektivit Strategjik 3"*

### 8.6.1 Programet strategjike

3.1. Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë

3.1.A. Projekt – "Mbështetje për shtimin e numrit të bagëtive për fermat e vogla", krijimi i një fondi bashkiak nga buxheti i bashkisë apo dhe donatorë të ndryshëm për mbështetjen e fermave vendase në procesin e shtimit të numrit të bagëtive. Bashkia do të përcaktojë fermat lokale që merren me mbarështimin e bagëtive të cilave do u mundësojë blerjen e një numri të caktuar bagëtish në raport me numrin e krerëve që çdonjëra nga fermat ka. Përparësi kanë ato ferma që merren me mbarështimin e dhisë së Hasit si një nga rracat e të imtave që njihet për cilësinë e qumështit dhe nënprodukteve të tij.

3.1.B. Projekt – "Financimi i blerjes së makinerive për përpunimin e tokës për fermat familjare", nisur nga fakti që shumica e fermave në territorin e bashkisë Has janë në formën e organizimeve familjare, subvencionimi nga ana e bashkisë në blerjen e makinerive për përpunimin e tokës është një ndihmë dhe nxitje për rritjen e aktivitetit. Projekti konsiston në evidentimin e familjeve që investojnë në bujqësi dhe përcaktimi i nevojave që kanë këto familje për makineri. Ndërsa faza tjetër është ajo e përcaktimit të mundësive që ka bashkia për blerjen e këtyre makinerive dhe blerja e tyre. Përfituesit nga kjo skemë duhet të përmbushin kushtin që rrisin sipërfaqet e mbjella nga 20% deri 50%. Apo dhe kushte të tjera që do të përcaktohen nga bashkia.

3.1.C. Projekt – "Ndërtimi i pikës së grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore vendase në Golaj", shumë e rëndësishme në tregun e sotëm është organizimi në forma bashkëpunimi i bujqësisë dhe blegrorisë ku pushteti lokal duhet të luajë rolin e koordinatorit. Ky projekt konsiston në ndërtimin e një objekti ku të grumbullohen të gjitha produktet bujqësore dhe blegtorale si dhe nga ku të tregëtohen si në tregun vendas (bashkiak) ashtu dhe atë jashtë, në atë kombëtar apo ndërkombëtar. Pronar dhe menaxhues i saj të jetë bashkia si organi që përfaqëson interesat e të gjitha palëve. Në këtë pikë do të bëhet:

- kontrolli i përshtatshmërisë së produkteve bujqësore
- përpunimi i produkteve bujqësore, në pajtueshmëri me standartet minimale të cilësisë
- ambalazhimi i produkteve bujqësore, duke ruajtur dimensionet minimale dhe shkallët e madhësisë
- ruajtje e produkteve në frigoriferë

3.1.D. Projekt – "Hartimi i strategjisë për zhvillimin e bujqësisë në zonë", një ndihmë tjetër që vjen nga bashkia e Hasit në raport me sektorin e bujqësisë është dhe hartimi i një dokumenti udhëzues për fermerët vendas lidhur me problematikat dhe mundësitë që shfaq territori i bashkisë së Hasit në raport me aktivitetin bujqësor. Njëkohësisht aty do të përcaktohet dhe roli i bashkisë në mbështetjen që do i japë këtij sektori. Kjo strategji do të përcaktojë:

- kulturat me më shumë interes për tu kultivuar në sipërfaqen e territorit të bashksië Has
- udhëzime për bonifikimin e tokave bujqësore
- orientimin e fermerëve vendas drejt tregjeve lokale dhe atyre kombëtare

3.2. Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore dhe blegtorale

3.2.A. Projekt – "Pastrimi dhe përforcimi i rezervuarve artificialë dhe rehabilitimi i rrjetit infrastrukturor të ndërlidhjes mes tyre dhe të shpërndarjes", ky projekt konsiston në pastrimin e rezervuarve dhe brigjeve të tyre nga mbetjet e ndryshme urbane apo natyrale sipas rastit. Dhe rikonstruksionin e rrjetit infrastrukturor që bën ndërlidhjen mes tyre si dhe infrastrukturën që bën shpërndarjen nëpër parcela, kjo duke u paraprirë nga një studim ku të tregohen zonat që kanë më shumë nevojë për ndihmën e rezervuarve për të bërë vaditjen e

kulturave bujqësore apo për të plotësuar nevojat e blegtorisë. Gjithashtu ky projekt duhet të parashikojë dhe rikonstuksionin ose përforcimin e digave të këtyre rezervuarve sipas neveojës.




*Fig.27. Rezervuarët në Helshan që propozohen për ndërhyrjen mirëmbajtëse të specifikuar më sipër*

3.2.B. Projekt – "Pastrimi dhe sistemimi i rrjetit të kanaleve vaditës", projekt që konsiton sipas rastit në pastrimin, zhbllokimin dhe sitemimin e rrjetit të kanaleve vaditës përgjatë terrtitorit të bashkisë. Me anë të këtij projekti bashkia Has do tu mundësojë fermerëve të zonës akses më të lehtë dhe cilësi më të mirë të infrastrukturës vaditëse.

3.2.C. Projekt – "Krijimi i një zyre informacioni për fermeret dhe mbështetja për zinxhirin e prodhimit", furnizimi i fermerëve vendas me informacionin e nevojshëm për format e reja dhe më frytdhënëse të trajtimit të proceseve të prodhimit në bujqësi apo blegtori, do të sjellë një impakt shumë pozitiv për këta fermerë por dhe për tregun dhe ekonominë vendase. Kjo pasi rritja e sasisë dhe cilësisë së prodhimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale do të plotësojë boshllëkun që ekzsiston në tregun bashkiak dhe atë më gjërë. Njëkohësisht kjo zyrë do të ofrojë mbështëtje teknike dhe këshillim për zhvillimin e koorporatave dhe shfrytëzimin e fondeve kombëtare për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore nga ana e fermerëve dhe biznesëve lokale.

3.2.D. Projekt – "Krijimi i tregjeve lokale për produktet bujqësore dhe blegtorale në Fajzë, Golaj dhe Gjinaj", si qendra të njësive administrative me anë të këtij projekti iu shtohet dhe një facilitet tjetër i nevojshëm për jetën e popullatës së këtyre vendbanimeve ai i tegut të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Në këtë mënyrë banorët e këtre zonave nuk do jenë të detyruar të zhvendosën deri në Krumë apo gjetkë për të blerë fruta-preime apo bulmet etj. Bashkia do të përcaktojë vendet ku do të ndërtohen dhe do të ndërtojë strukturat e posaçme të cilat do të përbëhen nga ambjente magazinimi, tregëtimi, etj. Këto ndërhyrje duhet të limitohen në dimensionet minimale të ndërtimit të strukturave pa cënuar funksionimin normal të tyre.

3.2.E. Projekt – "Ndërtimi i një ferme edukative në Fajzë", si një nga zonat më të përshtatshme për aktivitete bujqësore dhe blegtorale si rezultat i terrenit të favorshëm. Sipërfaqet e lira të sistemit bujqësor në njësinë administrative Fajzë do të përzgjidhen nga bashkia duke përcaktuar vendin më të përshtatshëm për ndërtimin e kësaj ferme. Aty do të kultivohen të gjitha kulturat bujqësore që mund të kultivohen në territorin e bashkisë së Hasit duke ruajtur theksin tek ato kultura që janë vendase dhe karakteristike për zonën, e nëjta gjë dhe për

mbarshtimin rracave të kafshëve blegtorale. Synimi i kësaj ferme është edukimi i fermerëve vendas sidomos fermerët e rinj me praktikat me të fundit në fushën e bujësisë dhe blegtorisë. Aty do të organizohen kurse të posaçme dhe pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata, fermat e të cilëve do të jenë të parat që do të përfitojnë nga mbështetja e qeverisë qendrore apo vendore.

3.3. Promovimi i produkteve vendase

3.3.A. Projekt – "Financimi i një spoti publicitar në një nga televizionet kombëtare për produktet vendase", me rëndësi të veçantë në këtë rast është reklamimi, ndaj ky projekt bën të mundur shfaqen e produkteve të bashkisë Has kundrejt një morie konsumatorësh të mundshëm duke bërë që të rritet numri i personave të interesuar për produktet që prodhohen në Has por dhe ata që duan të vizitojnë Hasin.

3.3.B. Projekt – "Zhvillimi i fermave organike për zhvillimin e agroturizmit dhe kultivimin dhe përpunimin e bimëve mjekësore dhe frutave të pyllit në shkallë të vogël përrreth zonave të: Cahanit, Vahen, Liqen i Kuq", me anë të këtij projekti bashkia Has do të orientojë fermerët vendas dhe ata jashtë territorit të bashkisë të interesuar për investime të territorin e saj drejt organizimit të fermave organike dhe agroturizmit. Masat që do të marrë bashkia në kuadër të këtij projekti janë:

- identifikimi dhe invetarizimi i sasive të prodhimeve organike dhe prodhuese
- identifikimi i tregjeve vendase, kombëtare dhe ndërkombëtare të cilët mundet të furnizojnë me produkte organike
- bashkëpunim me specialistë mbi produkte organike
- rikuperim i strukturave tradicionale me potencial zhvillimi të agroturizmit
- promovimi i organizimit të konsulencave midis specialistëve mbi produkte organike dhe fermerëve

3.3.C. Projekt – "Krijimi i markave të produkteve bujqësore (frutat e pyllit, bimët mjekësore, produktet e bulmetit)", bashkia Has duhet të promovojë produktet lokale për të rritur turizmin dhe eksportin e këtyre produkteve. Projekti ka si qëllim:

- identifikimi i markës të zonës dhe krijimi i një emri të përbashkët dhe promovimi i saj në tregje lokale dhe kombëtare
- sigurimi i cilësisë së produkteve bujqësore nëpërmjet një sistemi konytrolli
- marketing i markës me anë të krijimit të një faqeje në internet
- programim i evenenimeteve për promovimin e produkteve bujqësore në nivel lokal dhe kombëtar

3.3.D. Projekt – "Organizimi i panaireve dhe të tregut të produkteve bujqësore të bashkisë në data të caktuara gjatë vitit", me qëllim promovimin e produkteve vendase bashkia do të organizojë panaire për produktet lokale. Qëllimi kryesor i këtij projekti është promovimi i cilësisë së produkteve dhe promovimi i produkteve karakteristike për zonën, për këtë bashkia do të:

- hartojë një kalendar për disa data panairesh sipas sezoneve të kulturave kyesore të zonës
- njoftojë paraprakisht fermerët vendas për aktivitetet e planifikuara
- të krijojë forma standarte të ekspozimit të produkteve dhe t'ua servirë fermerëve pjesëmarrës në panaire
- organizojë takime kosultative me fermerët pët të diktuar cilësinë e produkteve dhe kulturat që janë me më shumë interes për ekspozim

## 8.6.2 Projektet Prioritare/Pilot

| SKEDA E PROJEKTIT - 12 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Pilot |
| Emri i Projektit | "Krijimi i markave të produkteve bujqësore (frutat e pyllit, bimët mjekësore, produktet e bulmetit)" |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 3: "Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase" |
| Vendndodhja | Bashkia Has |
| Harta/Fotot | - |
| Sektori | 04_Çështjet ekonomike |
| Programi | 041_Çështjet e përgjithshme ekonomike tregëtare dhe të punës |
| Tipologjia | Rigjenerim i bujqësisë |
| Faza | Afatshkurtër (1 vit) |
| Kohëzgjatja | 1 vit |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Bashkia Has duhet të promovojë produktet lokale për të rritur turizmin dhe eksportin e këtyre produkteve. Projekti ka si qëllim:<br>• identifikimi i markës të zonës dhe krijimi i një emri të përbashkët dhe promovimi i saj në tregje lokale dhe kombëtare<br>• sigurimi i cilësisë së produkteve bujqësore nëpërmjet një sistemi kontrolli<br>• marketing i markës me anë të krijimit të një faqeje në internet<br>• programim i evenenimeteve për promovimin e produkteve bujqësore në nivel lokal dhe kombëtar |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 375,000 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Shpallja e një konkursi të hapur për propozime lidhur me logon për brandin lokal, përcaktimi i çmimeve për 3 vendet e para.<br>- Krijimi i një aktiviteti ku të ekspozohen propozimet si dhe shpallja e fituesit, shpërdarja e çmimeve përkatëse.<br>- Takim me prodhuesit vendas për arritjen e një dakortësie lidhur me vendosje e logos fituese ne amablazhin e produkteve të tyre |
| Treguesi i monitorimit | Shitja e produkteve të para nën logon e brandit lokal. |

| SKEDA E PROJEKTIT - 13 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Pilot |
| Emri i Projektit | Ndërtimi i pikës për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve ushqimore vendase në Golaj |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 3: "Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase" |
| Vendndodhja | Bashkia Has |
| Përmasa | 1200 $m^2$ |
| Harta/Fotot |  |
| Sektori | 04_ Çështjet ekonomike |
| Programi | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| Tipologjia | Rigjenerim i bujqësisë |
| Faza | Afatgjatë (4-10vite) |
| Kohëzgjatja | 7 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Bashkia Has sikundër dhe shumica e bashkive në territorin e Shqipërisë kanë toka bujqësore të cilët i shfrytëzojnë privatisht dhe me sipërfaqë të vogla, pa bashkëpunuar me njëri-tjetrin. Kjo si rezulat sjell dhe prodhim më të ulët dhe kosto më të larta për prodhimin e produkteve bujqësore. Kjo bën të nevojshme ngritjen e infrastrukturës magazinuese dhe përpunuese si mënyrë për të grumbulluar sasi më të larta prodhimi nga fermerët e bashkisë dhe përpunimi i tyre për të rritur vlerën e produktit.<br>Sipas këtij projekti është e nevojshme ngritja e infrastrukturës së duhur në mënyrë që dhe banorët dhe kryesisht fermerët të bashkpunojmë mes tyre duke bashkuar njësitë e tyre të tokavë bujqësore dhe në këtë mënyrëtë rrisin prodhimin me më pak kosto dhe cilësi më e lartë. Kjo do të bëjë që produktet lokale të Hasit të jenë konkurruese në treg.<br><br>Ndërtimi i pikës grumbullimit ka pjesë ndërtimin e magazinës kryesore frigoferike të ruajtjes së produktit, sektorin e paketimit dhe të jetë e pajisur me logjistikën e |

| | |
|---|---|
| | duhur për ngarkim-shkarkimin e kamionëve transportues si dhe godina të ndërtohet pranë zonës agroturistike në Golaj. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 24,000,000 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Shpallja e një konkursi për të hapur për projektide të këtij segmenti<br>- Shpallja e fituesit të konkursit<br>- Hartimi i projektzbatimit nga ana e fituesit të konkursit<br>- Prezantimi i Projktit për publikun<br>- Ndërtimi i veprës |
| Treguesi i monitorimit | Ndërtimi i pikës së grumbullimit dhe vendosja në funksion e saj |

| SKEDA E PROJEKTIT - 14 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Pilot |
| Emri i Projektit | Ndërtimi i tregjeve lokale për produktet bujqësore dhe blegtorale në Fajzë, Golaj dhe Gjinaj |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 3: "Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase" |
| Vendndodhja | Bashkia Has |
| Përmasa | - |
| Harta/Fotot | |
| Sektori | 04_ Çështjet ekonomike |
| Programi | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| Tipologjia | Rigjenerim i bujqësisë |
| Faza | Afatmesëm (5-10vite) |
| Kohëzgjatja | 5 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Si qendra të njësive administrative me anë të këtij projekti iu shtohet dhe një facilitet tjetër i nevojshëm për jetën e popullatës së këtyre vendbanimeve ai i tegut të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Në këtë mënyrë banorët e këtre zonave nuk do jenë të detyruar të zhvendosën deri në Krumë apo gjetkë për të blerë fruta-preime apo bulmet etj. Bashkia do të përcaktojë vendet ku do të ndërtohen dhe do të ndërtojë strukturat e posaçme të cilat do të përbëhen nga ambjente magazinimi, tregëtimi, etj. Këto ndërhyrje duhet të limitohen në dimensionet minimale të ndërtimit të strukturave pa cënuar funksionimin normal të tyre. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 5,843,000 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Përcaktimi i pikave për çdonjërën nga njësitë ku do të ndërtohet tregu<br>- Ndërtimi i strukturave që do të përdoren si treg<br>- Ofrimi i këtyre hapësirave për tregëtarët vendas me anë të kontratave të bashkëpunimit me bashkinë |
| Treguesi i monitorimit | Ndërtimi i strukturave të tregjeve dhe vënia e tyre në funksion |

GJEOKONSULT & C
NIP1: K31810005'J

| SKEDA E PROJEKTIT - 15 | |
|---|---|
| Lloji i Projektit | Pilot |
| Emri i Projektit | Ndërtimi i një ferme edukative në Fajzë |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 3: "Përmirësimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke rritur prodhimin e produkteve vendase" |
| Vendndodhja | Bashkia Has |
| Përmasa | - |
| Harta/Fotot | |
| Sektori | 04_ Çështjet ekonomike |
| Programi | 042_Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia |
| Tipologjia | Rigjenerimi i bujqësisë |
| Faza | Afatgjatë (4-10vite) |
| Kohëzgjatja | 8 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Si një nga zonat më të përshtatshme për aktivitete bujqësore dhe blegtorale si rezultat i terrenit të favorshëm. Sipërfaqet e lira të sistemit bujqësor në njësinë administrative Fajzë do të përzgjidhen nga bashkia duke përcaktuar vendin më të përshtatshëm për ndërtimin e kësaj ferme. Aty do të kultivohen të gjitha kulturat bujqësore që mund të kultivohen në territorin e bashkisë së Hasit duke ruajtur theksin tek ato kultura që janë vendase dhe karakteristike për zonën, e nëjta gjë dhe për mbarështimin rracave të kafshëve blegtorale. Synimi i kësaj ferme është edukimi i fermerëve vendas sidomos fermerët e rinj me praktikat me të fundit në fushën e bujësisë dhe blegtorisë. Aty do të organizohen kurse të posaçme dhe pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata, fermat e të cilëve do të jenë të parat që do të përfitojnë nga mbështetja e qeverisë lokale apo vendore. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 282,843,000 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Evidentimi i një hapësire në afërsi të inrastrukturave ku mund të organizohet ferma<br>- Hartimi i një projekti për ndërtimin e saj<br>- Ndërtimi i fermës me të gjitha facilitetet për organizimin e proceseve mësimore<br>- Vënia në punë e fermës dhe nisja e kurseve praktike të para |
| Treguesi i monitorimit | Ndërtimi i fermës dhe nisja e kurseve prkatike |

### 8.7 Objektiv Strategjik 4 – Përmirësimi i shërbimeve publike

Potenciali bashkiak duhet nxitur me përmirësimin e rrugëve jo vetëm lidhëse me bashkitë e tjera por edhe ato lokale brenda territorit të saj midis fshatrave edhe qytetevte të tjera

- Përmirësimi i rrugëve lokale ekzistuese për të rritur aksesin psh: Aksi Has - Cahan; Asfaltimi i rrugës së fshatit Zahrisht, Gjinaj, Dobrunë, etj.
- Përmirësimi i rrugëve me rëndësi kombëtare
- Rritja e aksesit të rrugëve me fshatrat
- Të parashikohen programe afatgjata për mirëmbajtjen e tyre

Kushtet e dobëta të infrastrukturës primare të bashkisë sjellin automatikisht largimin e popullsisë edhe mungesën e investimeve në zonë. Në këtë mënyrë kërkohet përmirësimi imediat i kushteve të tilla si rrjeti ujësjellës-kanalizime, energjisë elektrike, arsimit, shëndetësisë etj. Kushtet e dobëta të elementëve bazë për popullsinë kërkon që këto të fundit të lokalizohen ku janë më problematike dhe këshillohet ristrukturimi i tyre si dhe shtimi i pikave të tjera në bashki për të mundësuar furnizimin e bashkisë.




*Grafiku.7. Diagrama e zbërthimit të "Objektivit Strategjik 4"*

### 8.7.1 Programet strategjike

4.1.Përmirësimi i rrugëve ekzistuese lokale

4.1.A. Projekt – "Sistemim asfaltimi i rrugës Krumë-Cahan", Cahani si pjesë e projektit për "100 Fshatrat" zë një rëndësi të veçantë edhe në parashikimet e PPV-Has sidomos me fokus turizmin. Sistemi dhe asfaliti i rrugës ekzistuese Krumë-Cahan është i një rëndësie të veçantë për vënien në punë të projekteve të tjera turistike në fshatin Cahan.




*Fig.28. Rruga Krume – Cahan, e cila propozohet për sitemim dhe asfaltim*

4.1.B. Projekt – "Asfaltimi i aksit Dobrunë - Golaj", asfaltimi i aksit Dobrunë-Golaj ndihmon lëvizjen e banorëve të Dobrunës për të shkurtuar distancën kohore për tu lidhur me fshatin Golaj qendrën e bashkisë qytetin e Krumës dhe më pikën doganore. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Dobrunë duke shkurtuar ndjeshëm distancën kohore duke lehtësuar marrjen e shërbimeve për banorët e Dobrunës. Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës, ndërtimin e veprave inxhinierike, krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave. Aksi rrugor i propozuar bashkohet në Golaj me Segmentin Rrugor Kombëtar (SH23)

4.1.C. Projekt – "Asfaltimi i aksit Nikoliq – SH23", dhe pse në distancë të afërt me qytetitn e Krumës rrjeti infrastrukturës rrugore nuk është në gjendje optimale duke sjell vështirësi në qarkullimin e banorëve zonës. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht pasi integron fshatin Nikoliq me qendrën e bashkisë së Hasit duke lehtësuar në mënyrë të ndjeshme aksesin në shërbime infrastrukture etj por dhe duke ndihmuar Nikoliqin në thithjen e investimeve private. Rruga ndodhet në gjendje mesatare e shtruar me çakull . Ky projekt synon asfaltimin

e plotë të rrugës, ndërtimin e veprave inxhinierike, krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave. Aksi prej 2.5 km shtrihet nga qendra e fshatit Zahrishtë dhe lidhet me segmentin Kombëtar (SH23)

4.1.D. Projekt – "Asfaltimi i aksit Kostur – Helshan – (Sh23)", projekti kërkon asfaltimin e rrugës të fshatrave Helshan dhe Kostur dhe lidhjen e tyre me infrastrukturën rrugore ekzistuese të bashkisë Has. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe shkurton ndjeshëm kohën për banorët e fshatrave Kostur dhe Helshan. Rruga ndodhet në gjendje mesatare e shtruar me çakull. Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës ,ndërtimin e veprave inxhinierike, krijimin e xhepave per shkëmbimin e makinave. Aksi prej 6.9 km shtrihet nga qendra e fshatit Kostur më pas duke kaluar nga qendra e fshatit Helshan dhe përfundon duke u intersektuar me segmentin (SH23).

4.1.E. Projekt – "Sistemim asfaltimi i rrugëve të fshatrave", nga konstatimet që u bënë në terren por dhe nga bisedat me banorët dhe përfaqësues të bashkisë, asfaltimi i rrugëve që lidhin fshtarat me rrugën kombëtare SH23 na rezultoi i një rëndësie të veçantë për zhvillimin. Këtu mund të përmendim Kostur-Helshan-Sh23, Myc-Has – SH23, Metaliaj-SH23, Dobrunë – SH23, Vlahen – SH23, Domaj – SH23, etj. Ky projekt do të bëjë që të zvogëlohet koha e lëvizjes nga fshatrat drejt qendrës dhe anasjelltas si dhe do i japë një dorë zhvillimit ekonomik duke i dhënë mundësinë fermerëve që të kenë akses më të kollajtë drejt tregut.

4.1.F. Projekt – "Vendosja e një rrjeti ndriçimi për rrugën kombëtare SH23 (segmenti që kalon nëpër bashkinë Has)". Një magësi e rrugës SH23 është mungesa e ndriçimit, fakti që pothuajse përgjatë gjithë segmentit të kësaj rruge që kalon në territorin e Bashkisë Has kemi zhvillimi priavte apo dhe vënbanime, është shumë e rëndësishme shtimi i ndriçimit sidomoms në segmentin që vjen nga kukësi drejt krumës ku dhe dëndësia e banësave dhe aktiviteteve njerëzore është më e madhe.

4.1.G. Projekt – "Hartimi i një plani afatgjatë masash për mirëmbajtjen e rrugëve lokale", me asfaltimin e rrugëve lokale është shumë e rëndësishme që bashkia të hartojë një plan masash për mirëmbajtjen perodike të tyre ose mirëmbajtjen nga dëmtimet apo bllokimet (si për shembull bllokimet e rrugëve nga bora) e mundshme nga faktorët atmosferikë. Ky plan duhet të hartohet në formën e studimit i cili do të përcaktojë dhe një kosto mestare vjetore të mirëmbajtjes.

4.1.H. Projekt – "Sistemim asfaltimi i rrugëve të brendshme të fshatrave që janë dhe njësi administrative", si qendra të njësive administrtive fshatrat Golaj, Fajzë dhe Gjinaj, janë dhe fshatrat me pupullsinë dhe aktivitet më të lartë njerëzor prandaj shihet me përparësi sitemimi dhe asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave të këtyre pasi në gjendjen aktuale banorëve u vështirësohet shumë aksesesi në këto qendra sidomos në periudhën e dimrit.

4.2. Përmirësimi i kushteve të ujësjellës-kanalizimeve

4.2.A. Projekt – "Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të qytetit Krumë", Qyteti i Hasit një nga problemet kryesore në fushën e infrastrukturës është infrastruktura e kanalizimeve. Aktualisht ujërat e zeza janë të depozituara në gropa septike e cila shkakton ndotje të nëntokës dhe probleme mjedisore për bashkinë Has. Nisur nga kjo problematikë është e nevojshme ndërtimi i një rrjeti kanalizimesh prej 7.8 km në qytetin e Hasit për largimin e ujërave të zeza të qytetit. Ndërtimi i rrjetit të ujërave të zeza ndihmon në largimin e ujërave të zeza të qytetit duke rritur dhe cilësinë e mjedisit përreth. Ky projekt synon ndërtimin nga e para e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza për lagjet kryesore të qytetit të Hasit.

4.2.B. Projekt – "Ndërtimi i një ujësjellësi në fshatin Cahan", si një fshat i orientuar drejt turizmit si pjesë e projektit 100 fshatrat është shumë e rëndësishme të pajiset me rrjet ujësjellësi për tu mundësuar ujë në ndërtesat si me funksion banim ashtu dhe në njësitë turistike që parashikoen të ndërtohen. Sygjerohet që ky projekt gjejë zbatim pasi të jetë vlerësuar numri i njësive turistike që mund të zhvillohen në këtë fshat.

4.2.C. Projekt – "Shtimin e pikave të furnizmit me ujë të rrjetit të ujësjellësit", nga konsultat dhe shqyrtimi i situatës në terren na rezultoi se sasia e ujit që merret nga burimi i Vrellës nga ku shpërndahet nëpër qytet nuk është i mjaftueshëm për të siguruar ujë për të gjithë popullsinë e bashkisë Has. Ndaj ky projekt ka për qëllim gjetjen e një ose disa pikave të tjera për të shtuar sasinë e prurjeve të ujit në rrjetin e ujësjellësit, në përshtatje me nevojat e popullsisë duke marë parasysh dhe ndërtimin e rrjeteve të fshatrave të parashikuar në këtë dokument.

4.3. Përmirësimi i shërbimeve në shëndetësi

4.3.A. Projekt – "Rikonstruksioni i qendrës shëndetësore Pus i Thatë", distanca e largët nga spitali i qytetit të Krumës dhe infrastruktura e dobët rrugore e cila vështirëson ofrimin e shërbimit shëndetësor ndikon negativisht në marrjen e këtij shërbimi për banorët e fshatit Pus i Thatë. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë për banorët e fshatit. Qendra Shëndetësore e fshatit Pus i Thatë ndodhet në gjendje të keqe sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Pus i Thatë. Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtesës së Qendrës Shëndetësore

4.3.B. Projekt – "Rikonstruksioni i qendrës shëndetësore Brenogë", qendra shëndetësore Brenogë i shërben fshatit Brenogë. Distanca e largët nga qendrat shëndetësore kryesore dhe infrastruktura e dobët rrugore e cila vështirëson ofrimin e shërbimit shëndetësor ndikon negativisht në marrjen e këtij shërbimi per banorët e fshatit Brenogë. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë. Qendra Shëndetësore e fshatit Brenogë ndodhet në gjendje mesatare sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Brenogë . Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtesës të Qendrës Shëndetësore.

4.3.C. Projekt – "Rikonstruksioni i qendrës shëndetësore Vlahen", gjëndja e keqe e infrastrukturës rrugore dhe e qendrës shëndetësore vështirëson marrjen e shërbimeve në bujqësi për banorët e fshatit Vlahen. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë. Qendra Shëndetësore e fshatit Vlahen ndodhet në gjëndje mesatare sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Vlahen. Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtesës të Qendrës Shëndetësore

4.4. Përmirësimi i kushteve në arsim

4.4.A. Projekt – "Rikonstruksioni i fushave dhe ambjenteve rekreative të shkollave ekzistuese", ky projekt konsiston në përmirësimin e ambjenteve të jashtme rekreative dhe oborreve të shkollave në territorin e bashkisë Has. Realizimi i këtij projekti do të sjellë ambjente më të pastra dhe të sigurta për nxënësit e shkollave pasi aktualisht oborret e shkollave në përgjithësi janë subjekt i baltosjes nga shirat apo pluhurosja në stinën e verës. Gjithahstu do tu japë mundësinë nxënësve dhe mësuesve të zhvillojnë një proces mësimor me një cilësi më të larë.

4.4.B. Projekt – "Rikonstruksioni i shkollës së mesme Vlahen", gjëndja ekzistuese e ndërtesës ndikon negativisht në procesin e mësimdhënies. Distanca e largët nga shkollat e mesme të tjera e lidhur bashkë me aksesin e dobët në infrastrukture dhe problematikat e bllokimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit .

Kjo bën të nevojshme ndërhyrjen në përmirësimin e ndërtesës së shkollës. Shkolla Mesme Vlahen ndodhet në gjendje të keqe sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatrave Vlahen dhe Gajrep. Ky projekt synon rikonstruksionin e plotë të ndërtesës të shkollës.

4.4.C. Projekt – "Rikonstruksion i shkollës 9-Vjeçare Fshat Krumë", Shkolla 9 vjeçare e Fshat Krumë ka një rol të rëndësishëm pasi i shërben gjithë zonave në periferi të qytetit të Krumës. Kjo bën që standartet e shkollës të përmirësohen për të përmbushur standartet. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e Fshat Krumë dhe lagjeve në periferi të qytetit të Krumës. Ky projekt synon rikonstruksionin e plotë të ndërtesës së Shkollës.

4.4.D. Projekt – "Furnizimi i shkollave me bazën materiale për zhvillimin e procesit mësimor", ashtu si në të gjitha zonat larg qendrave të mëdha në Shqipëri edhe në territorin e Hasit shkollat vuajnë nga mungesa e bazës materiale për zhvillimin e një procesi mësimor konform një norme normale. Të tilla si banka, dërrasa të zëza apo librari mungojnë nëpër auditoret e shkollave në Has, projekti në fjalë duhet të bëjë evidentimin e saktë të mungesave dhe plotësimin e tyre.

### 8.7.2 Projektet prioritare/pilot

| SKEDA E PROJEKTIT - 16 | |
|---|---|
| Lloji i Projktit | Pilot |
| Emri i Projektit | Asfaltimi i aksit Dobrunë-Golaj |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike" |
| Vendndodhja | Aksi Dobrunë-Golaj (ka një gjatësi prej 6.3 km dhe lidh Dobrunën me rrugën Interurbane dytësore të Krumë-Golaj) |
| Harta |  |
| Sektori | 01_Shërbime të përgjithshme publike |
| Programi | 013_Shërbime të përgjithshme publike |
| Tipologjia | Infrastrukturë rrugore |
| Faza | Afatgjatë (4-10 vite) |
| Kohëzgjatja | 5 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Asfaltimi i aksit Dobrunë-Golaj ndihmon lëvizjen e banorëve të Dobrunës për të shkurtuar distancën kohore për tu lidhur me fshatin Golaj qendrën e bashkisë qytetin e Krumës dhe më pikën doganore<br><br>Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Dobrunë duke shkurtuar ndjeshëm distancën kohore duke lehtësuar marrjen e shërbimeve për banorët e Dobrunës.<br><br>Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës, ndërtimin e veprave inxhinierike, krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave. |

| | |
|---|---|
| | Aksi rrugor i propozuar bashkohet në Golaj me Segmentin Rrugor kombëtar (SH23) |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 359,500,000 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i projekt zbatimit për ndërtimin e rrugës<br>- Ndërtimi i rrugës |
| Treguesi i monitorimit | Përfundimi i asfaltimit dhe vendosja e sinjalistikave të posaçme, vënia në funksionim e rrugës |

| SKEDA E PROJEKTIT - 17 | |
|---|---|
| Lloji i Projktit | Pilot |
| Emri i Projektit | Asfaltimi i aksit Nikoliq-Sh23 |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike" |
| Vendndodhja | Fshati Nikoliq ndodhet në veri të qytetit të Krumës, segmenti që do të asfaltohet është 2.4km nga rruga SH23 deri në fshatin Nikoliq |
| Harta |   |
| Sektori | 01_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Programi | 013_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Tipologjia | Infrastrukturë rrugore |
| Faza | Afatgjatë (4-10 vite) |
| Kohëzgjatja | 5 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Dhe pse në distancë të afërt me qytetitn e Krumës rrjeti infrastrukturës rrugore nuk është në gjendje optimale duke sjell vështirësi në qarkullimin e banorëve zonës. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht pasi integron fshatin Nikoliq me qendrën e bashkisë së Hasit duke lehtësuar në mënyrë të ndjeshme aksesin në shërbime infrastrukture etj por dhe duke ndihmuar Nikoliqin në thithjen e investimeve private.<br><br>Rruga ndodhet në gjendje mesatare e shtruar me çakull. Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës, ndërtimin e veprave inxhinierike, krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave. Aksi prej 2.5 km shtrihet nga qendra e fshatit Zahrishtë dhe lidhet me segmentin Kombëtar (SH23) |
| Përgjegjës | Bashkia Has |

| | |
|---|---|
| Kosto e përafërt | 125,000,000 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i projekt zbatimit për ndërtimin e rrugës<br>- Ndërtimi i rrugës |
| Treguesi i monitorimit | Përfundimi i asfaltimit dhe vendosja e sinjalistikave të posaçme, vënia në funksionim e rrugës |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

| SKEDA E PROJEKTIT - 18 | |
|---|---|
| Lloji i Projktit | Pilot |
| Emri i Projektit | Asfaltimi i aksit Kosturr – Helshan – (SH23) |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike" |
| Vendndodhja | Fshatrat Helshan dhe Kostur janë dy nga fshatrat kryesorë që ndodhen në veri të bashkisë Infrastrukura rrugore që lidh këto dy fshatra me segmentin kryesor SH23. |
| Harta |  |
| Sektori | 01_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Programi | 013_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Tipologjia | Infrastrukturë rrugore |
| Faza | Afatgjatë (4-10 vite) |
| Kohëzgjatja | 5 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Projekti kërkon asfaltimin e rrugës së fshatrave Helshan dhe Kostur dhe lidhjen e tyre me infrastrukturën rrugore ekzistuese të bashkisë Has. Asfaltimi i rrugës ndikon pozitivisht në rritjen e aksesit dhe shkurton ndjeshëm kohën për banorët e fshatrave Kostur dhe Helshan. Rruga ndodhet në gjendje mesatare e shtruar me çakull .<br><br>Ky projekt synon asfaltimin e plotë të rrugës, ndërtimin e veprave inxhinierike, krijimin e xhepave për shkëmbimin e makinave. Aksi prej 6.9km shtrihet nga qendra e fshatit Kostur më pas duke kaluar nga qendra e fshatit Helshan dhe përfundon duke u intersektuar me segmentin (SH23) |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 345,000,000 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |

| | |
|---|---|
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i projekt zbatimit për ndërtimin e rrugës<br>- Ndërtimi i rrugës |
| Treguesi i monitorimit | Përfundimi i asfaltimit dhe vendosja e sinjalistikave të posaçme, vënia në funksionim e rrugës |

| SKEDA E PROJEKTIT - 19 | |
|---|---|
| Lloji i Projktit | Pilot |
| Emri i Projektit | Rikonstruksioni i Shkollës së Mesme Vlahen |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike" |
| Vendndodhja | Shkolla e mesme në fshatin Vlahen është një shkollë që përdoret nga nxënësit e fshatit Vlahen dhe Gajrep. |
| Harta/Foto |   |
| Sektori | 01_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Programi | 013_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Tipologjia | Infrastrukturë arsimore |
| Faza | Afatmesëm (1-3 vite) |
| Kohëzgjatja | 2 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Gjendja ekzistuese e ndërtesës ndikon negativisht në procesin e mësimdhënies. Distanca e largët nga shkollat e mesme të tjera e lidhur bashkë me aksesin e dobët në infrastrukturë dhe problematikat e bllokimit të rrugëve gjatë stinës së dimrit .<br><br>Kjo bën të nevojshme ndërhyrjen në përmirësimin e ndërtesës së shkollës. Shkolla Mesme Vlahen ndodhet në gjendje të keqe sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatrave Vlahen dhe Gajrep. Ky projekt synon rikonstruksionin e plotë të ndërtesës të shkollës. |

| | |
|---|---|
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 9,862,500 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i projekt zbatimit për rikonstruksionin e shkolles<br>- Rikonstruksioni i shkollës |
| Treguesi i monitorimit | Përfundimi i rikonstruksionit dhe nisja e procesit normal mësimor. |

| SKEDA E PROJEKTIT - 20 | |
|---|---|
| Lloji i Projktit | Pilot |
| Emri i Projektit | Rikonstruksioni i Shkollës 9-Vjeçare Fshat Krumë |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike" |
| Vendndodhja | Fshat-Krumë (është një nga fshatrat më të populluara të bashkisë Has dhe ndodhet në afërsi të qytetit Krumë) |
| Harta/Foto | |
| Sektori | 01_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Programi | 013_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Tipologjia | Infrastrukturë arsimore |
| Faza | Afatmesëm (1-3 vite) |
| Kohëzgjatja | 2 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Shkolla 9 vjeçare e Fshat-Krumë ka një rol të rëndësishëm pasi i shërben gjithë zonave në periferi të qytetit të Krumës. Kjo bën që standartet e shkollës të përmirësohen për të përmbushur standartet.<br><br>Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e Fshat- Krumë dhe lagjeve në periferi të qytetit të Krumës.<br><br>Ky projekt synon rikonstruksionin e plotë të ndërtesës së Shkollës. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 10,068,750 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i projekt zbatimit për rikonstruksionin e shkollës<br>- Rikonstruksioni i shkollës |
| Treguesi i monitorimit | Përfundimi i rikonstruksionit dhe nisja e procesit normal mësimor. |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

GJEOKONSULT & CO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA

| SKEDA E PROJEKTIT - 21 | |
|---|---|
| Lloji i Projktit | Pilot |
| Emri i Projektit | Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Pusi i Thatë |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike" |
| Vendndodhja | Fshati Pus i Thatë ndodhet në pjesën jugore të Hasit në afërsi të fshatit Gjinaj. |
| Harta/Foto |  |
| Sektori | 01_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Programi | 013_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Tipologjia | Infrastrukturë shëndetësore |
| Faza | Afatshkurtër (1 vit) |
| Kohëzgjatja | 1 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Distanca e largët nga spitali i qytetit të Krumës dhe infrastruktura e dobët rrugore e cila vështirëson ofrimin e shërbimit shëndetësor ndikon negativisht në marrjen e këtij shërbimi per banorët e fshatit Pus i Thatë. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë për banorët e fshatit<br><br>Qendra Shëndetësore e fshatit Pus i Thatë ndodhet në gjendje të keqe sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Pus i Thatë. Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtesës të Qendrës Shëndetësore |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 918,750 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i projekt zbatimit për rikonstruksionin e qendrës shëndetësore |

| | |
|---|---|
| zbatimin e projektit | - Rikonstruksioni i godinës së qendrës shëndetësore |
| Treguesi i monitorimit | Përfundimi i rikonstruksionit dhe ofrimi i shërbimit mjekësor ambulator në kushte normale. |

| SKEDA E PROJEKTIT - 22 | |
|---|---|
| Lloji i Projktit | Pilot |
| Emri i Projektit | Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Brenogë |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 4: “Përmirësimi i shërbimeve publike” |
| Vendndodhja | Fshati Brenogë ndodhet në pjesën jug- perëmdimore të bashkisë së Hasit në afërsi të fshtit Tregëtan. |
| Harta/Foto |  |
| Sektori | 01_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Programi | 013_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Tipologjia | Infrastrukturë shëndetësore |
| Faza | Afatshkurtër (1 vit) |
| Kohëzgjatja | 1 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Qendra shëndetësore Brenogë i shërben fshatit Brenogë. Distanca e largët nga qendrat shëndetësore kryesore dhe infrastruktura e dobët rrugore e cila vështirëson ofrimin e shërbimit shëndetësor ndikon negativisht në marrjen e këtij shërbimi për banorët e fshatit Brenogë. Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë.<br><br>Qendra Shëndetësore e fshatit Brenogë ndodhet në gjendje mesatare sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Brenogë . Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtesës të Qendrës Shëndetësore |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 768,750 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i projekt zbatimit për rikonstruksionin e qendrës shëndetësore |

| | |
|---|---|
| zbatimin e projektit | - Rikonstruksioni i godinës së qendrës shëndetësore |
| Treguesi i monitorimit | Përfundimi i rikonstruksionit dhe ofrimi i shërbimit mjekësor ambulator në kushte normale. |

| SKEDA E PROJEKTIT - 23 | |
|---|---|
| Lloji i Projktit | Pilot |
| Emri i Projektit | Rikonstruksioni i Qendrës Shëndetësore Vlahen |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike" |
| Vendndodhja | Fshati Vlahen ndodhet në pjesën veri-lindore të bashkisë së Hasit, në lindje të fshatit Nikoliq si dhe në afërsi fshatit Gajrep i cili ndodhet në jug-lindje të Vlahenit. |
| Përmasa | 71 m$^2$, 1 kat |
| Harta/Foto |  |
| Sektori | 01_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Programi | 013_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Tipologjia | Infrastrukturë shëndetësore |
| Faza | Afatshkurtër (1vit) |
| Kohëzgjatja | 1 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Gjendja e keqe e infrastrukturës rrugore dhe e qendrës shendetësore vështirëson marrjen e shërbimeve në bujqësi për banorët e fshatit Vlahen.<br><br>Kjo situatë përkeqësohet dhe në stinën e dimrit ku aksesi në infrastrukturë bëhet dhe më i vështirë. Qendra Shëndetësore e fshatit Vlahen ndodhet në gjendje mesatare sa i përket infrastrukturës duke penguar marrjen e shërbimit të plotë dhe brenda standarteve. Rikonstruksioni i saj sjell ndikime pozitive për banorët e fshatit Vlahen.Ky projekt synon rikonstruksionin e pjesshëm të ndërtesës të Qendrës Shëndetësore |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 1,327,000 ALL |

| | |
|---|---|
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i projekt zbatimit për rikonstruksionin e qendrës shëndetësore<br>- Rikonstruksioni i godinës së qendrës shëndetësore |
| Treguesi i monitorimit | Përfundimi i rikonstruksionit dhe ofrimi i shërbimit mjekësor ambulator në kushte normale. |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

GJEOKONSULT & CO NIPT K[illegible]8100 05U

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

| SKEDA E PROJEKTIT - 24 | |
|---|---|
| Lloji i Projktit | Pilot |
| Emri i Projektit | Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të qytetit Krumë |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike" |
| Vendndodhja | Krumë |
| Përmasa | 7.8 km |
| Harta/Foto | |
| Sektori | 01_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Programi | 013_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Tipologjia | Infrastrukturë KUZ |
| Faza | Afatmesëm (1-3 vite) |
| Kohëzgjatja | 3 vite |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Qyteti i Hasit një nga problemet kryesore në fushën e infrastrukturës është infrastruktura e kanalizimeve. Aktualisht ujërat e zeza janë të depozituara në gropa septike e cila shkakton ndotje të nëntokës dhe probleme mjedisore për bashkinë Has.Nisur nga kjo problematikë është e nevojshme ndërtimi i një rrjeti kanalizimesh prej 7.8 km në qytetin e Hasit për largimin e ujërave të zeza të qytetit .<br><br>Ndërtimi i rrjetit të ujërave të zeza ndihmon në largimin e ujërave të zeza të qytetit duke rritur dhe cilësinë e mjedisit përreth.<br><br>Ky projekt synon ndërtimin nga e para të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza për lagjet kryesore të qytetit të Hasit. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |
| Kosto e përafërt | 51,441,000 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i projekt zbatimit për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve KUZ.<br>- Ndërtimi i rrjetit KUZ në qytetin e Hasit |
| Treguesi i monitorimit | Ndërtimi dhe vënia në funksion e këtij rrjeti |

| SKEDA E PROJEKTIT - 25 | |
|---|---|
| Lloji i Projktit | Pilot |
| Emri i Projektit | Hartimi i një plani afatgjatë masash për mirëmbajtjen e rrugëve lokale |
| Objektivi Strategjik | Objektivi Strategjik 4: "Përmirësimi i shërbimeve publike" |
| Vendndodhja | Bashkia Has |
| Përmasa | - |
| Harta/Foto |  |
| Sektori | 01_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Programi | 013_ Shërbime të përgjithshme publike |
| Tipologjia | Infrastrukturë rrugore |
| Faza | Afatshkurtër (1 vit) |
| Kohëzgjatja | 1 vit |
| Qëllimi kryesor dhe rëndësia | Bashkia Has ka një rrjet rrugor me 749.2 km rrugë të kategorive të ndryshme ku mbizotërojnë rrugët lokale . Problematikat më të mëdha shfaqen gjatë periudhës së dimrit, për shkak të terrenit goxha të thyer dhe dëborës. Mirëpo kapacitetet e bashkisë nuk janë të mjaftueshme për të mirëmbajtur rrugët e saj sidomos ato lokale në mënyrë që të ofrojë shërbimin e duhur.<br><br>Bashkia Has ka nevojë për një plan menaxhimi që të mund të propozojë disa mënyra dhe skema në favor të saj, dhe më kosto sa më të ulët dhe për buxhetin e bashkisë dhe në të njëtën kohë të ofrojë dhe shërbimin sipas standarteve. |
| Përgjegjës | Bashkia Has |

| | |
|---|---|
| Kosto e përafërt | 2,500,000 ALL |
| Burimet e mundshme të financimit | - Investim publik<br>- Buxheti i bashkisë Has |
| Veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit | Projekti duhet të ndjekë hapat e mëposhtëm për arritjen e qëllimit:<br>- Hartimi i një plani menaxhimi draft dhe konsultimi me banorët dhe aktorët e interesuar<br>- Miratimi i planit të menaxhimit dhe implementimi në planin bashkiak të menaxhimit të rrugeve |
| Treguesi i monitorimit | Mbajtja pastër dhe në funksion të rrjetit rrugor bashkiak gjatë gjithë vitit duke përfshirë dhe sezonin dimëror. |

## 8.8 Objektiv Strategjik 5- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar të bashkisë si pasojë e pozicionit gjeografik të saj

Pozicioni i Hasit mundëson lidhjen e tij me disa pika kryesore të zhvillimit të vendit si:

- Afërsia me aeroportin e Kukësit
- Afërsia me korridorin X pan europian etj

Këto janë disa nga pikat e Hasit të cilat lejojnë lidhjen e kësaj zone me rajonet kufitare dhe ndërkufitare duke sjellë automatikisht zhvillimin ekonomik dhe social të kësaj zonë.

Ky pozicion gjeografik mundëson:

- Rritjen e marrëdhënies me vendet kufitare nëpërmjet politikave të import-eksportit të produkteve lokale
- Rritjen e pikave turisitike të përmendura në OS3 për rritjen e prurjes së turistëve ndërkombëtar
- Rritjen e investimeve ndaj infrastrukturës rrugore të parashikuar në OS5




*Grafiku.8. Diagrama e zbërthimit të "Objektibvit strategjik 5"*

### 8.8.1 Programet strategjike

5.1. Rritja e bashkëpunimit me njësitë administrative vendore kufitare në kuadër të projekteve IPA.

5.1.A. Projekt – "Krijimi i një ure bashkëpunimi me komunën e Prizrenit", në kuadër të projekteve IPA të bashkëpunimit ndërkufitar, nisja e një bashkëpunimi mes dy njësive të qeverisjes vendore shihet me prioritet për përfitimin e fondeve të vendosura në dispozicion nga bashkimi europian. Gjithashtu edhe hartimi i projekteve të përbashkëta në fushën e turizmit dhe kulturës, siç mund të jenë krijimi i intinerareve të përbashkëta turistike apo organizimi i evenimeneteve kulturore me pjesëmarrje nga të artistëve dhe personazheve poblikë nga të dy njësitë administrative. Masat që do të merren nga bashkia Has për ekzekutimin e këtij projekti janë:

- organizimi i një takimi ndërbashkiak me bashkinë e Prizrenit ku të përcaktohen fushat e bashkëpunimit dhe kalendari i takimeve për periudhën kur projektet IPA janë aktive
- propozimi i një kalendari aktivitetesh të përbashkëta në kuadër të projekteve IPA
- propozimi i rpojekteve konkrete të bashkëpunimit

